R E L A C I O N

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR BUXHETIN E VITIT 2027”

HYRJE

Projektbuxheti i vitit 2027 përbën një nga instrumentet kryesore për zbatimin e prioriteteve të Qeverisë për periudhën 2025–2029 dhe për avancimin e vizionit për një Shqipëri europiane, me ekonomi konkurruese, institucione moderne dhe një nivel më të lartë mirëqenieje për qytetarët. Ai ndërthur mbështetjen për rritjen ekonomike dhe politikat sociale me investimet strategjike, modernizimin e shërbimeve publike, forcimin e sigurisë dhe mbrojtjes, zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe përshpejtimin e procesit të integrimit në Bashkimin Europian.

Në këtë kuadër, **integrimi europian dhe përmbushja e angazhimeve që lidhen me procesin e anëtarësimit marrin një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në orientimin e burimeve publike**. Plani i Rritjes i Bashkimit Europian për Ballkanin Perëndimor krijon mundësi shtesë për financimin e reformave dhe investimeve që mbështesin konvergjencën ekonomike dhe sociale me Bashkimin Europian. Në vitin 2027, investimet publike parashikohen në rreth **201.5 miliardë lekë ose 6.9% të PBB-së**, duke përfshirë rreth **14.1 miliardë lekë financime të pritshme mbi bazë projektesh nga Plani i Rritjes.**

Ekonomia e vendit parashikohet të zgjerohet me rreth **4 përqind në vitin 2026**, e mbështetur nga kushtet e favorshme ekonomike, e mbështetur nga kushtet e favorshme ekonomike, performanca e qëndrueshme e sektorit të shërbimeve, veçanërisht turizmi, si dhe zgjerimi i konsumit privat dhe investimet në ndërtim e infrastrukturë. **Në periudhën afatmesme 2027-2029**, rritja parashikohet të ruajë trajektore pozitive, me një normë mesatare prej **rreth 4.0 përqind në vit**, e mbështetur nga dinamika e kërkesës së brendshme, zhvillimi i mëtejshëm i sektorëve strategjikë dhe pritshmëritë për një rikuperim gradual të ekonomisë globale dhe veçanërisht atë të Bashkimit Evropian.

Deficiti buxhetor për vitin 2027 planifikohet të qëndrojë në nivelin **2.3 përqind të PBB-së**, duke qëndruar në të njëjtin nivel me atë të pritshëm për vitin 2026. Balanca primare pritet të rezultojë e balancuar në vitin 2027, në zbatim me rregullin fiskal të parashikuar në LOB që përcaktohet se, duke filluar nga viti buxhetor 2024 e për çdo vit në vijim, balanca primare nuk mund të rezultojë negative. Gjithashtu, borxhi publik bruto do të vijojë trajektoren rënëse në përputhje me rregullin respektiv fiskal. Në vitin 2026 parashikohet që **borxhi publik bruto** të ulet në rreth 52.5 përqind të PBB-së dhe pritet të vijojë të bjerë më tej në rreth **52.4** përqind në vitin **2027.** Sipas skenarit bazë, **borxhi publik bruto** pritet të bjerë në rreth **52.2 përqind deri në vitin 2029** dhe më tej në rreth **50.9 përqind në vitin 2031**.

Në projektbuxhetin e vitit 2027, **programimi i të ardhurave buxhetore** bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi. Të ardhurat buxhetore për vitin 2027 parashikohen në masën 907.8 miliardë lekë ose **30.9% e PBB**. Krahasuar me planin e rishikuar për vitin 2026, të ardhurat buxhetore për vitin 2027 parashikohen me rreth 57.2 miliardë lekë më shumë.

Shpenzimet Buxhetore për vitin 2027 programohen në masën **976.1 miliardë lekë** ose rreth **33.3% e PBB** duke rezultuar rreth 69.3 miliardë lekë më shumë se plani i rishikuar i vitit 2026. **Politikat sociale dhe rritja e mirëqenies përbëjnë një nga shtyllat kryesore të Projektbuxhetit 2027.** Në shpenzimet buxhetore për periudhën 2027-2029 sigurohen burimet e nevojshme për arritjen e angazhimit të Qeverisë për vijimin e politikës për rritjen e pensionit minimal në nivelin e **200 Euro në muaj** dhe atij mesatar në nivelin e **400 Euro** në muaj. Krahas kësaj politike, parashikohet financimi i plotë i rishikimit të politikës së bonusit të bebes duke ofruar dhe një **pagesë mujore për fëmijët 0-5 vjeç**.

Qeveria do të vijojë me financimin e një niveli të lartë investimesh publike, me një mesatare prej **6.6% të PBB** gjatë periudhës 2027–2029. Këto investime do të përqendrohen në projekte me rëndësi strategjike, të cilat janë të lidhura ngushtë me Planin e Rritjes së Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor. Shpenzimet e planifikuara për këtë periudhë mbështeten në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021–2030, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë fushave prioritare si dixhitalizimi, transporti, siguria kombëtare, shëndetësia, arsimi, bujqësia dhe zhvillimi rural.

Në kuadër të **buxhetimit të përgjigjshëm gjinor**, në vitin 2027 do të vijojë adresimi i çështjeve të lidhura me barazinë gjinore kryesisht në fushat e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale, drejtësisë dhe rendit publik. Në këtë projektbuxhet parashikohet që rreth 9.1% e shpenzimeve buxhetore t'i dedikohen politikave publike me bazë gjinore të përfshira në 82 programe buxhetore.

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2027 parashikohen në **114.6 miliardë lekë**, ose **2.4%** më shumë se në vitin 2026. Këto shpenzime për vitin 2027 zënë **3.9%** të PBB-së, në të njëjtin nivel me vitin 2026, kundrejt **2.3% të PBB-së** në vitin 2015. Transferta e pakushtëzuar për vitin 2027 rritet me **1.4 miliardë lekë** ose **5.1%** ndaj vitit 2026, ndërsa krahasuar me vitin 2015 është **16.9 miliardë lekë më shumë, ose mbi dy herë më e lartë**. Nëse e krahasojmë me buxhetin fillestar të vitit 2026, transferta e pakushtëzuar në vitin 2027 rritet në shumën 1.5 miliardë lekë, ose 6% më e lartë. Ky financim synon të mbështesë procesin e decentralizimit dhe zbatimin e reformës së re administrativo territoriale, duke forcuar kapacitetet administrative dhe ofrimin e shërbimeve vendore.

Në tërësi, Projektbuxheti 2027 synon të krijojë një ekuilibër ndërmjet tre objektivave themelorë: ruajtjes së stabilitetit dhe qëndrueshmërisë fiskale; financimit të prioriteteve sociale dhe përmirësimit të mirëqenies; dhe përshpejtimit të investimeve dhe reformave që rrisin produktivitetin, sigurinë, konkurrueshmërinë dhe konvergjencën e Shqipërisë me Bashkimin Europian**.** Në këtë mënyrë, Buxheti 2027 nuk përfaqëson vetëm planin financiar të një viti, por një hallkë të rëndësishme të programit afatmesëm 2025–2029 dhe të përgatitjes së vendit për fazën e ardhshme të integrimit europian.

1. SITUATA EKONOMIKE

1.1 ZHVILLIMET E FUNDIT DHE PERSPEKTIVA MAKROEKONOMIKE

Ekonomia shqiptare ka treguar një qëndrueshmëri të lartë përballë një sërë goditjesh të njëpasnjëshme që kanë prekur vendin gjatë viteve të fundit. Nga tërmeti i fundvitit 2019, te pasojat e pandemisë globale dhe tensionet gjeopolitike që kanë ndikuar në zinxhirët ndërkombëtarë të furnizimit, vendi ka arritur të ruajë stabilitetin makroekonomik dhe të vijoj trendin pozitiv të rritjes. Politikat e kujdesshme makroekonomike dhe fiskale kanë mbështetur rimëkëmbjen graduale të aktivitetit ekonomik, duke garantuar që fondamentet kryesore ekonomike dhe financiare të mbeten solide.

Gjatë vitit 2025, ekonomia ka vijuar trendin pozitiv të zgjerimit, duke regjistruar një rritje reale prej rreth 3.7 përqind, e mbështetur kryesisht nga forcimi i kërkesës së brendshme, rritja e investimeve publike dhe performanca tejet pozitive e sektorit të shërbimeve. Rritja ekonomike vazhdoi trendin e rritjes së qëndrueshme edhe në vitin 2026. Sipas vlerësimeve më të fundit të disponueshme nga INSTAT, PBB-ja

reale shënoi një rritje vjetore prej 3.7 përqind gjatë gjysmës së parë të vitit 2026, duke pasqyruar rritje pothuajse në të gjithë sektorët e ekonomisë. Rritja e besimit të biznesit, veçanërisht në sektorët e shërbimeve dhe ndërtimit, përmirësimi i ekonomive partnere, si dhe politikat mbështetëse fiskale dhe monetare, kanë nxitur rritje të konsumit të familjeve, të investimeve publike e private, si dhe të eksporteve të shërbimeve, veçanërisht turizmit. Inflacioni ka vijuar me një trajektore të qëndrueshme, duke reflektuar stabilizimin e çmimeve dhe normalizimin gradual të zinxhirëve të furnizimit. Këto zhvillime kanë mbështetur rimëkëmbje për biznesin dhe punësimin, duke krijuar premisa të qëndrueshme për perspektivën afatmesme.

Nga këndvështrimi i kërkesës agregate, rritja gjatë gjysmës së parë të vitit 2026 është gjeneruar kryesisht nga kërkesa e brendshme, si nga konsumi privat dhe publik, ashtu edhe nga investimet, si dhe nga ecuria e mirë e eksporteve të shërbimeve, në pasqyrim të një sezoni turistik mjaft pozitiv. Në këtë kontekst, konsumi final total, i cili përbën peshën më të madhe në ekonomi, për gjysmën e parë të vitit 2026 shënoi rritje prej 3.55 përqind, i mbështetur nga një rritje prej 4.2 përqind të konsumit privat dhe një rritje prej 1.4 përqind të konsumit të administratës publike krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Formimi i kapitalit fiks bruto (investimet totale) shënoi një rritje të fortë me rreth 3.3 përqind në terma real vjetor gjatë vitit 2025 dhe 2.8 përqind gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, duke vijuar të japë një kontribut pozitiv në zgjerimin ekonomik.

Në anën e ofertës agregate, kontribut pozitiv në gjysmën e parë të vitit 2026 dhanë disa degë, konkretisht: “Administrim publik, Arsimi, Shëndetësia” me rritje prej 13.04 përqind dhe kontribut prej +1.66 pikë përqindje, “Aktivitete të pasurive të paluajtshme” me rritje prej 8.1 dhe kontribut prej +0.46 pikë përqindje. “Aktivitete financiare dhe të sigurimit” me rritje prej 4.27 përqind dhe kontribut prej +0.08 pikë përqindje, “Tregti, Transport, Akomodim dhe Shërbim ushqimor” me rritje 3.77 dhe kontribut prej +0.61 pikë përqindje”, “Informacioni dhe komunikimi” me rritje prej 2.58 përqind dhe kontribut prej +0.07 pikë përqindje, etj.

Ndërkohë, aktiviteti ekonomik “Bujqësi, pyje dhe peshkim” kontribuoi negativisht me një rënie prej -1.52 përqind dhe kontribut prej -0.24 pikë përqindje, ndërsa sektori i “Industria nxjerrëse, përpunuese Energjia elektrike, ujë” rezultoi me një rënie prej -0.81 përqind dhe një kontribut prej -0.08 pikë përqindje.

Të dhënat e tregtisë së jashtme të mallrave në terma nominal për periudhën tetë-mujore, tregojnë për një rritje të eksporteve me 6.3 përqind dhe të importeve me 5.1 përqind, krahasuar me një vit më parë. Si rezultat, deficiti tregtar është rritur me 4.4 përqind për këtë periudhë, ndërsa norma e mbulimit të eksporteve ndaj importeve është 40.5 përqind. Kjo ecuri pasqyron ndikimin e çmimeve ndërkombëtare në rritje dhe kursit të mbiçmuar të këmbimit, të cilat kanë ndikuar ndjeshëm në strukturën e tregtisë së jashtme. Zhvillimet në tregun e punës kanë qenë gjithashtu pozitive. Shkalla e punësimit gjatë vitit 2025 është rritur mesatarisht me 0.8 pp. në vit, mbështetur kryesisht nga punësimi më i lartë në sektorin e shërbimeve. Nga pikëpamja e ofertës, rritja e punësimit mund t’i atribuohet kryesisht rritjes së qëndrueshme të shkallës të pjesëmarrjes së fuqisë punëtore dhe shkallës së punësimit, duke arritur përkatësisht 76.3 përqind dhe 69.3 përqind përgjatë vitit 2025 (krahasuar me respektivisht 75.7 përqind dhe 68.5 përqind në 2024). Tendencat pozitive të pagave kanë nxitur një interes të përgjithshëm në rritje për përfshirje në tregun e punës, duke intensifikuar kështu tendencat pozitive në ofertën e punës. Në të njëjtën kohë, shkalla e papunësisë vijoi trendin rënës të viteve të fundit, duke arritur në 8.3 përqind në tremujorin e dytë të vitit 2026, nga 8.5 përqind në tremujorin e dytë të vitit të kaluar (për moshën 15 vjeç e lart).
Pozicioni i jashtëm i ekonomisë, një tjetër fondament tejet i rëndësishëm dhe tipikisht vulnerabël ndaj goditjeve të jashtme, mbeti relativisht solid, përtej pritshmërive fillestare lidhur me efektin e pandemisë

dhe ndërprerjet në ofertën globale të mallrave kryesorë si dhe implikimeve negative zinxhir që mund të shkaktonte në fondamente të tjerë. Në vitin 2025, llogaria korrente u mbyll me një deficit prej rreth 0.7 përqind të PBB-së. Ndërkohë, në gjysmën e parë të vitit 2026, deficiti i llogarisë korrente shënon 362 milionë euro, i ngushtuar në terma vjetorë me rreth 246 milionë euro ose rreth 40.5 përqind kundrejt së njëjtës periudhë të një viti më parë. Ndërsa, vetëm gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026, deficiti i llogarisë korrente arriti në 108 milionë euro, duke u ngushtuar në terma vjetorë me rreth 182 milionë euro, ose 62.8 përqind, pavarësisht thellimit të deficitit tregtar në mallra. Ky i fundit u ndikua kryesisht nga rritja e importeve të mjeteve të transportit dhe produkteve ushqimore.

Në gjysmën e parë të vitit 2026, të hyrat nga shërbimet të lidhura përgjithësisht me "Turizmin" shënuan rritje prej 13.4 përqind, krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2025. Gjithashtu për këtë periudhë, edhe "Remitancat" shënuan rritje prej 16.9 përqind. Përmirësimi i llogarisë korrente u mbështet nga zgjerimi i suficitit në tregtinë e shërbimeve, kalimi i të ardhurave parësore nga deficit në suficit dhe rritja e suficitit të të ardhurave dytësore.

Investimet e Huaja Direkte (IHD) në gjysmën e parë të vitit 2026, shënuan vlerën 1.1 miliardë euro ose 50.8 përqind, krahasuar me 759 milionë euro në gjashtëmujorin e parë 2025. Gjithashtu, vetëm për tremujorin e dytë të 2026, IHD regjistruan vlerën 741 milionë euro ose një rritje prej 86.3 përqind, krahasuar me tremujorin e dytë të 2025. Kjo rritje u ndikua ndjeshëm nga flukse të lidhura me një projekt të rëndësishëm zhvillimi në sektorin e pasurive të paluajtshme.
Stoku i rezervës valutore, në fund të qershorit 2026 shënoi 7.8 miliardë euro, mjaftueshëm për mbulimin e 7.9 muaj importe mesatare vjetore në mallra dhe shërbime.

Këto zhvillime në pozicionin e jashtëm të ekonomisë dhe performancës relativisht mjaft të mirë të ekonomisë në tërësi janë reflektuar edhe në fondamentin tjetër mjaft të rëndësishëm dhe një ndër ekuilibrat agregat kyç të ekonomisë, atë të kursit të këmbimit. Në pesë vitet e fundit, kursi i këmbimit ka ndjekur një trajektore mbiçmuese, e nxitur nga rritja e flukseve hyrëse në turizëm, remitancave dhe investimeve të huaja direkte. Faktorë të tjerë që kanë kontribuar për këtë trajektore janë rritja e produktivitetit, ndikimi pozitiv i kërkesës së jashtme në sektorin e shërbimeve dhe zvogëlimi i primeve të rrezikut kanë çuar në një tendencë përmirësimi të deficitit të llogarisë korrente e rrjedhimisht në tendencë forcuese të Lekut kundrejt monedhave kryesore, veçanërisht kundrejt Euros që përfaqëson valutën kryesore të shkëmbimeve tregtare.

Kursi mesatar Lek/Euro për periudhën janar-shtator 2026 ishte 94.8 nga 98.24 që ishte mesatarisht gjatë të njëjtës periudhë të 2025, ndërsa Lek/USD ishte 81.6 nga 88.1 që ishte një vit më parë.
Qëndrueshmëria e sektorit financiar, në terma të kapitalizimit, likuiditetit dhe përfitueshmërisë, vazhdon të mbetet një fondament tjetër i fortë i ekonomisë. Kreditë me probleme (NPL) kanë vijuar të ulen duke shënuar në fund të muajit korrik 2026 nivelin prej rreth 3.7 përqind nga rreth 5.0 përqind që shënonin rreth katër vite më parë (fund 2022). Stoku total i kredive bankare në muajin gusht 2026, pati një rritje me 11.8 përqind krahasuar me të njëjtin muaj të vitit 2025. Stoku i kredive në Lekë shënoi një rritje prej 16.6 përqind, ndërsa ai në valutë rritje prej 4.9 përqind, krahasuar me një vit më parë. Kreditimi i sektorit privat të ekonomisë ka pësuar rritje, si për kreditë ndaj bizneseve dhe ndaj konsumatorëve, deri në fund të muajit gusht 2026, ku janë regjistruar rritje respektivisht prej 10.3 përqind dhe 17.2 përqind kundrejt një viti më parë.
Sa i përket depozitave bankare, referuar të dhënave të deritanishme, gjatë muajit gusht të vitit 2026 stoku total i depozitave bankare ka shënuar rritje me 9.78 përqind krahasuar me të njëjtin muaj të të vitit 2025. Stoku total i depozitave në Lekë pësoi rritje me 17.5 përqind, ndërsa ai në valutë është rritur me 3.0 përqind.

Në gusht 2026 rezulton se rreth 50.02 përqind e totalit të stokut të depozitave përbëhet nga depozitat në Lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 49.98 përqind përbëhet nga depozitimet në valutë të huaj.
Inflacioni gjatë vitit 2026 ka qëndruar në nivele të ulëta dhe të qëndrueshme, duke reflektuar normalizimin e çmimeve të mallrave ushqimore në tregjet ndërkombëtare. Sa i përket të dhënave më të fundit të disponueshme, në muajin shtator 2026 ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit është 2.9 përqind, ndërsa një vit më parë ky ndryshim ishte 2.4 përqind. Inflacioni mesatar për nëntëmujorin e parë të 2026 është 2.9 përqind.

1.2 KRAHASIMI ME VENDET E RAJONIT

Bazuar në raportet dhe analizat e institucioneve ndërkombëtare, parashikimet e rritjes për vitin 2026 janë rishikuar me rënie në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, ndikuar nga efektet zinxhir të konfliktit në Lindjen e Mesme, inflacionit të vazhdueshëm dhe rritjes së pasigurisë. Duke reflektuar dinamikën globale dhe rajonale, rritja agregate në Ballkanin Perëndimor u ngadalësua nga 3.7% në vitin 2024, në rreth 2.6% në vitin 2025. Serbia përjetoi ngadalësimin më të fortë, të nxitur nga një sezon i dobët bujqësor, sanksionet në sektorin e naftës, investimet më të ulëta private dhe paqëndrueshmëria politike e brendshme. Rritja gjithashtu u ngadalësua në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Mal të Zi, kryesisht për shkak të performancës së dobët të sektorit industrial, ndërsa në Kosovë pasiguria politike e brendshme ndikoi në vrullin e investimeve dhe dobësimin e reformave. Në të kundërt, rritja mbeti përgjithësisht e qëndrueshme në Shqipëri dhe u përshpejtua në Maqedoninë e Veriut, për shkak të rritjes së konsumit familjar dhe investimeve publike në infrastrukturë.

Konsumi vazhdoi të mbetet burimi kryesor i rritjes në pjesën më të madhe të rajonit për vitin 2025, ndërkohë investimet dhe eksportet ishin relativisht të ulëta. Konsumi u mbështet nga rritja e vazhdueshme e pagave dhe zgjerimi i qëndrueshëm i kredisë, ndërsa çmimet në rritje ushtruan presion mbi të ardhurat reale. Investimet patën një ndikim modest në rritjen ekonomike për vitin 2025, krahasuar me vitin 2024, ndërsa investimet publike kompensuan vetëm pjesërisht nivelet e ulëta të investimeve private. Eksportet neto ishin negative për shkak të kërkesës së jashtme të ulët, megjithëse flukset e eksporteve u rritën në disa vende.

Rritja e punësimit në rajon u ngadalësua ndjeshëm në vitin 2025, duke reflektuar aktivitetin më të dobët ekonomik, rënie në sektorë specifikë dhe kufizimet e vazhdueshme strukturore në krijimin e vendeve të reaj të punës. Rritja mesatare e punësimit u ngadalësua nga 1.8% në vitin 2024, në vetëm 0.1% në vitin 2025. Bujqësia dhe industria ishin sektorët kryesore që penguan punësimin, me një sezon të pafavorshëm bujqësor të shoqëruar nga tkurrja e investimeve private. Ndërsa shërbimet ishin burimi kryesor i rritjes së punësimit, të mbështetura nga turizmi dhe eksportet e shërbimeve. Shkalla e papunësisë tek të rinjtë mbeti e lartë në 25%, mbi mesataren e BE-së prej 14.7%, me Bosnjën dhe Hercegovinën që raporton shkallën më të lartë në rajon me 32.8%, dhe Kosova që regjistroi shkallën më të ulët me 18.4%. Hendeqet gjinore në pjesëmarrjen në fuqinë punëtore variojnë nga 13.3 pikë përqindjeje në Shqipëri, në afërsisht 34 pikë përqindjeje në Kosovë, duke treguar një potencial të konsiderueshëm të nënshfrytëzuar të punës në të gjithë rajonin.

Varfëria vazhdoi të ulej, e mbështetur nga të ardhurat reale më të larta dhe rritja e kreditimit, edhe pse ritmi i reduktimit të varfërisë vazhdoi të ngadalësohej. Shkalla e varfërisë, e matur në kufirin prej 8.3 dollarësh/ditë (PPP 2021), vlerësohet të jetë 14.1% e popullsisë në vitin 2025. Pagat reale në të gjithë rajonin vazhduan të rriteshin, megjithëse me ritëm më të ngadaltë krahasuar me një vit më parë.

Pas një rënieje të ndjeshme në vitin 2024, inflacioni total në të gjithë Ballkanin Perëndimor u rrit në 3.7% në vitin 2025, i nxitur nga çmimet më të larta të ushqimeve, si dhe nga rritja e çmimeve të shërbimeve. Të gjitha vendet në rajon përjetuan një normë më të shpejtë inflacioni në vitin 2025, krahasuar me një vit më parë.

Në vitin 2025, qeveritë e rajonit mbështetën aktivitetin ekonomik përmes rritjes së shpenzimeve publike. Megjithëse të ardhurat arritën nivelin prej 36.2% të PBB-së (niveli më i lartë që nga viti 2012), të mbështetura nga TVSH-ja dhe TAP-i, rritja e shpenzimeve në 38.8% të PBB-së zgjeroi deficitin mesatar fiskal nga 2.1% në 2.6% të PBB-së. Ky trend ishte më i theksuar në Mal të Zi dhe Shqipëri, ku deficitet e tyre fiskale u zgjeruan me rreth 1.0 pikë përqindjeje të PBB-së, në 4.3% dhe 1.7% përkatësisht. Maqedonia e Veriut ishte i vetmi vend që ngushtoi deficitin e saj fiskal, nga 4.5% e PBB-së në vitin 2024, në 4% në vitin 2025. Bilanci fiskal primar mbeti negativ në të gjitha vendet e rajonit, përveç Shqipërisë, e cila regjistroi një suficit për të tretin vit radhazi, megjithëse modest në 0.3% të PBB-së në vitin 2025, nga 1.4% e PBB-së në vitin 2024.

Rritja e PBB-së rajonale parashikohet të ngadalësohet në 2.8% në vitin 2026, mes pasigurisë së shtuar dhe ndikimit negativ të konfliktit në Lindjen e Mesme, përpara se të rikuperohet gradualisht në 3.2% në vitin 2027 dhe 3.7% në vitin 2028. Perspektiva afatshkurtër është përkeqësuar, duke reflektuar kryesisht tensionet gjeopolitike, presionet e jashtme që kanë rritur çmimet e importit dhe pritet të ndikojnë kërkesën në eurozonë, por edhe zhvillimet specifike të vendeve respektive rrit rreziqet e një ritmi më të ngadaltë se sa pritej të zbatimit të reformave.

Tabela 1: ***Produkti i Brendshëm Bruto (rritja vjetore në %, në terma realë)***

	2023	**2024**	**2025**	**2026***
Shqipëria	4.0	4.0	3.9	3.4
Bosnja dhe Hercegovina	2.0	3.2	2.1	2.5
Kosova	4.1	4.6	3.6	3.7
Maqedonia	2.6	3.0	3.5	2.9
Mali i Zi	6.5	3.2	2.7	2.9
Serbia	3.7	3.9	2.0	2.7
Mesatarja e rajonit	3.5	3.7	2.6	2.8

Burimi*:* Raporti i rregullt ekonomik i Ballkanit Perëndimor-Pranverë 2026 *(WB) (*-parashikim)*

Tabela 2: ***Balanca Korrente (% të PBB)***

	2023	**2024**	**2025**	**2026***
Shqipëria	-1.2	-2.4	-0.9	-3.1
Bosnja dhe Hercegovina	-2.1	-3.5	-3.6	-4.1
Kosova	-7.2	-8.4	-9.6	-9.8
Maqedonia	0.3	-2.1	-4.3	-3.8
Mali i Zi	-11.2	-17.1	-20.5	-19.6
Serbia	-2.4	-4.5	-4.9	-4.9
Mesatarja e rajonit	-4.0	-6.4	-7.3	-7.6

Burimi*:* Raporti i rregullt ekonomik i Ballkanit Perëndimor- Pranverë 2026 *(WB)*

Tabela 3: ***Bilanci tregtar i mallrave (% të PBB)***

	2023	2024	2025	2026*
Shqipëria	-5.4	-6.9	-5.4	-7.1
Bosnja dhe Hercegovina	-11.7	-13.4	-13.4	-13.6
Kosova	-35.3	-34.8	-34.3	-36.9
Maqedonia	-13	-12.9	-13.9	-14.1
Mali i Zi	-18.3	-22.5	-26.3	-26.1
Serbia	-4.7	-4.7	-4.7	-6.0
Mesatarja e rajonit	-14.7	-15.9	-16.3	-17.3

***Burimi**:* Raporti i rregullt ekonomik i Ballkanit Perëndimor- Pranverë 2026 *(WB)*

Kufizimet strukturore vazhdojnë të rëndojnë konkurrueshmërinë e rajonit: kostot e punës për njësi tejkalojnë rritjen e produktivitetit, punësimi mbetet i përqendruar në sektorët me produktivitet të ulët dhe tregjet e punës përballen me një paradoks, ku mungesa e fuqisë punëtore bashkëjeton me papunësi të lartë, pjesëmarrje të ulët në fuqinë punëtore dhe migrim të vazhdueshëm jashtë vendit. Shfrytëzimi i potencialit të grupeve të nënpërfaqësuara, veçanërisht grave dhe të rinjve, do të jetë thelbësor për lehtësimin e këtyre kufizimeve, ruajtjen e rritjes afatgjatë dhe qëndrueshmërisë fiskale.

Vendet e Ballkanit janë ndër vendet që po plaken më shpejt në Evropë brenda dekadës së ardhshme, duke intensifikuar mungesën e fuqisë punëtore që tashmë po shfaqet në disa sektorë. Pavarësisht rritjes së niveleve të arsimimit, këto vende vazhdojnë të mos e shfrytëzojnë kapitalin e tyre njerëzor. Pasiviteti i përhapur, nivelet e larta të papunësisë dhe nënpunësimi i përhapur vazhdojnë në të gjithë rajonin, veçanërisht tek gratë dhe të rinjtë. Pjesëmarrja e ulët në fuqinë punëtore dhe nivelet e ulëta të punësimit midis këtyre grupeve përfaqësojnë jo vetëm një sfidë të barazisë, por edhe një mundësi të humbur për të rritur produktivitetin, qëndrueshmërinë dhe rritjen ekonomike.

Tabela 4: ***Norma e papunësisë (në %, mesatare e periudhës)***

	2023	2024	2025	2026*
Shqipëria	9.5	8.5	8.4	n.a
Bosnja dhe Hercegovina	13.2	12.6	12.2	n.a
Kosova	10.9	10.8	n.a	n.a
Maqedonia	13.1	12.4	11.5	n.a
Mali i Zi	13.1	11.4	10.7	n.a
Serbia	9.4	8.6	8.7	n.a

***Burimi**:* Raporti i rregullt ekonomik i Ballkanit Perëndimor- Pranverë 2026 *(WB)*

Tabela 5: ***Balanca e përgjithshme e qeverisë (Deficiti fiskal në % të PBB)***

	2023	2024	2025	2026*
Shqipëria	-1.3	-0.7	-1.7	-1.8
Bosnja dhe Hercegovina	-1.2	-1.8	-2.0	-2.0
Kosova	-0.3	-0.2	-0.7	-1.5
Maqedonia	-4.3	-4.5	-4	-3.6
Mali i Zi	0.6	-3.3	-4.3	-3.7
Serbia	-2.0	-2.0	-2.4	-3.0
Mesatarja e rajonit	-1.4	-2.1	-2.6	-2.6

***Burimi**:* Raporti i rregullt ekonomik i Ballkanit Perëndimor- Pranverë 2026 *(WB)*

Tabela 6: Borxhi publik total *(% të PBB)*

	2023	2024	2025	2026*
Shqipëria	57.6	54.2	52.9	52.7
Bosnja dhe Hercegovina	28.5	27.2	26.8	26.1
Kosova	17.5	17.2	17.1	17.5
Maqedonia	57.8	61.4	59.3	59.4
Mali i Zi	59.9	61.2	65.2	67.5
Serbia	48.4	47.3	45.0	44.9
Mesatarja e rajonit	44.9	44.8	44.4	44.7

***Burimi**:* Raporti i rregullt ekonomik i Ballkanit Perëndimor- Pranverë 2026 *(WB)*

1.3 PARASHIKIMET AFATMESME 2027-2029

Perspektiva makroekonomike e vendit mbetet pozitive, duke reflektuar qëndrueshmërinë e faktorëve bazë të rritjes dhe forcimin gradual të aktivitetit ekonomik në horizontin afatmesëm. Rritja ekonomike parashikohet në normën 4.0 përqind për vitin 2026, e mbështetur nga kushtet e favorshme ekonomike, performanca e qëndrueshme e sektorit të shërbimeve, veçanërisht turizmi, si dhe zgjerimi i konsumit privat dhe investimet në ndërtim e infrastrukturë. Në periudhën afatmesme 2027-2029, rritja parashikohet të ruajë trajektore pozitive, me një normë mesatare prej rreth 4.0 përqind në vit, e mbështetur nga dinamika e kërkesës së brendshme, zhvillimi i mëtejshëm i sektorëve strategjikë dhe pritshmëritë për një rikuperim gradual të ekonomisë globale dhe veçanërisht atë të Bashkimit Evropian. Kontributi kryesor në rritjen ekonomike do të vijojë nga konsumi privat, i cili pritet të mbetet nxitësi kryesor i zgjerimit të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), stimuluar kryesisht nga përmirësimi i besimit të konsumatorit, si dhe nga përmirësimi në tregun e punës. Rritja graduale e pagave, në kushtet e një inflacioni të stabilizuar, pritet të stimulojnë të ardhurat reale të disponueshme të individëve, duke kontribuar më tej në qëndrueshmërinë e kërkesës së brendshme dhe të rritjes ekonomike.

Nga ana tjetër, rritja graduale e investimeve private dhe publike pritet të nxitet nga një shfrytëzim më i intensifikuar i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit, përshpejtimi i aktivitetit ekonomik gjatë periudhës së parashikuar, si dhe nga perceptimi i përmirësuar i biznesit mbi perspektivën ekonomike afatmesme e afatgjatë. Njëkohësisht edhe përmirësimi sërish i kushteve financiare dhe lehtësimi i standardeve të huadhënies gradualisht përgjatë afatit të mesëm, priten të jenë faktorë të rëndësishëm incentivues të investimeve private.

Specifikisht, konsumi final total për periudhën afatmesme 2027 – 2029 parashikohet të rritet në terma real me mesatarisht rreth 2.8 përqind në vit, duke kontribuar me mesatarisht rreth 2.2 pikë përqindje në vit në rritjen e PBB-së. Ndërsa investimet totale në ekonomi parashikohen të rriten në terma real mesatarisht në rreth 5.6 përqind në vitet 2027-2029, me një kontribut mesatar në rritjen totale prej rreth 1.4 pikë përqindje në vit.

Kërkesa e huaj neto pritet të ketë një kontribut pozitiv të moderuar në periudhën afatmesme. Eksportet e mallrave pritet të ruajnë trendin pozitiv, ndërsa eksportet e shërbimeve, veçanërisht shërbimet turistike, do të vijojnë të jenë një burim i rëndësishëm i të ardhurave valutore dhe të jenë elementi kryesor për të kompensuar kontributin negativ të ardhur prej rritjes së importeve. Në terma realë, sa i takon më specifikisht komponentëve të kërkesës së huaj neto, eksportet totale të mallrave dhe shërbimeve parashikohen të rriten me mesatarisht rreth 4.3 përqind në vit, me një kontribut mesatar pozitiv prej rreth 1.6 pikë përqindje në vit në rritjen e PBB-së. Ndërsa importet totale të mallrave dhe shërbimeve për këtë periudhë afatmesme parashikohen të zgjerohen me mesatarisht rreth 3.3 përqind në vit me një kontribut mesatar negativ në

rritjen e PBB-së me rreth 1.4 pikë përqindje në vit. Rrjedhimisht, në terma neto kërkesa e huaj parashikohet të ketë një kontribut të moderuar pozitiv në rritjen totale të PBB-së me mesatarisht rreth 0.2 pikë përqindje në vit.

Nga pikëpamja e ofertës agregate, parashikohet që të gjithë sektorët kryesorë të ekonomisë të vijojnë me ritmet e tyre të rritjes, duke ndjekur përafërsisht të njëjtin trend me mesataren e tyre historike. Specifikisht për periudhën afatmesme 2027-2029, sektori i "*Shërbimeve*" i mbështetur nga turizmi dhe teknologjia e informacionit, pritet të jetë nxitësi kryesor i rritjes ekonomike, me një rritje mesatare vjetore prej rreth 5.4 përqind dhe një kontribut mesatar vjetor prej rreth 2.8 pikë përqindje; sektori i "*Ndërtimit*" parashikohet me rritje mesatare vjetore prej rreth 3.1 përqind, i mbështetur nga investimet publike dhe private dhe me një kontribut mesatar vjetor prej rreth 0.4 pikë përqindje; sektori i "*Industrisë*" parashikohet me një rritje mesatare vjetore prej rreth 2.6 përqind dhe një kontribut mesatar vjetor prej rreth 0.2 pikë përqindje; "Bujqësia" pritet të mbetet relativisht e qëndrueshme, me një rritje me rreth 0.2 përqind në vit, duke qenë neutrale sa i takon kontributit në rritjen ekonomike.

Tabela 7

Treguesit kryesorë makroekonomikë

Treguesit	Njësia	2022	2023	2024	2025	2026 Para.	2027 Para.	2028 Para.	2029 Para.
Popullsia	Milion	2.4	2.4	2.4	2.4	2.4	2.4	2.4	2.3
Inflacioni (mesatar)	%	6.7	4.8	2.2	2.2	2.9	3.0	3.0	3.0
Deflatori i PBB	%	10.0	5.7	2.3	1.5	1.4	1.2	1.2	1.2
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	113.0	100.6	93.1	86.8	82.2	82.2	82.2	82.2
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	119.0	108.8	100.7	97.8	96.2	96.2	96.2	96.2
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit te Fuqisë Blerese (PPP)	Lek / USD	39.8	40.6	39.7	39.7	39.7	39.7	39.7	39.7
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit te Fuqisë Blerese (PPP)	Lek / Euro	64.2	63.2	63.2	63.2	63.2	63.2	63.2	63.2
Rritja reale e PBB	%	4.5	4.0	4.0	3.7	4.0	3.9	4.1	3.9
PBB	Lek miliardë	2,150.6	2,365.2	2,517.3	2,648.5	2,790.4	2,934.5	3,092.2	3,252.1
PBB	USD miliardë	19.0	23.5	27.0	30.5	33.9	35.7	37.6	39.5
PBB	Euro miliard	18.1	21.7	25.0	27.1	29.0	30.5	32.1	33.8
PBB për banor	Lek mijë	879.9	984.6	1,051.2	1,110.0	1,174.1	1,240.2	1,312.6	1,386.3
PBB për banor	USD	7,784.0	9,783.2	11,292.5	12,787.1	14,277.5	15,081.8	15,961.2	16,858.3
PBB për banor	Euro	7,395.5	9,049.9	10,437.9	11,344.1	12,199.2	12,886.3	13,637.8	14,404.3
PBB për banor	USD-PPP	22,109.4	24,258.5	26,492.9	27,972.8	29,589.2	31,255.9	33,078.5	34,937.7
PBB për banor	Euro-PPP (EU=27)	13,714.2	15,587.9	16,622.3	17,550.8	18,564.9	19,610.6	20,754.2	21,920.7
Shkalla e papunësisë (15-64 vjec)	%	11.3	10.1	9.4	9.3	9.0	8.8	8.5	8.3
Shkalla e papunësisë (15+ vjec)	%	10.9	9.5	8.5	8.4	8.1	7.9	7.6	7.4
Të ardhurat totale	% të PBB	26.6	27.2	28.2	28.5	30.2	30.9	30.9	30.5
Shpenzimet totale	% të PBB	30.3	28.5	28.9	30.3	32.5	33.3	33.0	32.3
Bilanci i përgjithshëm	% të PBB	-3.6	-1.3	-0.7	-1.8	-2.3	-2.3	-2.1	-1.8
Bilanci primar fiskal	% të PBB	-1.8	0.7	1.4	0.3	0.0	0.0	0.3	0.7
Bilanci korrent fiskal	% të PBB	1.6	3.7	3.9	3.2	4.0	4.5	4.7	4.4
Borxhi publik NETO nga gjendja e likuiditetit në TSA (Neto)	% të PBB	63.4	55.6	51.9	49.9	49.8	49.8	49.7	49.4
Borxhi Publik (Bruto)	% të PBB	64.1	57.6	54.2	52.9	52.5	52.4	52.3	52.1
Borxhi publik i qeverise se pergjithshme	% të PBB	61.7	55.9	52.9	51.8	51.3	51.2	50.7	50.3
I Brendshem	% të PBB	33.1	30.7	30.8	31.1	31.3	31.4	31.1	30.9
I Huaj	% të PBB	28.5	25.2	22.1	20.7	20.0	19.8	19.5	19.4
Borxhi publik jashte treguesve fiskale	% të PBB	2.4	1.8	1.3	1.1	1.2	1.2	1.6	1.8
Bilanci I llogarisë korrente	% të PBB	-6.2	-1.7	-2.4	-0.7	-0.3	-2.1	-1.7	-1.9
Bilanci tregtar (Mallra & Shërbime)	% të PBB	-10.6	-5.9	-6.9	-5.5	-5.7	-6.2	-5.7	-5.7
Mallra	% të PBB	-23.9	-21.3	-22.4	-22.0	-22.3	-22.6	-22.2	-22.2
Eksporte	% të PBB	10.4	8.0	6.7	5.8	6.4	6.5	6.6	6.6
Importe	% të PBB	-34.3	-29.3	-29.1	-27.8	-28.7	-29.1	-28.8	-28.8
Bilanci i pagesave	% të PBB	-0.4	4.3	1.1	4.2	4.8	2.1	2.7	2.3
Rezervat valutore	Euro milion	4,952.1	5,847.0	6,263.9	7,309.0	8,708.0	9,342.2	10,214.7	10,987.2
Në muaj importi mallrash e shërbimesh	Muaj	6.9	7.3	7.0	7.6	8.2	8.3	8.7	8.9

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Banka Botërore, Eurostat

2. TREGUESIT KRYESORË TË BUXHETIT PËR VITIN 2027

2.1 PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE PËR VITIN 2027

Programimi i të ardhurave për vitin 2027, mbështet synimet e Ministrisë së Financave për rritjen e të ardhurave nëpërmjet mirëadministrimit tatimor e doganor, realizimin e reformave/investimeve të rëndësishme buxhetore të qeverisë si dhe mbajtjen nën kontroll të defiçitit buxhetor dhe borxhit publik. Ky program bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi si dhe në faktorët që do impaktojnë këtë periudhë dhe risqet e mundshme që mund të shfaqen.

Në programimin e të ardhurave nga Tatimet dhe Doganat për vitin 2027, janë marrë në konsideratë faktorët kryesorë me ndikim në buxhet, përfshirë efektin e rritjes ekonomike dhe indeksit të çmimeve, efektet e politikave të mëparshme dhe të reja tatimore dhe buxhetore, efektet nga zbatimi i masave të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave dhe Plani i Veprimit (SAA), 2024-2027, për vitin 2027 e shoqëruar kjo me masa kundër informaltetit, me qëllim rritjen e nivelit të pajtimit vullnetar të tatimpaguesit me ligjin.

Në vitin 2027, **të ardhurat nga "Tatimet dhe Doganat**" parashikohet të jenë **583.5 miliardë lekë, me një rritje prej 46,86 miliardë lekë krahasuar me të ardhurat e pritshëme për vitin 2026 nga "Tatimet dhe Doganat", ose me një rritje prej 8.7 %.**

Të ardhurat nga **Kontributet shoqërore dhe shëndetësore** parashikohen të jenë 210.3 miliardë lekë, me një rritje prej 9.1 miliardë lekë krahasuar me të ardhurat nga Kontributet sipas parashkikimit të pritshëm të të ardhurave për vitin 2026, ose **me një rritje prej 4.5%.**

Metodologjia e programimit të të ardhurave është bazuar në modelin e programimit që përdoret prej kohësh nga Ministria, si dhe në analizën e detajuar të faktorëve që ndikojnë në secilën taksë dhe tatim. Modeli i përdorur bazohet në parashikimet makroekonomike për vitin 2027, të tilla si: rritja nominale, deflatori, kombinuar me faktorë të tjerë që ndikojnë në pritshmëritë e të ardhurave, shpjeguar më poshtë, si dhe analizën e serive kohore për çdo taksë.

Të ardhurat tatimore dhe doganore, përfshirë edhe kontributet janë parashikuar bazuar në këto elementë:

1) Kuadri makroekonomik me rritjen reale të Prodhimit të Brendshëm Bruto 3.9%;
2) Inflacioni i parashikuar 3%;
3) Efekte nga zbatimi i masave të politikave tatimore dhe buxhetore të mëparshme;
4) Efektet e masave tatimore (Paketa fiskale 2027) dhe buxhetore, për vitin 2027;
5) Efektet në të ardhura nga zbatimi i masave të parashikuara në SAA, për vitin 2027;
6) Efekte +/- nga korektime bazuar në faktorë të tjerë.

Në planifikim janë harmonizuar faktorët makroekonomikë, me treguesit kryesorë që ndikojnë në taksa specifike. Në mënyrë të detajuar treguesit kryesore për programimin e të ardhurave janë:

- Rritja nominale të PBB-së, duke analizuar këtë efekt në mënyrë të integruar me faktorë të tjerë për çdo taksë në veçanti, të ndërlidhur me të dhënat historike dhe projeksionet e çmimeve në tregjeve ndërkombëtare tek taksat ad-valorem si Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, Renta Minerare dhe Taksa Doganore.
- Kursi i këmbimit të dy monedhave kryesore: USD dhe EURO me Lekun.

- Të ardhurat nga akciza për karburantet, cigaret, pijet etj, si rezultat i sasisë së pritshme të tyre.

Në mënyrë të përmbledhur për të ardhurat nga tatimet dhe doganat, përfshirë edhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të mbledhura, janë paraqitur si në tabelën më poshtë.

Tabela 8: **Treguesit makro 2027** sipas kuadrit makroekonomiko-fiskal

(në milionë lekë)

1	PBB 2027	2,934,532
2	Rritja ekonomike reale	3.9%
3	Koeficienti i elasticitetit (KE)	70%
4	Rritja e të ardhurave nga rritja ekonomike 3.9 % x 70 %	2.73%
5	Inflacioni 2026	3%
6	Rritja e te ardhurave nga indeksi i cmimeve 3%*70%	2.1%

Për vitin 2026 të ardhurat nga tatimet dhe doganat parashikohen ne masen 536.2 miliardë lekë ndersa nga kontributet ne masen 210.2 miliardë lekë, bazuar në ecurinë e të ardhurave.

I. Parashikimi i të ardhurave sipas zërave për vitin 2027 nga Tatimet dhe Doganat

Bazuar në parashikimin e pritshëm të të ardhurave për vitin 2026, është kryer parashikimi për vitin 2027, për të ardhurat nga tatimet dhe doganat.

Sipas metodologjisë, mbi bazën e të ardhurave të pritshme për 2026, janë zbatuar:

- Efektet nga treguesit e rritjes ekonomike për të gjitha llojet e taksave në masën 2.73%, me efekt në të ardhura rreth 13.3 miliardë lekë;
- Efektet nga indeksimi në masën 2,1% për tvsh-në dhe taksën doganore, me efekt në të ardhura 5.4 miliardë lekë;
- Efekte nga zbatimi i masave fiskale buxhetore të mëparshme në vlerën 1.4 miliardë lekë;
- Efektet e masave fiskale buxhetore për vitin 2027, me rreth 4.4 miliardë lekë;
- Efektet nga zbatimi i masave të përcaktuara në SAA, për vitin 2027, me rreth 10 miliardë lekë;
- Efekte nga korektime bazuar në faktorë të tjerë në vlerën e 12.8 miliardë lekë.

Totali i të ardhurave	**Plani 2026 - One Off**	**Rritja ekonomike**	**Inflacion / Indeksimi**	**Masa fiskale te meparshme me efekt ne 2027**	**Masat fiskale/ buxhetore viti 2027**	**Te ardhurat nga MTRS 2027**	**Korektime bazuar ne faktore te tjere**	**Total Viti 2027**	**Dif 2027/2026**	**Përqindja e Rritjes 2027/2026**
		2.73%	2.1%							
Te ardhurat nga tatimet dhe Doganat	**536,227**	**13,293**	**5,457**	**1,381**	**4,373**	**10,007**	**12,775**	**583,514**	**46,861**	**8.7%**

II. Parashikimi për vitin 2027 për të ardhurat nga Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

Bazuar në parashikimin e pritshëm të të ardhurave për vitin 2026, është kryer parashikimi për vitin 2027, për të ardhurat nga kontributet. Sipas metodologjisë, mbi bazën e të ardhurave të pritshme për 2027, janë zbatuar:

- Efektet nga treguesit e rritjes ekonomike, me rreth 5.4 miliardë lekë;
- Efektet e masave fiskale dhe buxhetore për vitin 2027, me rreth 2.3 miliardë lekë;
- Efektet nga zbatimi i masave të përcaktuara në SAA, për vitin 2027, me rreth 2.7 miliardë lekë;
- Efekte nga korektime bazuar në faktorë të tjerë në vlerën e 2.1 miliardë lekë.

Totali i të ardhurave	I pritshmi viti 2026-one off	Rritja ekonomike 2.73%	Inflacion / Indeksimi 2.10%	Masat fiskale të mëparshme me efekt në vitin 2027	Masat fiskale/ Buxhetore viti 2027	Të ardhurat nga MTRS 2027	Korrektime bazuar në faktorë të tjerë	Parashikim 2027	Dif 2027/2026	Përqindja e Rritjes
Të ardhurat nga Kontributet	**197,747**	**5,398**	**-**	**-**	**2,281**	**2,729**	**2,149**	**210,304**	**9,132**	**4.5%**

III. Të ardhurat nga tatimet dhe doganat

1. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

Të ardhurat nga "T.V.SH-ja neto" për vitin 2027 parashikohet të jenë rreth 275.4 miliardë lekë, ose 25.5 miliardë lekë ose 10.2% më shumë se pritshmëria e vitit 2026 që pritet të jetë në vlerën 249.9 miliardë lekë. TVSH-ja në vitin 2027 përfshin:

- Rritjen e të ardhurave nga TVSH që gjeneron rritja ekonomike shtesë 6.8 miliardë lekë dhe indeksi i çmimeve në masën 5.2 miliardë lekë;
- Efekte nga zbatimi i masave tatimore të mëparshme në vlerën -1.5 miliardë lekë (skema e kompensimit të fermerit);
- Efektet e Paketës Fiskale 2027 dhe masave buxhetore për vitin 2027, në masën 3.7 miliardë lekë;
- Efektete nga zbatimi i masave të SAA për mirëadminstrimin e TVSH-së, për vitin 2027 në masën 4.5 miliardë lekë;
- Efekte nga korektime bazuar në faktorë të tjerë në vlerën e 7.3 miliardë lekë nga të cilat 3.5 miliardë lekë, të tilla si efektet në tvsh nga investimet e mëdha që priten të realizohen në vitin 2027 si tvsh nga investimi i SMAT City(1 miliard lekë), trajtimi i mbetjeve nga projekti i i KFË (138 milion lekë dhe, ndërtimi i hekurudhës (300 milion lekë), si dhe invetimet e tjera në rreth 2.4 miliardë lekë, si dhe nga rritja e konsumit si rezultatat i masave të politikës tatimore 2027

2. Tatimi mbi Fitimin

Për vitin 2027, të ardhurat nga "Tatimi mbi Fitimin" parashikohen të jenë rreth 62.1 miliardë lekë, ose 5.1 miliardë lekë ose 9% më shumë se pritshmëria e vitit 2026 që pritet të jetë në vlerën 56.9 miliardë lekë.

Parashikimi i tatimit mbi fitimin për vitin 2027 bazohet në:

- Rritjen e të ardhurave që gjeneron rritja ekonomike shtesë në masën 1.5 miliardë lekë;
- Të ardhura nga zbatimi i masave të SAA nga mirëadministrimi i këtij tatimi për vitin 2027, në shumën 3.5 miliardë lekë.
- Efekte nga korektime bazuar në faktorë të tjerë në vlerën 1 miliardë lekë.

3. Akciza

Të ardhurat nga "Akciza" për vitin 2027 programohen në masën 80.6 miliardë lekë, + 6.9 miliardë lekë ose +9.4% më shumë se i pritshmi i vitit 2026 prej 73.7 miliardë lekë. Faktorët kryesorë në parashikimin e të ardhurave nga akciza lidhen kryesisht me konsumin e karburanteve, produkteve të duhanit të cilat kanë trend pozitiv si dhe nga disa faktorë të tjerë si:

- Rritjen e të ardhurave nga akciza që gjeneron rritja ekonomike në masën 2 miliardë lekë;
- Rritja e të ardhurave nga efektet e Politikës Fiskale e vitit 2027 në masën e 3.4 miliardë lekë (rritja e akcizës së duhaneve dhe njësia matëse e biodiezelit);
- Efekte nga korektime bazuar në faktorë të tjerë në vlerën e 1.5 miliardë lekë.

4. Tatim mbi të ardhurat personale

Për vitin 2027, të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale (TAP) parashikohen në shumën rreth 107.4 miliardë lekë, me një rritje prej 10.3% ose 10 miliardë lekë më shumë se i pritshmi i vitit 2026 prej 97.3 miliardë lekë.

Në parashikimin e të ardhurave janë marrë në konsideratë:

- Rritja e të ardhurave që gjeneron rritja ekonomike në masën 2.7 miliardë lekë;
- Efekte nga zbatimi i masave fiskale të mëparshme në vlerën 0.6 miliardë lekë, nga të ardhurat nga qeraja
- Rritja e të ardhurave nga efektet e Paketës fiskale 2027 dhe masave buxhetore të vitit 2027, në masën 2.3 miliardë lekë;
- Të ardhura nga mirëadministrimi e parashikuar në SAA për vitin 2027, me rreth 2 miliardë lekë shtesë.
- Efekte nga faktore të tjerë në vlerën 2.5 miliardë lekë.

5. Taksa Nacionale dhe të tjera

Të ardhurat nga "Taksa Nacionale dhe të tjera" për vitin 2027, parashikohen të jenë rreth 46.5 miliardë lekë. Për vitin 2026, të ardhurat nga ky zë pritet të arrijnë në 48.3 miliardë lekë, duke reflektuar një renie me 1.8 miliarde lek ose -3.6% për vitin 2027.

Në parashikimet për këtë taksë për vitin 2027 janë marrë në konsideratë:

- Efekte nga zbatimi i masave fiskale të mëparshme në vlerën 2.3 miliardë lekë, dhe konkretisht në masën 2 miliardë lekë nga zbatimi i akteve nëligjore në fushën e lojrave të fatit dhe zbatimi i kalendarit të rritjes së taksë së karbonit për qymyrin nga 4,5 lek/kg që është në 2026 në 6.5 lekë/kg nga 1 janar 2027;

- Efekti minus 5 miliardë lekë nga politika tatimore e rishkimit të taksimit të makinave elektrike dhe heqjes së taksës së qarkullimit prej 27 lekë litri për karburantet.

6. Taksat Doganore

Të ardhurat nga "Taksa Doganore" në vitin 2027 programohet në vlerën 11.5 miliardë lekë, me rritje 1 miliardë lekë ose 9.1% më shumë se i pritshmi për vitin 2026.

Në programimin e të ardhurave për vitin 2027 janë marrë në konsideratë:

- Efektet e rritjes ekonomike në masën 285 milionë lekë;
- Indeksimi në masën 219 milionë lekë, si dhe;
- Efekte nga korektime bazuar në faktorë të tjerë në vlerën e 0.6 miliardë lekë.

7.Të ardhurat nga Kontributet

Të ardhurat nga "Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore" për vitin 2027 janë programuar të jenë 210.3 miliardë lekë, +9.1 miliardë lekë ose 4.5% më shumë krahasuar me pritshmërinë për vitin 2026.

Rritja e programuar e të ardhurave për vitin 2027 mbështetet në këto faktor:

- Të ardhura nga rritja ekonomike në masën 5.4 miliardë lekë,
- Efekti nga masat fiskale dhe buxhetore të vitit 2027 në masën 2.3 miliardë lekë;
- Të ardhura shtesë nga zbatimi i masave në SAA, për vitin 2027, në masën 2.7 miliardë lekë;
- Efekte nga korektime bazuar në faktorë të tjerë në vlerën e 2.1 miliardë lekë

Tabelat më poshtë përmbledhin, të ardhurat sipas zërave, për vitin 2025, i pritshmi për vitin 2026 dhe parashikimi për vitin 2027.

Tabela 9 ***(në milionë lekë)***

Lloji i taksave	Fakt 2025	I Pritshmi 2026	Projeksioni 2027
TVSH Neto	227,261	249,901	275,449
Tatimi mbi fitimin	58,547	56,943	62,090
Akciza	69,599	73,660	80,573
Tatimi mbi të ardhurat personale	82,532	97,323	107,367
Taksat Nacionale	48,799	48,296	46,547
Taksë doganore	9,486	10,529	11,487
TOTAL TATIME + DOGANA	**496,225**	**536,653**	**583,514**
Kontributet shoqërore dhe shëndetësore	178,209	201,172	210,304
TOTALI	**674,433**	**737,825**	**793,818**

Burimi: Ministria e Financave (2026)

Tabela 10

Lloji i taksave	I Pritshmi 2026	Projeksioni 2027	Ndryshimi në vlerë	Ndryshimi në %
TVSH Neto	249,901	275,449	25,548	10.2%
Tatimi mbi fitimin	56,943	62,090	5,147	9.0%
Akciza	73,660	80,573	6,913	9.4%
Tatimi mbi të ardhurat personale	97,323	107,367	10,045	10.3%
Taksat Nacionale	48,296	46,547	-1,750	-3.6%
Taksë doganore	10,529	11,487	958	9.1%
TOTAL TATIME + DOGANA	**536,653**	**583,514**	**46,861**	**8.7%**
Kontributet shoqërore dhe shëndetësore	201,172	210,304	9,132	4.5%
TOTALI	**737,825**	**793,818**	**55,993**	**7.6%**

Burimi: Ministria e Financave (2026)

2.2 SHPENZIMET PUBLIKE

Totali i shpenzimeve publike për vitin 2027 është planifikuar **976.06 miliardë lekë** ose **33.3% e PBB**.

Shpenzimet e personelit për vitin 2027, reflektojnë koston aktuale të Administratës Publike. Shpenzimet totale për pagat në Administratën Publike në nivel qendror për **87.887** punonjës planifikohen në masën **148.5 miliardë lekë** ose **5.1% e PBB.**

Shpenzimet për interesa parashikohen në nivelin **68.3 miliardë lekë** ose **2.3% të PBB,** duke përfshirë në të dhe një rezervë prej 6.85 miliardë lekë për të mitiguar risqet e mundshme nga luhatjet e normave të interesit, kursit të këmbimit etj.

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për qeverisjen qendrore për vitin 2027 (*pa përfshirë shpenzimet që realizohen nga institucione publike, që kanë si burim financimi të ardhurat jashtë limitit*), janë parashikuar në masën **85.1 miliardë lekë** ose rreth **2.9% e PBB-së**. Në këtë zë është programuar mbështetja me prioritet e politikave ekzistuese dhe të reja të qeverisjes qendrore si: skema e fermerëve, mirëmbajtja e rrugëve nacionale, mirëmbajta e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe siguria kibernetike, programet e nxitjes së punësimit, skemat për mbështetjen e zhvillimit ekonomik, dhe mbështetje direkte përmes rritjes së bursës për studentët në nevojë.

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2027 parashikohen në **114.6 miliardë lekë**, ose **2.4%** më shumë se në vitin 2026. Këto shpenzime për vitin 2027 zënë **3.9%** të PBB-së, në të njëjtin nivel me vitin 2026, kundrejt **2.3% të PBB-së** në vitin 2015. Transferta e pakushtëzuar për vitin 2027 rritet me **1.4 miliardë lekë** ose **5.1%** ndaj vitit 2026, ndërsa krahasuar me vitin 2015 është **16.9 miliardë lekë më shumë, ose mbi dy herë më e lartë**. Nëse e krahasojmë me buxhetin fillestar të vitit 2026, transferta e pakushtëzuar në vitin 2027 rritet në shumën 1.5 miliardë lekë, ose 6% më e lartë. Ky financim synon të mbështesë procesin

e decentralizimit dhe zbatimin e reformës së re administrativo territoriale, duke forcuar kapacitetet administrative dhe ofrimin e shërbimeve vendore.

Shpenzimet e fondeve speciale që përfshin shpenzimet totale për Fondet e Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe kompensimin në vlerë të ish-pronarëve, janë planifikuar në vlerën prej **313.9 miliardë lekë.** Niveli i shpenzimeve për *Skemën e Sigurimeve Shoqërore* për vitin 2027, parashikohet në masën **215.6 miliardë lekë** ose **7.3% e PBB**. Nga ky fond, për indeksimin e pensioneve është parashikuar niveli prej **4 miliardë lekë** dhe **20 miliardë lekë** për bonusin mujor për pensionistët. Ndërsa, shpenzimet e *Skemës së Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor* për vitin 2027 janë parashikuar në masën **70.8 miliardë lekë** ose **2.4% e PBB** .
Së fundi, shpenzimet për **Fondin e Kompensimit në vlerë të Pronarëve** parashikohen në total në masën **3.5 miliardë lekë** ose 0.1% e PBB.

Shpenzime të tjera sociale, përfshin fondet për pagesën e papunësisë, aftësisë së kufizuar, ndihmës ekonomike, dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë dhe bonusin e lindjeve.

- Shpenzimet për pagesën e papunësisë parashikohen në nivelin **1 miliardë lekë**;
- Shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar parashikohen në nivelin **27.2 miliardë lekë** ose 0.9% e PBB.
- Për ish-të përndjekurit është parashikuar një fond prej **2 miliardë lekë** ose 0.1% e PBB.
- Për bonusin e lindjeve është parashikuar një fond prej **2.8 miliardë lekë** ose 0.1% e PBB.

Shpenzimet për subvencione janë parashikuar në masën **2.45 miliardë lekë** ose rreth 0.1% e PBB. Subvencionet shtetërore për vitin 2027 janë përqëndruar në financimin e skemave të nxitjes së punësimit, mbështetjen e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve bazuar në performancën e tij, si dhe në mbulimin e një pjese të shpenzimeve të veprimtarisë hekurudhore dhe veprimtarisë së shërbimeve qeveritare.

Investimet Publike për vitin 2027 janë planifikuar në masën **6.8% e PBB** ose **200.3 miliardë lekë** (*duke përfshirë këtu dhe fondin e rindërtimit në shumën 2 miliardë lekë dhe 14.1 miliardë lekë financime të pritshme mbi bazë projektesh nga Plani i Rritjes me BE)*. Në planifikimin e investimeve për vitin 2027 janë mbajtur në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet e investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm dhe do të ketë përparësi financimi i projekteve në vazhdim. Në raport me buxhetin e rishikuar të vitit 2026, vëllimi i investimeve publike në vitin 2027 parashikohet me rreth **24.1 miliardë lekë më shumë**.

Niveli i Fondit Rezervë dhe Kontingjencës për vitin 2027, planifikohet në masën **5.8 miliardë lekë** ose **0.2% e PBB.**

2.3 DEFIÇITI BUXHETOR

Vitet e fundit, defiçiti buxhetor në Shqipëri ka ndjekur një trajektore rënëse pas periudhës së pandemisë, duke reflektuar përmirësimin e disiplinës fiskale dhe konsolidimin e mëtejshëm të financave publike. Ky

zhvillim pasqyron angazhimin për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe të qëndrueshmërisë fiskale, si parakushte thelbësore për mbështetjen e rritjes ekonomike afatgjatë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Konsolidimi fiskal vijon të jetë objektivi themelor i politikës fiskale për periudhën afatmesme 2027-2029, në funksion të ruajtjes së stabilitetit të financave publike dhe të uljes graduale të borxhit publik.

Me synimin për të ruajtur qëndrueshmërinë e financave publike dhe forcimin e besueshmërisë së politikës fiskale në perceptimin e tregjeve dhe partnerëve ndërkombëtar, politika fiskale do të synojë ruajtjen e një trajektoreje të qëndrueshme dhe rënëse të borxhit publik, ndërsa balanca primare do të jetë së paku neutrale ose në nivel pozitiv, duke përbërë objektivin kryesor operacional që do të ankorojë politikën fiskale në afatin e mesëm dhe të gjatë, në përputhje edhe me rregullat fiskalë të përcaktuara në Ligjin Organik të Buxhetit (LOB).

Në të njëjtën kohë, krahas konsolidimit fiskal, synojmë që të ruajmë një raport të shëndetshëm të shpenzimeve buxhetore korrente dhe kapitale, me qëllim që të garantohet hapësira e nevojshme për investimet publike me ndikim në rritjen ekonomike. Për periudhën 2027-2029, shpenzimet kapitale (pra, investimet publike) do të targetohen të jenë mesatarisht rreth 6.6 përqind e PBB-së në çdo vit buxhetor, duke përfshirë edhe investimet e reja publike që potencialisht do të mundësohen në kuadër të Planit të Ri të Rritjes të Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor, i cili synon nxitjen e një rritje potenciale më të lartë dhe konvergjencë më të shpejtë me ekonomitë e BE-së.

Deficiti buxhetor për vitin 2027 planifikohet të qëndrojë në nivelin 2.3 përqind të PBB-së, duke qëndruar në të njëjtin nivel me atë të pritshëm për vitin 2026. Balanca primare pritet të rezultojë e balancuar në vitin 2027, në zbatim me rregullin fiskal të parashikuar në LOB që përcaktohet se, duke filluar nga viti buxhetor 2024 e për çdo vit në vijim, balanca primare nuk mund të rezultojë negative (pra së paku e balancuar ose pozitive).

Kuadrat shpjegues 1: Balanca primare, ankora kryesore e politikës fiskale

Balanca primare përbën një parametër thelbësor të qendrueshmërisë afatgjatë të financave publike, për të cilën, në Korrik 2020, u ndërmor një nismë e rëndësishme ligjore për forcimin e kuadrit fiskal, duke përfshirë një rregull të ri fiskal në LOB, në linjë edhe me rekomandimet e Komisionit Europian dhe me parimet kryesore të "acquis communautaire" të BE-së. Ky rregull përcakton se, duke filluar nga viti buxhetor 2024 e në vijim, balanca primare faktike nuk mund të rezultojë negative, pra duhet të jetë së paku e balancuar ose pozitive (suficit primar). Ky target i parametrit të balancës primare buxhetore përbën tashmë dhe në vijimësi objektivin kryesor operativ të politikës fiskale për të materializuar synimin e një trajektore vijimësisht rënëse të borxhit publik, pra duke synuar konsolidim të vijueshëm fiskal me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë së financave publike si një fondament kyç i stabilitetit makroekonomik dhe mbarë-vajtjes së ekonomisë së vendit.

Balanca korrente fiskale (diferenca ndërmjet investimeve publike dhe deficitit fiskal) do të jetë pozitive edhe gjatë vitit 2027, në nivelin prej 4.5 përqind të PBB-së, nga 4.0 përqind që pritet të jetë në vitin 2026, në përputhje kjo me rregullin respektiv fiskal (rregullin "e artë" të buxhetit). Gjithashtu, borxhi publik bruto do të vijojë trajektoren rënëse në përputhje me rregullin respektiv fiskal (rregullin "borxh-frenues" të qëndrueshmërisë së borxhit publik). Në vitin 2026 parashikohet që borxhi publik bruto të ulet në rreth 52.5 përqind të PBB-së dhe pritet të vijojë të jerë më tej në rreth 52.4 përqind në vitin 2027. Sipas skenarit bazë, borxhi publik bruto pritet të bjerë në rreth 52.1 përqind deri në vitin 2029 dhe më tej në rreth 50.9 përqind në vitin 2031.

Shtojcë: Pajtueshmëria me rregullat fiskale

Në përputhje të plotë me detyrimet që rrjedhin nga Ligji Organik i Buxhetit (LOB) Nr. 9936/2008, i ndryshuar, ligji i buxhetit 2027, ku projeksionet shtrihen deri në vitin 2029, materializon parimet dhe rregullat fiskale të mëposhtme:

1. *Rregulli i "Qëndrueshmërisë së borxhit":* *Në çdo ligj vjetor të buxhetit, fillestar apo të rishikuar, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe të qëndrojë poshtë nivelit 45 për qind të PBB-së.*

Në përputhje me këtë rregull fiskal të LOB-së, ligji i buxhetit 2027 (-2029) ***targeton çdo vit një nivel të borxhit publik total (bruto) në përqindje të PBB-së më të ulët se niveli i vitit pararendës.***

2. *Rregulli i "Balancës primare":* *Duke filluar që prej vitit buxhetor 2024 e në vijim, balanca primare buxhetore nuk mund të jetë negative, duhet të jetë së paku zero ose pozitive (tepricë primare).*

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull të ri fiskal) të LOB, ***balanca primare në ligjin e buxhetit 2027 (-2029) targeton një balancë primare të balancuar ose pozitive***.

3. *"Rregulli i artë":* *Masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit.*

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal – "rregulli i artë") të LOB, deficit i targetuar në ligjin e buxhetit 2027 (-2029) është ***çdo vit më i ulët se sa shpenzimet kapitale të planifikuara***. Rrjedhimisht, balanca fiskale korrente e targetuar është pozitive çdo vit.

4. *Parashikime makroekonomike të kujdesshme: Vlera e Produktit të Brendshëm Bruto, nominale në lekë, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto për vitet buxhetore që planifikohen dhe për vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose vlerësuar në raportin "Perspektiva Ekonomike Botërore" (World Economic Outlook - WEO), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqërues të ligjit vjetor të buxhetit;*

Në përputhje me rregullin fiskal të përcaktuar në Ligjin Organik të Buxhetit (LOB), projektligji i buxhetit 2027 - (2029) mbështetet në projeksionet e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) nominal, të cilat paraqiten në mënyrë krahasuese kundrejt **projeksioneve të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) të raportit "Perspektiva Ekonomike Botërore" (World Economic Outlook), të Tetor 2026**.

Parashikimet e PBB nominale të MF dhe FMN

	2024	2025	2026 *Para.*	2027 *Para.*	2028 *Para.*	2029 *Para.*
MF	2,517.3	2,648.5	2,790.4	2,934.5	3,092.2	3,252.1
FMN	2,517.8	2,658.1	2,817.5	3,000.4	3,190.5	3,391.6
Diferenca MF - FMN (Diferenca e vlerave të parashikuara duhet të jetë jo më e madhe se zero)	-0.5	-9.5	-27.1	-65.9	-98.2	-139.5

5. *Planifikim kontigjence:* *Në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontigjencë e veçantë, prej jo më pak se 0.7 përqind e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interest, me ndikim në nivelin e borxhit.*

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiscal) të LOB, ligji i buxhetit 2027 - (2029) përfshin për çdo vit në një zë të veçantë të tij, emërtuar "Kontigjencë për luhatjet e normave të interesit, etj.", ***një kontigjencë prej 0.7 përqind e shpenzimeve totale.***

6. *Të ardhurat nga privatizimi:* *Të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rast se arkëtohen, ato përdoren jo më pak se 50 për qind për uljen e borxhit publik dhe pjesa e mbetur për investime publike. Pas arritjes së nivelit të borxhit publik, sipas përcaktimeve të shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 4/1 të Ligjit Organik të Buxhetit nr 57/2016, përdorimi i të ardhurave të arkëtuara nga privatizimet përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit.*

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, ligji i buxhetit 2027 - (2029) ***nuk përfshin të hyra nga privatizimet*** e mundshme.

1. *Linku për raportin "WEO" –World Economic Outlook, October 2026; Resilience Under Strain, Urgent Choices; October 13, 2026*

3. MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK

Borxhi publik gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 përgjithësisht u karakterizua nga një ecuri pozitive, duke qenë në përputhje me objektivat makro-fiskale, buxhetin e planifikuar për vitin 2026 dhe objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit *(SAMB)*. Në fund të muajit qershor 2026, borxhi publik u vlerësua në nivelin 1,367.9 miliard Lekë ose 49.0% e PBB[1], duke shënuar ulje krahasuar me fundin e vitit 2025 (3.9 pp ulje).

Periudha janar-qershor 2026 ka qenë pozitive përsa i përket sigurimit të financimit, si në tregun e brendshëm dhe në atë të huaj. Huamarrja gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 u realizua në linjë me buxhetin e vitit 2026 si edhe në linjë me Planin e Huamarrjes së vitit 2026. Huamarrja në terma bruto u realizua në vlerën rreth 232.6 miliard Lekë, nga të cilat 93.1% (ose rreth 216.5 miliard Lekë) u financuan nëpërmjet burimeve të brendshme dhe 6.9% (ose rreth 16.2 miliard Lekë) nëpërmjet burimeve të huaja. Ministria e Financave emetoi tituj shtetërorë në vlerën rreth 216.5 miliard Lekë në tregun e brendshëm, nga të cilët rreth103.9 miliard Lekë Bono Thesari dhe rreth 112.5 miliard Lekë Obligacione. Huamarrja e jashtme bruto u realizua në nivelin prej rreth 16.2 miliard Lekë.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, strukturat e Ministrisë së Financave përgjegjëse për menaxhimin e borxhit kanë vijuar përpjekjet në drejtim të reduktimit të ekspozimit ndaj risqeve duke mbajtur koston në nivelin më të ulët të mundshëm. Përmirësimi i mëtejshëm i strukturës së borxhit, kryesisht në aspektin e reduktimit të ekspozimit ndaj riskut të rifinancimit dhe riskut të normave të interesit do vijojë të mbetet fokusi kryesor në menaxhimin e borxhit, në mënyrë që tregues të këtyre risqeve të tregojnë përmirësim të mëtejshëm në periudhat në vijim.

Në përputhje me objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 u vijua me aktivitete në drejtim të zhvillimit të tregut të titujve shtetërorë. Në vazhdim të angazhimit të ndërmarrë në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të tregut primar dhe zhvillimin e tregut sekondar të titujve shtetërorë, përgjatë kësaj periudhe është vijuar me praktikat që kontribuojnë në krijimin e madhësive referencë dhe konsolidimin e kurbës së yield-it. Në drejtim të krijimit të madhësive benchmark është vijuar me konsolidimin e numrit të ankandeve të titujve shtetërorë, duke ulur frekuencën e emetimeve të titujve të rinj dhe duke përdorur rihapjet e titujve ekzistues.
Gjatë pjesës së mbetur të vitit 2026, menaxhimi i borxhit do të synojë plotësimin e nevojave të qeverisë për financim në kohë, si edhe nevojave për të shërbyer borxhin aktual me kosto sa më të ulët duke mbajtur nivele të pranueshme të ekspozimit ndaj risqeve. Në tregun e brendshëm, nëpërmjet titujve afatshkurtër do të synohet kryesisht rifinancimi i titujve ekzistues, si dhe menaxhimi aktiv i nevojave për likuiditet. Ndërkohë, nëpërmjet titujve afatgjatë do të synohet të mbulohet financimi i deficitit. Financimi i huaj do të shërbejë si plotësues i burimeve të brendshme dhe përveç të tjerash edhe si optimizues i kostove të borxhit.

4. POLITIKAT SEKTORIALE DHE PËRFITIMET PËR QYTETARIN

BUJQËSIA DHE ZHVILLIMIT RURAL

- **Prioritetet 2027-2029**

[1] *PBB për vitet 2020-2025: Burimi- Instat (http://databaza.instat.gov.al). Parashikimi 2026 , Burimi -Drejtoria Makroekonomike dhe Statistikave pranë MF https://financa.gov.al/kuadri-makroekonomik-dhe-fiskal (VKM Nr.516 datë 30.06.2026)*

- Garantimi i sigurisë ushqimore, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, dhe shëndetit të bimëve përmes adoptimit të standardeve përkatëse të BE-së në kuadrin normativ vendas;
- Konsolidimi i pronësisë mbi tokën bujqësore, administrimi i qëndrueshëm, ruajtja e saj nga dëmtimi, gërryerja, shpërdorimi dhe faktorë të tjerë;
- Nxitja e tregut të tokës dhe konsolidimi i fermës bujqësore duke rritur sipërfaqen dhe nxitur kooperimin;
- Mbështjetje për agroindustrinë;
- Mbështjetje për tregjet dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- Administrimi i sistemit të ujitjes nëpërmjet kujdesit, sigurimit dhe administrimit të qëndrueshëm të sistemit të ujitjes dhe shmangia e përmbytjeve;
- Mbështetje financiare dhe asistencë teknike për fermerët.
- Zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të peshkimit dhe akuakulturës, shfrytëzimin e përgjegjshëm të burimeve peshkore dhe kapaciteteve të flotës së peshkimit si dhe ngritjen e një sistemi kontrolli dhe inspektimi për peshkimin në det, në tokë dhe në të gjithë zinxhirin e tregut.

- **Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2027-2029**

Në fushën e "*Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit*", synohet të realizohet:

- Rritja e % së fermerëve që përfitojnë nga përmirësimi i infrastrukturës ujitëse dhe kulluese ndaj totalit të fermerëve në sipërfaqen potencialisht të ujitshme nga 77% në vitin 2026, në 80% në vitin 2029;

- Përqindja e sipërfaqes ujitëse ku fermerët kanë akses për ujë për ujitje, kundrejt sipërfaqes potencialisht të ujitshme (360 000 ha) nga 77% në vitin 2026, në 80% në vitin 2029;

- Përqindja e hidrovoreve të rehabilituara/ndërtuara/rikonstruktuara, kundrejt totalit të nevojshëm (14 hidrovorë) nga 85% në vitin 2026-2027, në 88% në vitet 2028-2029;

- Përqindja e sipërfaqes kulluese, që i kryhet procesi ciklik normal i pastrimit të rrjetit kryesorë kullues (1 herë në 5-6 vjet) , kundrejt sipërfaqes potencialisht të kullueshme (280 000 ha) nga 22% në vitin 2026, në 24% në vitin 2029;

- Rritja e numrit të veprave të mbrojtjes nga përmbytja të rehabilituara/ndërtuara (argjinatura gjatësore dhe penele terthorë), nga 45 vepra në 2026, në 48 vepra në vitin 2027, 50 vepra në vitin 2028 dhe 52 vepra në 2029.

Programi *"Zhvillimi Rural duke mbështetur Prodhimin Bujqësor, Blegtoral, Agroindustrial dhe Marketingun"* synon:

- Zhvillimi i sektorit të bujqësisë dhe atij rural në Shqipëri, për të përmirësuar performancën e tyre ekonomike dhe kushtet e jetesës në zonat rurale, për t'i përgatitur këta sektorë për anëtarësimin e ardhshëm në BE, duke rritur:
    - ✓ Numrin e të punësuarëve në bujqësi dhe agropërpunim (nga 438 000 të punësuar të parashikuar në vitin 2027 në 440 000 të punësuar në periudhën 2028-2029).
    - ✓ Aktivitetet promovuese të produkteve shqiptare në bujqësi, blegtori dhe agropërpunim.

- ✓ Rritja e volumit të eksportit të produkteve bujqësore dhe të agropërpunimit nga 59.76 miliardë lekë në vitin 2027 në 62 miliardë lekë në vitin 2028 dhe 64 miliardë lekë në vitin 2029.

- Përmirësimi i konkurrueshmërisë së bujqësisë dhe industrisë agro-ushqimore si dhe përmirësimi i cilësisë së jetës përmes nxitjes së shumëllojshmërisë së veprimtarive ekonomike në zonat rurale, nëpërmjet:
  - ✓ Shtimit të numrit të përfituesëve nga masat mbështetëse në bujqësi. Parashikohen rreth 43.666 përfitues në vitin 2027, 44.374 përfitues në vitin 2028 dhe 45.250 përfitues në vitin 2029, ku 15% e përfituesve parashikohet të jenë gra për vitin 2027.
  - ✓ Rritjes së numrit të pjesëmarrësve në aktivitetet promovuese të produkteve shqiptare, në bujqesi, blegtori dhe agropërpunim nga 140 pjesëmarrës në vitin 2027, në 147 pjesëmarrës në vitin 2028 dhe 152 pjesëmarrës në vitin 2029.
  - ✓ Rritjes së numrit të çertifikimeve dhe testimeve të farave dhe fidanëve që hidhen në treg, për të siguruar inpute cilësore për bujqësinë në tregun shqiptar.
  - ✓ Rritjes së numrit të fermave organike të mbështetura nga 120 ferma në vitin 2027, në 130 ferma në vitin 2028 dhe 140 ferma në vitin 2029.

Nëpërmjet programit *"Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit"* synohet fuqizimi i sistemit të kontrollit dhe inspektimit, duke përfshirë të gjithë zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë nëpërmjet:

- ✓ Kontrolleve dhe monitorimeve të sëmundjeve infektive dhe zoonotike në kafshët e gjalla duke ulur në këtë mënyrë numrin e kafshëve të prekura nga Bruceloza, nga plasja, nga tuberkulozi, dhe nga LSD.
- ✓ Do të vijojë zbatimi i politikave të shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve të gjalla, si dhe programet e parandalimit, kontrollit, eliminimit deri në çrrënjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë, sipas përcaktimeve të legjislacionit veterinar, nëpërmjet:
  - ✓ Kryerjes mesatarisht së rreth 317-318 mijë gjurmimeve dhe kontrolleve tek kafshët përgjatë viteve 2027-2029.
- Kryerjes së rreth 460 mijë vaksinimesh tek kafshët në vitin 2027, 470 mijë vaksinimesh në vitin 2028 dhe përiudhën 2026-2027 dhe 500 mijë vaksinimesh në vitin 2029.

Nëpërmjet programit *"Mbështetje për Peshkimin"* synohet:

- Menaxhimi i peshkimit dhe akuakulturës duke mbështetur sektorin me politika strukturore për tregjet, politikat tregtare dhe politikat ndërkombëtare me qëllim zhvillimin e aktivitetit të peshkimit në përputhje me standardet e BE duke garantuar konkurueshmërinë, mbrojtjen e resurseve, nëpërmjet:
  - ✓ Rritjes së numrit të kontrollove të inspektoriatit të peshkimit në subjektet e peshkimit nga 2450 në vitin 2027-2028 në 2700 në vitin 2029.
  - ✓ Menaxhimit të 7 porteve dhe ekonomive të peshkimit duke bërë të mundur rritjen e produktivitetit të resurseve nëpërmjet menaxhimit të programeve të ripopullimit me raste.
  - ✓ Kryerjen e raporteve për një monitorim sa më të saktë të aktiviteteve të lidhur me peshkimin, akuakulturën dhe molusqet.

- Rritja e numri të subjekteve të mbështetura për peshkimin dhe akuakulturën nga 150 në vitin 2027, në 200 në periudhën 2028-2029.

ZHVILLIMI EKONOMIK

- Promovimin e Shqipërisë si destinacion investimesh nëpërmjet organizimit dhe pjesëmarrjeve në panaire ndërkombëtare dhe road shou promovuese, vizita në kompani (after care) si dhe monitorim efektiv investimesh strategjike për periudhën 2027-2029;
- Rritjes së numrit të NVMV-ve të mbështetura me fonde publike nga 65 respektivisht në vitet 2027-2028 në 140 në vitin 2029.
- 9500 shërbime të ofruara për bizneset sipas sistemit të Regjistrimit të në periudhën 2027-2029.
- 3500 biznese të regjistruara në Regjistrin Tregtar dhe shërbimet e tjera, në periudhën 2027-2029.
- 990 liçenca të miratuara në Regjistrin e liçensave dhe shërbimeve të tjera, në periudhën 2027-2029.
- Rritjes së numrit të kompanive dhe investitorëve të targetuar gjatë fushata outreach, nga 70 parashikuar në vitin 2027, në 80 dhe 90 në vitin 2028 dhe vitin 2029.

INFRASTRUKTURA DHE ENERGJIA

Prioritetet 2027-2029

- Zgjerimi i rrjetit të rrugëve kombëtare nëpërmjet, ndërtimit, rehabilitimit dhe sistemimit të rrugëve kombëtare dhe përveç kësaj kalimin në praktikat e mirëmbajtjes së rrugëve bazuar në performancë;
- Zgjerimi i aksesit dhe cilësisë së shërbimit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve përmes: (i) një portofoli të investimeve publike; dhe (ii) përmirësimit rrënjësor të menaxhimit të shoqërive aksionere të ujësjellës kanalizimeve, duke standartizuar parimet e qeverisjes së sektorit;
- Rritja e efiçencës së energjisë kundrejt konsumit të përgjithshëm final të energjisë nëpërmjet shqyrtimit të programeve për promovimin e tregut, për penetrimin e teknologjive të përparuara si dhe rritjen e përdorimit të energjive të rinovueshme;

Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2027-2029

Programi “Transporti Rrugor”

- 3522 km rrugë të mirëmbajtura sipas standardeve në vitet 2027-2029 në të gjithë territorin;
- Numri i kilometrave të ndërtuara reabilituara, sistemuara, asfaltuara dhe të pajisura me sinjalistike rrugore do të arrijë në 565 Km në vitin 2027;
- Në PBA 2027-2029, është mbajtur në konsideratë, vazhdimi dhe financimi i projekteve koncesionare, me autoritet kontraktor Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ku edhe për tre vitet e ardhshme, këto projekte do të mbështeten me fonde nga buxheti i shtetit, në zbatim të kontratave dhe modeleve financiare të miratuara, konkretisht:
  - ✓ Kontrata e Koncesionit për ndërtimin e Rrugës së Arbrit;
  - ✓ Kontrata e Koncesionit për ndërtimin e Rrugës Milot – Morinë;
  - ✓ Kontrata e Koncesionit për ndërtimin e Rrugës Orikum – Dukat, By Pass-Porti i Jahteve;

Programi “Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime”

- Reduktimi i humbjeve në rrjet në nivel kombëtar në masën 50% në vitin 2029 nga 57% që parashikohet në vitin 2027;
- Orët mesatare të furnizimit me ujë të pijshëm synohet të rritet në 24 orë/dite në vitin 2029 nga 22 orë/ditë në vitin 2027;
- Orët e furnizimit me ujë në zonat bregdetare synohet të arrihet në 23 orë/ditë në vitin 2029 nga 21 orë/ditë në vitin 2027;
- Mbulimi me shërbim furnizimi me ujë të pijshëm zonë Urbane në 98% në vitin 2029 nga 96% në vitin 2027;
- Mbulimi me shërbim furnizimi me ujë të pijshëm zonë Rurale 80% në vitin 2029 nga 70% në vitin 2027;
- Mbulimi me kanalizime në zonat Urbane në 91% në vitin 2029 nga 87% në vitin 2027;
- Mbulimi me kanalizime në zonat Rurale 24% në vitin 2029 nga 20% në vitin 2027;
- Sasia e ujit të faturuar synohet të arrihet në 120 litër/ frymë/ditë në vitet 2027- 2029;
- Mbulimi me shërbimin e ITUN (kanalizime+gropa septike) synohet të arrihet në nivelin 24% në vitin 2029 nga 20% në vitin 2027;
- Përqindja e mbulimit të kostove të Ujësjellës-Kanalizimeve me të ardhurat synohet të arrihet në vlerën 90% në vitin 2029 nga 80% në vitin 2027;

Programi "Mbështetje për Rrjetet e Komunikacionit"

- Në kuadër të planit të rritjes parashikohet zhvillimi i infrastrukturës së qëndrueshme dhe të sigurtë Gigabit ku përfshihen si rrjetet e shpejtësisë shumë të lartë dhe zhvillimi dhe zbatimi i 5G Toolbox;
- Rritja e penetrimit broadband fiks në nivel popullsie në 60% në vitin 2029 nga 40% që parashikohet në vitin 2026;
- Rritja e penetrimit broadband fiks në nivel familje në 99% në vitin 2029 nga 90% që parashikohet në vitin 2026;
- Sigurimi i mbulimit me Wi-Fi falas për qytetarët dhe vizitorët në hapësirat publike përmes projektit Wi-Fi4AL ku synohet të mbulojë deri në 44 pika "hotspote" në Bashkitë e vendit.

Programi "Transporti Ajror"

- Zhvillimin dhe ndërtimin e infrastrukturave të reja aeroportuale, me qëllim krijimin e një tregu konkurrues me shërbime ajrore të liberalizuara;
- Rritjen e standarteve dhe performancës së Autoritetit Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil nëpërmjet investimeve për forcimin e kapaciteteve;

Programi "Transporti Detar"

- Rritja e volumit të përpunimit të mallrave tregtare në porte në 9,831,507 në vitin 2029 nga 8,886,940 që parashikohet në vitin 2027;
- Rritja e numrit të pasagjereve që udhëtojne në/nga Shqipëria në rruge detare në 1,858,950 pasagjerë në vitin 2029 nga 1,765,664 pasagjerë që parashikohen në vitin 2027;
- Vijon financimi i projektit "Porti i ri Tregtar i Integruar i Durrësit në Porto Romano Faza I".

Programi "Transporti Hekurudhor"

- Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës - Terminali pasagjerëve Tiranë dhe ndërtimi i linjës hekurudhore Tiranë – Rinas;
- Rehabilitimi i linjës hekurudhore Vore - Hani i Hotit;
- Rinovim i linjës hekurudhore Durrës-Rrogozhinë;

Programi "Mbështetje për Burimet Natyrore"

- Synohet nxitja e rritjes së sektorit përmes promovimit dhe inkurajimit të zbulimit të burimeve të reja potenciale mineralmbajtëse, nëpërmjet kompanive vendase e të huaja, të vogla dhe të mesme;
- Rritja e lejeve minerare aktive në të cilat zhvillohet aktivitet minerar konform standarteve në 610 leje në vitin 2029 nga 590 leje në vitin 2026;
- Studime për promovimin e burimeve natyrore si dhe studimeve mbi parandalimin e rreziqeve gjeologo-mjedisore dhe hidrologjike, duke parashikuar 23 studime në vit përgjatë periudhës 2027-2029;

Programi "Mbështetje për Industrinë"

- Rritja e sigurise së pajisjeve/instalimeve elektrike dhe eneve nën presion nëpërmjet inspektimeve periodike përgjatë 2027-2029;
- Rritja e standardeve të produkteve dhe sigurisë së pajisjeve/instalimeve me 20% për vitet 2027-2029;
- Reduktimi i rrezikut nga kimikatet e rrezikshme me 15% për vitet 2027-2029.
- Rritja e numrit të mostrave të analizuara të naftës dhe nënprodukteve të saj, të prodhuara në vend dhe të importuara me 20% përgjatë 2027-2029;
- Rritja e standardeve të naftës dhe nënprodukteve të saj nëpërmjet përdorimit të aparaturave specifike testuese;

Programi "Planifikimi Urban"

- Zhvillimi i qëndrueshëm dhe i balancuar i territorit, duke zbutur pabarazinë rajonale, për garantimin e ekuilibrit midis interesave publike dhe private, në zhvillimin e territorit;
- Hartimin e rregullave dhe standardeve të projektimit në disa fusha si dhe përafrimit të legjislacionit me standardet e BE-së;

SHËNDETËSI

Prioritetet 2027-2029

- Financimi i qëndrueshëm i kujdesit shëndetësor parësor, spitalor dhe shëndetit publik;
- Përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare të institucioneve shëndetësore, nëpërmjet mirëplanifikimit, mirëalokimit dhe përdorimit me efektivitet të burimeve;

- Zgjerimi dhe rritja e kosto-efektivitetit të Listës së Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore të Rimbursueshme;
- Financimi i paketave të shërbimeve shëndetësore në institucionet publike dhe jopublike;
- Zgjerimi i programeve të parandalimit, depistimit dhe diagnostikimit të hershëm;
- Zhvillimi dhe kostimi i shërbimeve të reja shëndetësore;
- Vijimi i reformës së financimit të shërbimeve mbi bazën e aktivitetit, produkteve, kostos dhe performancës;
- Fuqizimi i kapaciteteve diagnostikuese dhe terapeutike në nivel rajonal;
- Vijimi i reformës së autonomisë spitalore dhe forcimi i përgjegjshmërisë menaxheriale;
- Zhvillimi i mëtejshëm i digjitalizimit dhe përdorimi i të dhënave për planifikimin, monitorimin dhe kontrollin e shërbimeve.

Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2027-2029

- Mbulimi universal i popullsisë me shërbim shëndetësor duke parashikuar mesatarisht 7.51 milionë vizita në kujdesin shëndetësor parësor në vit gjatë periudhës 2027-2029 (7,441,287 vizita në vitin 2027, 7,485,934 vizita në vitin 2028 dhe 7,600,000 vizita në vitin 2029), mbështetur në treguesit e sëmundshmërisë dhe nevojat për kujdes shëndetësor të popullatës.
- Rritja e numrit të fëmijëve të moshës 0-1 vjeç që marrin vizitat e detyrueshme nga personeli shëndetësor në 28 mijë fëmijë në vitin 2029, kundrejt 25 mijë fëmijëve në vitin 2026, duke synuar forcimin e kujdesit parandalues dhe ndjekjes së hershme të shëndetit të fëmijëve.
- Trajtimi me recetë rimbursimi i 400 mijë pacientëve në vit përgjatë periudhës 2027-2029, bazuar në treguesit e sëmundshmërisë dhe në politikat e zgjerimit e përmirësimit të skemës së rimbursimit të barnave.
- Mbështetja e politikës së rimbursimit të fishave të diabetit, ku synohet rritja e numrit të përfituesve në 67 mijë persona në vitin 2029, nga 61 mijë përfitues në vitin 2026, duke garantuar akses më të mirë në monitorimin dhe menaxhimin e sëmundjes së diabetit;
- Numri i pacientëve të trajtuar në shërbimin spitalor parashikohet të rritet nga 370,755 pacientë në vitin 2027, në 389,293 pacientë në vitin 2028 dhe 410,000 pacientë në vitin 2029, duke garantuar mbulimin e nevojave të popullatës për kujdes mjekësor të specializuar.
- Rritja e numrit të pacientëve që përfitojnë nga paketat e kardiologjisë dhe kardiokirurgjisë nga 14,254 pacientë në vitin 2027 në 18,362 pacientë në vitin 2029, nëpërmjet zgjerimit të aksesit në shërbimet e specializuara dhe financimit të paketave përkatëse.
- Për shërbimin e dializës parashikohet realizimi i 227 mijë seancave në vitin 2027, 238 mijë seancave në vitin 2028 dhe 249 mijë seancave në vitin 2029, duke reflektuar rritjen graduale të kërkesës për këtë shërbim dhe garantimin e vazhdimësisë së trajtimit për pacientët me insuficiencë renale kronike.
- Trajtimi i 1,250 pacientëve në vit nëpërmjet paketës së ekzaminimeve për Sindromën Doën, me një fond prej rreth 6.0 milionë lekë në vit, ose rreth 18.1 milionë lekë për gjithë periudhën 2027-2029.
- Financimi i paketës së fertilitetit për çiftet që kanë nevojë për trajtim të infertilitetit, me një fond prej 37.5 milionë lekë në vit dhe 200 çifte përfituese çdo vit gjatë periudhës 2027-2029.

- Financimi i shërbimit të ndërhyrjes së rikonstruksionit të gjirit për 350 paciente në vit gjatë periudhës 2027-2029, me një fond prej 70 milionë lekë në vit, në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetës së grave të trajtuara për kancer gjiri.
- Financimi i shërbimit të radioterapisë për 31,530 pacientë në vitin 2027, 31,800 pacientë në vitin 2028 dhe 34,026 pacientë në vitin 2029, duke siguruar vazhdimësinë e trajtimit onkologjik.
- Financimi i procedurës së trombektomisë, si një ndërhyrje e avancuar dhe jetëshpëtuese për trajtimin e pacientëve me insult cerebral akut, duke parashikuar trajtimin e 250 pacientëve në vit përgjatë periudhës 2027-2029. Për realizimin e këtij shërbimi është planifikuar një fond prej 480 milionë lekë në vit, me synim përmirësimin e aksesit në trajtime të specializuara, uljen e vdekshmërisë dhe reduktimin e pasojave afatgjata të sëmundjeve cerebrovaskulare.
- Numri i thirrjeve për urgjencë mjekësore të adresuara nga njësitë e Urgjencës Mjekësore parashikohet të rritet nga 400 mijë thirrje në vitin 2026 në 460 mijë thirrje në vitin 2029, ndërkohë që koha mesatare e reagimit synohet të përmirësohet nga 15 minuta në vitin 2026 në 12 minuta në vitin 2029.
- Depistimi për kancerin e qafës së mitrës për 12 500 gra përgjatë 2027-2029 me synim uljen e vdekshmërisë nga kanceri i qafës së mitrës, me një fond mesatarisht prej 28.5 milion lekë në vit.
- Depistimi për kancerin e gjirit për 5 000 gra përgjatë 2027-2029 me synim uljen e vdekshmërisë nga kanceri i gjirit, me një fond mesatarisht prej 13.2 milion lekë në vit.
- Gjatë periudhës 2027-2029 parashikohen të vaksinohen për gripin sezonal rreth 300,000 persona/çdo vit me një fond respektivisht prej 171 milion lekë.

Investimet Publike në sektorin e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale për vitet 2027-2029:

- Ndërtimi i godinës së re multifunksionale të Spitalit Rajonal Korçë me një vlerë 1.38 miliardë lekë;
- Modernizimi i infrastrukturës digjitale me vlerë 1.4 miliardë lekë ku për vitin 2026 janë parashikuar 285 milion lekë;
- Vijon financimi i projektit rikonstruksion në Maternitetin nr.1 Tiranë, faza II, me vlerë kontrate 274 milion lekë;
- Vijon financimi i projektit rikonstruksion në Spitalin Psikiatrik Elbasan me vlerë totale 433 milion lekë;
- Vijon financimi për rehabilitimin e 100 objekteve të tjera të Qendrave Shëndetësore dhe ambulancave dhe pajisjen e tyre mjekësore, me një fond të planifikuar prej 310 milion lekë për vitin 2027. Deri në fund të vitit 2024 janë rikonstruktuar dhe pajisur 340 Qendra Shëndetësore dhe ambulanca;
- Vijon rikonstruksioni i godinës qendrore të Spitalit Pogradec vlera e plotë është parashikuar 350 milion lekë;
- Vijon rikonstruksion i godinës së djegie-plastikës në QSUNT, me vlerë të plotë 574 milion lekë;
- Rikonstruksion i godinës qendrore spitalit Lushnje me vlere 314 milionë lekë;
- Rikonstruksion i godinës së Maternitetit të spitalit Shkodër me vlerë 325 milionë lekë.
- Rikonstruksioni i urgjencës në Spitalin Durrës me vlerë rreth 300 milionë lekë;
- Rikonstruksioni i godinës qendrore spitalit Mat me vlerë rreth 407 milionë lekë;
- Rikonstruksion i godinës qendrore të spitalit Dibër me vlerë rreth 350 milionë lekë;

- Rikonstruksion i godinës qendrore spitalit Gjirokastër me vlerë rreth 420 milionë lekë.
- Vijon financimi për blerjen e paisjeve mjekësore për spitalet me vlerë financimi për vitin 2027 prej 1.1 miliardë lekë.

MBROJTA SOCIALE

Në fushën e mbrojtjes sociale, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale synon zbatimin me sukses të reformës së programit të përkujdesit social në tre shtyllat kryesore të tij: Ndihma Ekonomike, Aftësia e Kufizuar dhe Shërbimet Sociale. Më konkretisht synohet:

- Numri i familjeve dhe individëve në nevojë që pritet të përfitojnë nga skema e Ndihmës Ekonomike parashikohet të jetë 59 mijë përfitues në vitin 2027, 58 mijë përfitues në vitin 2028 dhe 57 mijë përfitues në vitin 2029, duke reflektuar objektivin për rritjen e integrimit në tregun e punës të anëtarëve në moshë pune të familjeve përfituese.
- Numri i përfituesve nga pagesat e aftësisë së kufizuar (PAK) dhe kujdestarëve të tyre parashikohet të rritet nga 99 mijë përfitues në vitin 2027 në 103 mijë përfitues në vitin 2029, në kuadër të vijimit të zbatimit të modelit bio-psiko-social të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, sipas standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe integrimit të pagesave me shërbimet sociale.
- Në kuadër të mbështetjes së personave nga grupet e pafavorizuara nëpërmjet ndërmarrjeve sociale, parashikohet punësimi i 100 personave në vitin 2027 dhe 150 personave në vitet 2028-2029, me një fond prej 50 milionë lekë në vitin 2027 dhe 80 milionë lekë në vit për vitet 2028-2029, me synim integrimin social dhe ekonomik të kategorive në nevojë.
- Rritja e përqindjes së personave të punësuar në ndërmarrjet sociale në raport me numrin e anëtarëve në moshë pune në skemën e ndihmës ekonomike nga 3% në vitin 2027, në 4% në vitin 2028 dhe 5% në vitin 2029, si pjesë e politikës së riintegrimit social-ekonomik të grupeve të margjinalizuara.
- Mbështetja e Fondit Social për njësitë e vetëqeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve të reja sociale territoriale për grupet në nevojë, duke financuar 105 shërbime në vitin 2027, 115 shërbime në vitin 2028 dhe 125 shërbime në vitin 2029, me një fond prej 480 milionë lekë në vitin 2027, 500 milionë lekë në vitin 2028 dhe 530 milionë lekë në vitin 2029. Numri i bashkive përfituese nga fondi social parashikohet të rritet nga 57 bashki në vitin 2027 në 61 bashki në vitin 2029.
- Financimi i politikës së mbrojtjes së veçantë nga shteti për gratë e papuna me tre ose më shumë fëmijë, ku njëri prej tyre është nën moshën 5 vjeç, duke synuar rritjen e numrit të përfitueseve nga 8,500 gra në vitin 2027, në 8,700 gra në vitin 2028 dhe 8,900 gra në vitin 2029. Për këtë masë është planifikuar një fond prej 870 milionë lekë në vitin 2027, 890 milionë lekë në vitin 2028 dhe 910 milionë lekë në vitin 2029.
- Financimi i politikës së rishikuar të bonusit të bebes nga e cila pritet të përfitojnë fëmijë të moshës 0-5 vjeç duke dhënë një pagesë mujore që varion nga 5,000-10,000 lekë/muaj;
- Numri i grave dhe vajzave në nevojë të riintegruara pas trajtimit në institucionet e përkujdesit social parashikohet të rritet nga 55 raste në vitin 2027, në 57 raste në vitin 2028 dhe 60 raste në vitin 2029, duke synuar fuqizimin e mekanizmave të mbështetjes dhe riintegrimit në komunitet.
- Numri i rasteve të trajtuara me urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje kundrejt totalit të rasteve të denoncuara të dhunës në familje parashikohet të ulet nga 43% në vitin 2026 në 41% në vitin 2027, 39% në vitin 2028 dhe 37% në vitin 2029, duke reflektuar përdorimin e instrumenteve më të gjera të mbrojtjes dhe menaxhimit të rasteve të dhunës në familje.

SIGURIMI SHOQËROR

Në fushën e Sigurimeve Shoqërore, për periudhën 2027-2029 synohet:

- Garantimi i mbulimit sa më të plotë të popullsisë së vendit me elementë të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, të mbajtura në nivele të pranueshme. Kjo do të arrihet nëpërmjet zbatimit të sistemit të reformuar të sigurimeve shoqërore në pershtatje sa më të plotë me stadin e arritur të zhvillimit ekonomik e social të vendit dhe të thellimit të parimit kontributiv të sistemit ;
- Zhvillimi dhe fuqizimi i kapaciteteve institucionale të ISSH-së, vazhdimi i punës për implementimin gradual i projekteve të nisura për ngritjen e një sistemi kompleks e të automatizuar informacioni për plotësimin e funksioneve të sigurimeve shoqërore dhe për të tretët;
- Mbështetje aktive për shqiptarët që jetojnë dhe studiojnë jashtë vendit, duke i dhënë prioritet vendeve ku ka më shumë prezencë shqiptarësh. Në zbatim të nenit 45 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, është ndërmarrë angazhimin për koordinimin për zgjerimin e skemave të mbrojtjes sociale me vendet e BE dhe më tej;
- Zbatimi me korrektësi i ligjit për skemat e sigurimit suplementar dhe i programeve të veçanta sociale të qeverisë, analiza konstatimi dhe bashkëpunimi me Ministritë përkatëse për harmonizimin e këtyre skemave me zhvillimet ekonomiko-sociale të vendit;
- Rritja e aftësimit profesional të punonjësve, nëpërmjet njohjes me ndryshimet në legjislacion, shkëmbimit të eksperiencave, trajnimeve etj, të cilat çojnë në rritjen e cilësisë së punës dhe ofrimin e shërbimeve më të mira ndaj qytetarëve.

❖ **Rezultatet e synuara për t'u arritur në periudhën 2027-2029:**

1. Rritja e nivelit të përfitimeve të pensionistëve sipas rritjes së indeksit të çmimeve të mallrave të konsumit dhe të shërbimeve, të përcaktuar në shportën e pensionistëve.
2. Mbulimi i efekteve financiare të shtesës natyrale të numrit të përfituesve, e cila për vitin 2027 parashikohet të jetë një shtesë neto rreth 22 mijë persona;
3. Numri i pensionistëve për të gjitha kategoritë në fund të vitit 2027 pritet të jetë rreth 805 mijë persona.
4. Sistemi do të vazhdojë të mbështesë me të ardhura deri në fund të vitit 2027 rreth 850 mijë persona që kanë përfituar dhe përfitojnë pensione publike, pensione suplementare, si dhe një sërë të ardhura të tjera të parashikuara me ligje si dhe, vendime të veçanta dhe vendime kompensuese të Këshillit të Ministrave.
5. Shkalla e mbulimit të popullsisë në moshë punë (kontribues/popullsi në moshë pune) do të jetë rreth 61%.
6. Pjesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore ndaj totalit të fondeve të alokuara për skemat e sigurimeve shoqërore do të arrijë të mbulojë mesatarisht rreth 84.5 % të totalit.
7. Raporti kontribues/përfitues për pensione pleqërie për vitin 2026 pritet të jetë 1.31.

Sistemi i Sigurimeve Shoqërore

Sistemi i sigurimeve shoqërore është fokusuar dhe synon:

- ✓ përmirësimin e vazhdueshëm të skemave aktuale, nëpërmjet forcimit të shtyllës publike të pensioneve e forcimit të një lidhje më të drejtpërdrejtë midis kontributeve të paguara dhe përfitimeve të ardhshme,
- ✓ futjen graduale të skemave të përfitimeve suplementare të menaxhuar nga subjekte jo publike,
- ✓ zhvillimin e forcimin e skemave të sigurimeve suplementare profesionale dhe vullnetare,
- ✓ rritjen e eficencës dhe përmbushjes së funksioneve të ISSH-së nëpërmjet shtimit të kapaciteteve drejtuese, informatizimit të sistemit në përgjithësi të proceseve të punës dhe të informacionit arkivor,
- ✓ përmirësimin e shërbimit proklient.

Realizimi i objektivave të sipërcituar bëhet përmes menaxhimit me efiçencë dhe efektivitet të tre skemave:

- ✓ **Skema e Sigurimit të Detyrueshëm:**

  Mbulon me fonde transfertat për individët nga pensionet publike, rastet e paaftësisë së përkohshme në punë, rastet e barrëlindjeve, rastet e aksidenteve në punë, në momentin e lindjes së të drejtës dhe nevojës për to. Gjithashtu, mbulon mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe të siguruarve vullnetarisht, administrimi i kontributeve dhe i transfertave me destinacion nga Buxheti i Shtetit në buxhetin e ISSH, si dhe administrimin e të gjithë informacionit që lidhet me të drejtat e fituara të kontribuesve në skemën e sigurimit shoqëror të detyrueshëm.
- ✓ **Skema e Sigurimit Suplementar**

  Mbulon transfertat fondeve shtetërore për individët që kanë kryer funksione kushtetuese, ish ushtarakët dhe policisë së rendit, si dhe mbështetje për ata individë që kanë statusin e profesorit, naftëtarit, metalurgut, si dhe punonjësve që kanë punuar në miniera.
- ✓ **Skema Kompensuese të shtetit dhe trajtimeve të veçanta**

  Mbulon transfertat fondeve shtetërore në buxhetet individuale të pensionistëve dhe personave të tjerë rezidentë që përfitojnë nga programe kompensuese shtetërore ose trajtime të veçanta financiare si personat nën statusin "Dëshmor i Atdheut", punonjësit e ndërmarrjeve ushtarake, për pilotët fluturues në pension, etj.

Buxheti i ISSH-metodologjia e përgatitjes

Llogaritjet për përgatitjen e buxhetit të ISSH-së kalon nëpër të gjitha hapat e kryerjes së një parashikimi. Kjo konsiston në:

- ✓ mbledhjen dhe analizën e të dhënave;
- ✓ hartimin e bashkësisë së supozimeve për periudhën që parashikohet;
- ✓ plotësimin e të dhënave në periudhën bazë dhe supozimet në periudhën e parashikimit;
- ✓ ekzekutimin e modelit dhe kryerjen e parashikimeve;
- ✓ marrjen e rezultateve dhe analizën e tyre.

ARSIMI

Prioritetet 2027-2029

Ministria e Arsimit do të vijojë zhvillimin e reformave në arsim, mbështetjen e arsimit bazë, të mesëm të lartë, orientimin e kurikulave ndaj nevojave të tregut të punës dhe modernizimin e tyre, zhvillimin

profesional të mësuesve nëpërmjet trajnimit, promovimit dhe zgjerimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në edukim si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së të rinjve, përmes rritjes së pjesëmarrjes së tyre në aktivitete rinore:

- Aksesin universal dhe të barabartë në arsimin parauniversitar, duke sigururar përfshirjen 100% të fëmijëve në arsimin bazë, regjistrimin 100% të fëmijëve romë dhe egjiptianë, si dhe rritjen e vijimësisë së tyre në arsimin e mesëm të lartë në nivelin 70-80%;
- Sigurimi i transportit falas për 38,000 në vitin 2027, 38,500 në vitin 2028 dhe 39,000 nxënës në vitin 2029 të cilët plotësojnë kriteret përkatëse dhe për 17,000 mësues e drejtues istitucionesh arsimore ne vitet 2027-2028 dhe 18,250 në vitin 2029.
- Sigurimin e teksteve shkollore falas për 215,000 nxënës të arsimit bazë në vitin 2027 dhe për 235,000 nxënës në secilin nga vitet 2028 dhe 2029;
- Ofrimin e bursave financiare dhe ushqimore për fëmijët nga kategoritë sociale në nevojë, me 4,000 përfitues në vitin 2027, 4,125 përfitues në vitin 2028 dhe 4,375 përfitues në vitin 2029;
- Arritjen e një niveli regjistrimi prej 82% në arsimin e mesëm të lartë publik, kundrejt numrit të nxënësve që përfundojnë arsimin bazë;
- Ndërtimin, rindërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve arsimore, në 2,140 klasa dhe mjedise arsimore gjatë periudhës 2027-2029;
- Financimin e zhvillimit të infrastrukturës shkollore në arsimin bazë dhe të mesëm të lartë, me financimin e 483 klasa/mjedise në vitin 2027, 786 në vitin 2028 dhe 871 në vitin 2029;
- Pajisjen me mobilieri dhe infrastrukturë mësimore të 286 klasave në vitin 2027, 160 klasave në vitin 2028 dhe 162 klasave në vitin 2029 në arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të lartë;
- Zbatimin e kurrikulës së re dhe zhvillimin profesional të mësuesve përmes trajnimit të 12,000 mësuesve të arsimit bazë në vit, 1,600 mësuesve SMARTLAB në vit dhe 2,000-4,000 mësuesve të arsimit të mesëm të lartë gjatë periudhës;
- Akreditimin e 30 institucioneve dhe programeve të studimit në vitet 2027 dhe 2028 dhe 33 institucioneve dhe programeve të studimit në vitin 2029, me synim akreditimin institucional të plotë sipas kërkesave ligjore;
- Rritjen e mbështetjes financiare për studentët, duke mbështetur me bursa financiare dhe akomodim 16,000 studentë në vit, si dhe 700 studentë e doktorantë ekselentë përmes Fondit të Ekselencës;
- Përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet kualifikimit shkencor të stafit akademik me 5-10% në vit dhe rritjes së numrit të stafit akademik me kohë të plotë;
- Mbështetjen e mobilitetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar të studentëve, kërkuesve dhe institucioneve të arsimit të lartë përmes programeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit shkencor;
- Mbështetjen e zhvillimit të kapaciteteve akademike dhe kërkimore të institucioneve të arsimit të lartë nëpërmjet investimeve, projekteve dhe programeve të bashkëpunimit ndërkombëtar.
- Financimin e kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë, instituteve shkencore dhe programeve kombëtare e ndërkombëtare të kërkimit me fonde grant nga buxheti i shtetit;
- Mbështetjen e pjesëmarrjes në programin Horizon Europe, me 20 projekte në vitet 2027 dhe 2028 dhe 23 projekte në vitin 2029.
- Forcimin e bashkëpunimit universitet–biznes përmes financimit të 50 projekteve të përbashkëta në vit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë dhe sektorit privat.
- Rritjen graduale të fondeve për kërkimin shkencor, nga 0.24% e shpenzimeve publike në vitin 2027 në 0.28% në vitin 2029.

- Fuqizimin e strukturave qendrore dhe vendore të sistemit arsimor përmes zhvillimit të kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese, duke trajnuar 450 punonjës në vitet 2027-2028 dhe 520 punonjës në vitin 2029.

Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2027-2029

Për arsimin parauniversitar për periudhën 2027-2029 synohet si më poshtë:

- Pjesëmarrja në arsimin parashkollor parashikohet në nivelin 100%, me rreth 66,343 fëmijë të grupmoshës 3-6 vjeç që ndjekin arsimin parashkollor në secilin vit të periudhës;
- Pjesëmarrja e vajzave në arsimin 9-vjeçar në zonat rurale parashikohet të ruhet në nivelin 40% në secilin vit të periudhës 2026-2029.
- Rritja e mbështetjes së përfshirjes së fëmijëve romë, egjiptianë dhe me aftësi të kufizuara, me rreth 2,127 fëmijë romë dhe egjiptianë në arsimin parashkollor, 9,802 nxënës romë dhe egjiptianë në arsimin 9-vjeçar publik dhe 4,485 nxënës me aftësi të kufizuara në secilin vit
- Raporti nxënës-mësues në arsimin bazë parashikohet të ruhet në nivelin 10.6 nxënës për një mësues.
- Digjitalizimi i arsimit bazë mbështetet përmes programit SMARTLAB në 216 institucione arsimore dhe trajnimit të 1,600 mësuesve në secilin vit;
- Pajisja me 25 laboratorë shkencorë në secilin vit dhe pajisja e 190 klasave SMARTLAB me mobilieri në vitin 2027.
- Programet "After School" dhe "Summer School" parashikojnë përfshirjen e 5,000 mësuesve në vitin 2027 duke synuar zgjerimin e mbështetjes arsimore për nxënësit dhe përmirësimin e rezultateve të të nxënit

Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor për periudhën 2027-2029 parashikohet sa më poshtë**:**

- Akreditimi institucional i institucioneve të arsimit të lartë dhe i programeve të studimit synohet të realizohet në masën 100% brenda afateve ligjore të akreditimit;
- Mbështetja financiare me bursa dhe financim për akomodim parashikohet për 16,000 studentë në secilin vit si dhe 700 studentë e doktorantë ekselentë përmes Fondit të Ekselencës;
- Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies përmes rritjes së kualifikimit shkencor të stafit akademik me 5-10% në vit dhe rritjes së numrit të stafit akademik me kohë të plotë;
- Raporti student-pedagog parashikohet të ruhet në nivelin 24 studentë për një pedagog gjatë periudhës, ndërsa objektivi afatgjatë i programit synon uljen e këtij raporti në 20 studentë për pedagog;
- Mbështetja e bashkëpunimit dhe ndërkombëtarizimit realizohet përmes projekteve të financuara me grant të huaj, përfshirë projektin REACH me financim prej 300 milion lekësh në secilin vit.
- Financimi i projekteve kërkimore në institucionet publike të arsimit të lartë parashikon 112 kërkues përfitues nga fondet grant të projekteve në secilin vit;

ARSIMI PROFESIONAL DHE PUNËSIMI

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023 - 2030 është dokumenti kryesor i politikës në fushën e punësimit dhe zhvillimin e aftësive në vend me objektiv kryesor në fushën e AFP-së, "Rritja e nivelit të aftësive të grave dhe burrave në moshë pune". Objektivat strategjik të periudhës 2023-2030 renditen si më poshtë vijon:

1. Zhvillimi i ofertës së Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) më relevant, fleksibël, qeverisur bazuar në fakte e që garanton vijueshmëri;
2. Forcimi i mekanizmave të garantimit dhe zhvillimit të cilësisë në sistemin e AFP-së;
3. Përfshirja në mënyrë sistemike dhe të vijueshme e sektorit privat në qeverisjen, zhvillimin dhe ofrimin e AFP-së;
4. Nxitja e mundësive gjithëpërfshirëse për të nxënit gjatë gjithë jetës;
5. Njohja e të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal;
6. Transformimi digjital dhe i gjelbër i sistemit të AFP-së.

Aktualisht, arsimi profesional publik ofrohet në **31 shkolla të mesme profesionale** në të gjithë vendin, ku ofrohen programe dhe kualifikime të lidhura ngushtë me nevojat e tregut të punës. Gjatë vitit shkollor **2024-2025**, mbi **16,000 nxënës** kanë zgjedhur të ndjekin arsimin profesional, ndërsa pesha e arsimit profesional në raport me arsimin e mesëm të lartë ka vijuar të rritet, duke arritur rreth **19%**, krahasuar me vetëm **13-14%** një dekadë më parë. Ky trend reflekton rritjen e interesit të të rinjve për formimin profesional, zgjerimin e ofertës së kualifikimeve dhe përmirësimin e lidhjes së sistemit arsimor me kërkesat e ekonomisë dhe të tregut të punës.

Prioritetet për periudhën afatmesme 2027-2029:

- Modernizimi i infrastrukturës së ofruesve publik të AFP-së, në përputhje me parimet e ekonomisë dhe transformimit digjital.
- Përditësimi i Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale, në përputhje me kërkesat për aftësitë dhe profesionet e të ardhmes.
- Promovimi dhe nxitja e pjesëmarrjes së grupeve të veçanta në AFP (vajza, PAK, romë dhe egjiptianë etj.).
- Zbatimi i plotë i procesit të akreditimit për të gjithë ofruesit publikë të AFP-së, si dhe ofrues privatë që ofrojnë kualifikime profesionale të niveleve 2-5 të KSHK-së, bazuar në standardet dhe kriteret e cilësisë sipas modelit të akreditimit.
- Zhvillimi i qasjes dhe modelit të inspektimit në AFP të harmonizuar me kornizën e garantimit dhe zhvillimit të cilësisë.
- Konsolidimi i sistemit të kualifikimit fillestar dhe zhvillimit të vazhduar profesional të mësimdhënësve për të përmirësuar aftësitë teknike (profesionale) dhe në shërbim të tranzicionit të gjelbër dhe digjital, në shërbim të mësimdhënies cilësore.
- Zhvillimi dhe zbatimi i mekanizmit të garantimit të cilësisë të ofruesve në zhvillimin e vazhduar profesional për mësimdhënësit e kulturës profesionale.
- Angazhimi i sektorit privat në Këshillin Kombëtar të AFP-së për të lehtësuar kontributin aktiv të komunitetit të biznesit dhe partnerëve socialë në reformën e AFP-së.
- Funksionimi dhe vijimi i krijimit të Komiteteve Sektoriale.
- Zbatimi i sistemit të njohjes së të nxënit të mëparshëm joformal dhe informal.
- Zhvillimi dhe operacionalizimi i autonomisë financiare të ofruesve të AFP-së.
- Krijimi i qasjes së ofrimit të AFP-së me kohë të pjesshme.
- Zbatimi i ofertës së AFP-së në formë të kombinuar.

Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2027-2029

- Rritjes së % së të diplomuarve/çertifikuarve të punësuar 1 vit pas diplomimit nga 68% në vitin 2027, në 68.5% në vitin 2028 dhe 69% në vitin 2029.
- Rritjes së numrit të të diplomuarve/certifikuarve në Agjencitë e Formimit Profesional nga 3000 në vitin 2027, në 3100 në vitin 2028 dhe 3150 në vitin 2029.
- Rritjes së shkallës së përqindjes së nxënësve në arsimin profesional (AP) në krahasim me totalin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë nga 19% në vitin 2027, në 20% në vitin 2028 dhe 23% në vitin 2029.
- Rritjes së numrit të nxënësve që ndjekin/regjistruar arsimin profesional nga 15.800 në vitin 2026, në 16.200 në vitin 2027, në 16.800 në vitin 2028 dhe 16.900 në vitin 2029.
- Rritjen e numrit të nxënësve që vijnë nga zonat rurale të cilët ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale, nga 52.5% e totalit në vitin 2027 në 53.5% e totalit në vitin 2029;
- Ndërtim rikostruksion i repartit të praktikave profesionale shkolla "Karl Gega", Tiranë;
- Vijon financimi për rikontruksionin e godinës së shkollës Mekanike "Hasan Gina" Lushnje;
- Vijon financimi për rikostruksion/ndërtim i ri i godinës së shkollës dhe reparteve të praktikave Industriale Pavarësia Vlorë;
- Vijon financimi për rikonstruksion Shkolla "Bajram Curri", Kukës;
- Vijon financimi për rikonstruksion për shkollën "Enver Qiraxhi", Pogradec;
- Vijon financimi për rikonstruksion/ndërtimim për godinën e shkollës dhe repartet e praktikave profesionale të Shkollës Teknike, Korçë;
- Vijon financimi për rikonstruksion Shkolla "Arben Broci", Shkodër;
- Vijon financimi për ndërtim/rikonstruksion Shkolla "Hamdi Bushati", Shkodër;
- Vijon financimi për ndërtimi i ri i Shkollës Karl Gega Tiranë.

MJEDISI

Prioritetet për periudhën 2027-2029

Në fushën e Mjedisit, synohet sigurimi dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit duke:

- Siguruar kushtet për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe uljes së ndotjes akustike në zonat kryesore urbane;
- Përmes menaxhimit të integruar të mbetjeve nëpërmjet trajtimit sipas hierarkisë dhe rehabilitimit të pikave të nxehta mjedisore;
- Parandalimit dhe kontrollit të integruar të ndotjes dhe rreziqeve nga aksidentet industriale, përmirësimit të menaxhimit të kimikateve;
- Përshpejtimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe zbutjes së gazeve me efekt serrë;
- Ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit dhe menaxhimit të integruar të Zonave të Mbrojtura.

Rezultatet që synohen të arrihen gjatë periudhës 2027-2029:

- Synohet përmirësimi i cilësisë së mjedisit, duke arritur një ulje të ndotjes akustike në zonat urbane me rreth 17% në vit;
- Monitorimi i ujërave sipërfaqësore pritet të intensifikohet, përmes realizimit të rreth 494 monitorimeve çdo vit;
- Zhvillimi i politikave në fushën e ndryshimeve klimatike përbën një ndër prioritetet kryesore, me synimin për hartimin e rreth 5 politikave të reja çdo vit;
- Zbatimi i legjislacionit mjedisor forcohet përmes realizimit të rreth 1,500 inspektimeve çdo vit;
- Ndërveprimi ndërinstitucional në fushën e kimikateve parashihet të konsolidohet përmes zhvillimit të takimeve koordinuese dhe mekanizmave bashkëpunues;
- Rritja e sipërfaqes së zonave të mbrojtura synohet të arrijë në rreth 24% deri në vitin 2029;
- Përdorimi i qëndrueshëm i biodiversitetit pritet të përmirësohet, duke arritur në nivelin 68%;
- Monitorimi i burimeve gjenetike pyjore do të zhvillohet më tej, duke arritur në rreth 140 monitorime deri në vitin 2029;
- Rritja e përqindjes së mbetjeve të trajtuara me standarde kundrejt sasisë totale të mbetjeve të prodhuara synon rritjen në 75% gjatë periudhës;
- Rritja e impianteve rajonale të trajnimit të mbetjeve të ndërtuara kundrejt totalit të nevojshëm për trajtimin e të gjithë mbetjeve të prodhuara në 90% ndaj periudhës.

TURIZMI, KULTURA DHE SPORTI

Prioritetet 2027-2029:

Në fushën e Turizmit, synojmë kthimin e Shqipërisë në një destinacion tërheqës turistik, cilësor dhe të qëndrueshëm, duke shfrytëzuar potenciale dhe burime lokale, duke u fokusuar në atë çka është unike në vendin tonë.

- Diversifikimi i produktit turistik për të arritur një turizëm gjithëvjetor duke promovuar gjerësisht Shqipërinë në komunitetin ndërkombëtar s i një destinacion i denjë për konkuruar globalisht;
- Sigurimi e zhvillimi i qëndrueshëm i zonës bregdetare, nëpërmjet ofrimit të shërbimit të pastrimit gjatë sezonit turistik, me qëllim rritjen e turistëve të huaj;
- Zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve të reja në turizëm, si dhe përmirësimi i imazhit të vendit duke promovuar produkte lokale;

Në fushat e kulturës dhe trashëgimisë kulturore do të prioritizohet:

- Përmirësimi dhe zgjerimi i tregjeve kulturore përmes legjislacionit nga i cili do të përfitojnë krijuesit, krijimtaria artistike dhe kulturore dhe trashëgimia kulturore;
- Krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm ligjor e institucional për zhvillimin e artit dhe kulturës;
- Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë materiale dhe jomateriale kulturore;
- Rehabilitimi i trashëgimisë arkitektonike, muzeve dhe peizazhit përmes rritjes së numrit të monumenteve dhe muzeve të rehabilituara;
- Nxitja dhe përfaqësimi i vlerave kulturore të arteve dhe trashëgimisë (materiale dhe jomateriale) shqiptare në aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare dhe prezantimi i praktikave të mira;
- Promovimi i vlerave të artit, trashëgimisë kulturore dhe fondeve muzeore;
- Mbështetja e krijimtarisë së artistëve shqiptar dhe shtimi i veprimtarive kulturore dhe artistike;

- Rritja e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të shërbimeve në infrastrukturë, si dhe rritjen e cilësisë artistike;
- Hartimi dhe zbatimi i një platforme arsimore përmes institucioneve të artit dhe trashëgimisë kulturore dhe sistemit parauniversitar;
- Zhvillimi i audiencave;
- Pasurimin e fondeve artistike në teatër - muzikë - arte pamore - film- balet- ansambël popullor dhe digjitalizimi i tyre në nivel kombëtarë.

Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2027-2029

Për Turizmin:

- Kontributi i Turizmit në PPB për periudhën 2027-2029 parashikohet të jetë rreth 33%.
- Niveli i punësimit në sektorin e turizmit pritet të rritet nga 8.6% në vitin 2026, në 8.7% në vitin 2027 dhe 8.8% në vitet 2028-2029.
- Numri e numrit të strukturave akomoduese nga 2100 në vitin 2027 në 2150 në vitin 2029.
- Rritja e numrit të bizneseve në sektorin e agriturizmit, nga 400 në vitin 2027 në 650 në vitin 2029;
- Rritja e numrit të shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri, nga 15.5 milion në vitin 2027 në 16 milion në vitin 2029.
- Rritja e numrit të vizitorëve në sitet kulturore, nga 950 mijë në vitin 2027 në 980 mijë në vitin 2029.
- Diversifikimi i produktit turistik për të arritur një turizëm gjithëvjetor.

Për Trashëgiminë kulturore

- Restaurimi dhe mirëmbajtja e trashëgimisë arkitektonike dhe peisazhit, duke përfshirë restaurimin e disa linjave muzeale, si edhe përshtatjen me standarde bashkëkohore. Parashikohen rreth 156 objekte të trashëgimisë arkitektonike dhe peisazhit të restauruara dhe mirëmbajtura në periudhën 2027-2029.
- Rritja e aksesit të publikut në Muze, Monumentet e kulturës dhe Parqe Arkeologjike në funksion të turizmit kulturor (nr. Vizitorësh), rreth 235 mijë vizitorë në vitet 2027-2029.
- Rritja e mbështetjes për aktiviteteve të fushës së trashëgimisë kulturore rreth 150 aktivitete të mbështetura financiarisht në vitet 2027-2029.

Për Artin dhe Kulturën

- Rritja e aksesit në kulturë, e cila parashikon një rritje të vazhdueshme të numrit dhe cilësisë së aktiviteteve në të gjitha zhanret. Rrjet aktivitetesh që synojnë në konsolidimin e vlerave artistike, promovimin e Artit Shqiptar në arenën ndërkombëtare, mbështetja e aktiviteteve kulturore në mbarë vendin nëpërmjet thirrjeve për aplikime në fushën e artit dhe kulturës librit dhe përkthimit.
- Prioritet do të jetë integrimi, angazhimi dhe promovimi i të rinjve më të evidentuar të kësaj fushe.
- Nxitja e konkurrencës artistike përmes audicioneve dhe konkurrimit publik krahasuar me një vit më parë.
- Rritja e numrit të aktiviteteve sensibilizuese/edukuese, artistike përmes promovimit të industrive krijuese në rang vendi, nga 440 aktivitete në vitin 2027, në 450 aktivitete në vitet 2028-2029.

- Rritja e numrit të projekteve me thirrje në mbështetje e industrive krijuese duke respektuar barazinë gjinore, të drejtat e njeriut, grupet e margjinalizuara dhe diversitetin kulturor në rang vendi nga 278 në vitin 2027 në 285 në vitin 2029.
- Mbështetja e skenës së pavarur për të mundësuar edukimin përmes kulturës si dhe përfaqësimin e produktit artistik në arenën elitare ndërkombëtare.
- Rritja e numrit të studenteve të punësuar të angazhuar në shfaqje dhe programe kulturore në rang vendi (Pakti i Sudentit) nga 80 studentë në vitin 2027 në 85 studentë deri në vitin 2028.
- Rritja e numrit të aktiviteteve nga kalendarët artistik të zhvilluara nga Institucionet qëndrore publike të art – kulturës, nga 720 aktivitete në vitin 2027 në 760 aktivitete në vitin 2029.

DREJTËSIA

Prioritetet 2027-2029:

Ministria e Drejtësisë, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, ushtron funksione dhe ka në kompetencë hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale dhe civile, sistemin e shërbimeve të lira juridiko-profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën civile dhe penale, fushat e tjera të drejtësisë dhe të kompetencës së saj sipas ligjit, si dhe për bashkërendimin, harmonizimin dhe reformimin e legjislacionit shqiptar në tërësi.

Në funksion të përparësive kryesore të Ministrisë së Drejtësisë, janë përcaktuar dhe objektivat për realizimin e tyre për periudhën 2027-2029, të cilat janë:

a) Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe miratimi i akteve nënligjore për zbatimin e reformës në drejtësi;
b) Konsolidimi i reformës në drejtësinë për të miturit në konflikt me ligjin;
c) Rritja e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve publike;
d) Forcimi i reformave legjislative institucionale dhe strukturore në institucionet ligjzbatuese;
e) Përmirësimi i sistemit të ndihmës juridike falas për grupet në nevojë dhe qytetarët me pamundësi financiare.

Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2027-2029

- Të mbahen në kushte të përshtatshme rreth 5,500 të dënuar burra, 86 të dënuara gra dhe 36 të dënuar të mitur, si dhe të trajtohen me shërbim shëndetësor 438 të dënuar të sëmurë;
- Të ri-integrohen nëpërmjet zhvillimit të programeve për rehabilitimin në shoqëri të paraburgosurve dhe të dënuarve në përputhje me standartet europiane, rreth 360 të dënuar burra, 2 të dënuara gra dhe 6 të dënuar të mitur;
- Të ofrojë këshillim dhe përfaqësim ligjor në gjykatë për individët që plotësojnë kushtet në zbatim të ligjit për ndihmën juridike falas, rreth 3,000 akte në total.
- Të ofrojë ndihmë juridike për rreth 3,000 gra e vajza në nevojë të cilat plotësojnë kushtet.
- Të mbikqyrë në mënyrë efektive nga 8,000-9,000 burra, 850 gra dhe 250 të mitur gjatë shërbimit të provës.
- Realizimin e skemës së shpërndarjes së Fondit Special të Kompensimit nga 926 vendime të trajtuara me kompensim kundrejt totalit të vendimeve të Regjistrit elektronik të ATP-së të parashikuar për vitin 2027, në 1,176 për vitin 2029.

- Rritjen e numri të titujve të ekzekutuara brenda afateve ligjore nga 16,403 në 2027, në 17,720 në vitin 2029.
- Të garantojë interesin më të lartë të fëmijëve, nëpërmjet vendosjes në familje të përhershme që përshtaten me nevoja specifike të secilit prej tyre, me synimin që 100% e totalit të birësimeve të rezultojnë të suksesshme.

POLITIKA E JASHTME

Prioritetet 2027-2029:

Orientimi i politikës së jashtme për tre vitet e PBA-së 2027-2029, do të jetë drejt zgjerimit, intensifikimit, diversifikimit, thellimit dhe pasurimit të marrëdhënieve dypalëshe me vendet fqinje, partnerët strategjik në rajon, Evropën dhe vendet e tjera të botës.

Objektivat kryesorë që synohen të arrihen nga aktiviteti i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për vitin 2027-2029 janë:

- Vijimi i angazhimit politik e diplomatik të MEPJ dhe përfaqësive në shtetet anëtare të BE për avancimin e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian;
- Forcimi i dialogut me institucionet e BE, në të gjitha nivelet dhe formatet, lidhur me çështje të politikës së përbashkët të jashtme e të sigurisë, përfshirë sanksionet e BE dhe zbatimin e tyre në territorin shqiptar;
- Kryerja me sukses e procesit të negociatave të anëtarësimit për të gjitha çështjet në grup kapitujt e acquis të BE-së, ku MEPJ është kryesuese (kapitulli 31) apo kontribuuese (kapitulli 24 dhe kapitulli 30);
- Ruajtja e rolit aktiv dhe kontributit të Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare, në zbatim të prioriteteve të politikës sonë të jashtme dhe në funksion të paqes, sigurisë dhe adresimit të sfidave të përbashkëta, me qëllim realizimin e një përfaqësimi sa më dinjitoz në OKB dhe organizatat ndërkombëtare;
- Angazhim dhe kontribut i shtuar/intensiv e strukturave ne MEPJ dhe misioneve të Përhershme të RSH në Gjenevë, Nju Jork dhe Vjenë. Gjatë 2027-2029 parashikohet angazhim i gjerë ndërkombëtar përmes pjesëmarrjes në delegacione të nivelit të lartë në sesione kyçe të OKB-së dhe KDNJ, aktiviteteve dhe takimeve të nivelit të lartë në kuadër të OKB-së, OSBE-së, Këshillit të Evropës, Frakofonisë dhe forumeve të tjera, organizimit të eventeve anësore, si dhe përgatitjes dhe mbrojtjes së raporteve kombëtare në fushën e të drejtave të njeriut.
- Vijimësi e angazhimit proaktiv të vendit, pas përfundimit të mandatit si anëtar jo i përhershëm i KS të OKB-së (2022-2023), anëtarësimi në ECOSOC dhe ICH të Unesco.
- Si anëtare e NATO-s, Shqipëria do vijojë të jetë pjesë aktive e vullnetit të palëkundur të Aleancës Atlantike për të siguruar dhe mbrojtur çdo pëllëmbë të territorit aleat, duke kontribuar ushtarakisht në përforcimin më të madh të NATO-s në Lindje të territorit aleat që nga Lufta e Ftohtë. Ajo do të

kontribuojë aktivisht në unitetin e Aleancës dhe në rëndësinë thelbësore të lidhjes Transatlantike, në mënyrë që NATO të mbetet kolonë stabiliteti për gjeneratat e ardhshme.

- Forcimi i marrëdhënieve me vendet e rajonit dhe bashkëpunimit rajonal;
- Konsolidim i marrëdhënieve me Kosovën, përmes G2G, zbatimit të marrëveshjeve të përbashkëta, angazhimit për njohjen ndërkombëtare te shtetit te Kosovës, për pjesëmarrjen dhe anëtarësimin e saj në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, etj.
- Forcimi i marrëdhënieve me të gjithë faktorin shqiptar në rajon (në Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi, Serbi-Luginën e Preshevës) dhe rritja e kujdesit dhe interesimit për këtë faktor. Kjo përfshin ngritjen dhe mirëfunksionimin e drejtorie të dedikuar, Drejtorisë së Bashkëpunimit me Faktorin Shqiptar në Rajon, që ka në fokus sistemimin dhe intensifikimin e bashkëpunimit dhe mbështetjes për këtë faktor jo vetëm në aspektin politik, por edhe ekonomik, arsimor, kulturor, zhvillimor, të pushteteve vendore, etj, me qëllim ruajtjen dhe kultivimin e boshtit, identitetit albanocentrist në rezistencë me presionet me të cilat përballet ky identitet në vendet e rajonit.
- Zhvillimi i mëtejshëm i marrëdhënieve me vendet e tjera, me prioritet marrëdhëniet me partnerët strategjikë, vendet mike dhe aleate; vënia në efikasitet i ambasadave të reja të sapohapura në Azerbaixhan, Ukrainë, Kenia, Bosnje dhe Hercegovinë e Indonezi, si dhe hapja e ambasadës në Indi. Rivlerësimi i rrjetit të përfaqësive dhe zgjerimi i mëtejshëm i tij në vende ku nuk kemi prezencë;
- Forcimi i dimensionit të diplomacisë ekonomike në strukturë, përmbajtje dhe mekanizma të reja për një qasje pro-aktive dhe gjithëpërfshirëse, me krijimin e Bordit te Investimeve dhe Eksporteve dhe Rrjetit te atasheve tregtar të nderit/ këshilltarëve të jashtëm, për të maksimizuar fitimet tona kombëtare në tregti dhe investime, rritur bashkëveprimin ekonomik me botën e jashtme, promovuar dhe mbrojtur interesat kombëtare ekonomike, nxitur zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të vendit dhe gjetur në arenën ekonomike botërore tregje e partnerë të rinj për tregti, eksport, biznes dhe know-how; promovimin dhe rritjen e imazhit të Shqipërisë jashtë kufijve, si dhe forcimin e brand-it të saj si destinacion turistik.
- Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë për të gjetur mundësi dhe zbatuar projekte që i sjellin shqiptarët e diasporës gjithmonë e më afër vendit të tyre. Marrëveshje me vende të ndryshme që synojnë të ndihmojnë dhe lehtësojnë jetën e përditshme të diasporës (marrëveshje për njohjen e lejeve të drejtimit dhe ato për sigurimet shoqërore);
- Modernizimi i shërbimeve konsullore në përmbushje të detyrave që rrjedhin nga Strategjia Kombëtare për Diasporën, duke synuar përafrimin e diasporës me vendin, identifikimin e nevojave dhe problemeve të tyre dhe ndërmjetësimi për zgjidhjen e tyre në vendin pritës;

MBROJTJA

Prioritetet 2027-2029:

Ministria e Mbrojtjes synon të përmbushë reformat e nisura dhe realizimin e detyrave kushtetuese të Forcave të Armatosura (FA), angazhimeve ndërkombëtare në kuadër të NATO-s, angazhimeve të FA në kuadër rajonal dhe në aftësitë trajnuese të vetë FA.

Me këtë buxhet, Ministria e Mbrojtjes synon:

- Modernizimin e kapaciteteve dhe infrastrukturës së FA duke:
  - zhvilluar kapacitetet e FA në përputhje me Planin Afatgjatë të Zhvillimit;
  - vijuar pajisjen e Forcave Tokësore me armatim të ri të ndërveprueshëm me aleatët në NATO;
  - zgjeruar investimet në infrastrukturë për përmirësimin e mjediseve të punës dhe ushtarake;
  - modernizuar pajisjet dhe sistemet kompjuterike.
- Vijimin e pjesëmarrjes në operacionet e NATO-s duke rritur nivelin e angazhimit të FA, në operacionet e Aleancës dhe pjesëmarrjen në misionet e iniciativat e reja që NATO mund të ndërmarrë.
- Zhvillimin dhe mbajtja në gatishmëri të kapaciteteve të FA për operacione të mbrojtjes kombëtare dhe kolektive, operacione në përgjigje të krizave, si dhe kapacitetet për përballimin e Emergjencave Civile, dhënien e ndihmës vendeve të rajonit në rast emergjencash civile në kuadrin e NATO-s, OKB-se dhe BE-së.
- Lartësimin e figurës dhe integritetit të ushtarakut, nëpërmjet zhvillimit të politikave të nevojshme në fushën e personelit, promovimit në karrierë, trajtimit të ushtarakut, rritjes së transparencës, llogaridhënies, si dhe eliminimin e korrupsionit në Forcat e Armatosura.

RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

Prioritetet 2027-2029

Ministria e Brendshme synon mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe garantimin e sigurisë së jetës, shëndetit dhe pronës së qytetarit, të cilat janë dhe prioritete për veprimtarinë e Policisë së Shtetit, e cila do të ketë si togfjalësh kyç në veprimtarinë e saj, 'kontrollin e territorit' dhe 'policimin në komunitet', të realizuara në praktikë përmes riorganizimit të sistemit të prezencës së policisë në territor, në funksion të një kontrolli më efektiv të tij dhe transformimin rrënjësor të marrëdhënieve dhe shërbimit ndaj komunitetit. Gjithashtu, synon sigurimin e rendit publik, pronës publike e private, rritjen e parametrave të sigurisë rrugore, krijimin e një mjedisi të sigurt për komunitetin, nëpërmjet shërbimeve profesionale, në kohë dhe me cilësi dhe policimit me standardet me të larta të përformancës.

Ministria e Brendshme synon të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të Sigurisë së Personaliteteve Vendas dhe të Huaj, të Objekteve të Rëndësisë së Veçantë nëpërmjet rritjes së kapaciteteve menaxhuese dhe përputhjes me standartet europiane në fushën e sigurisë. Gjithashtu, Ministria e Brendshme synon konsolidimin e mëtejshëm të një sistemi bashkëkohor të dixhitalizuar të regjistrit kombëtar të gjendjes civile (RKGJC), të sistemit të regjistrit kombëtar të adresave (RKA) dhe sistemit të personalizimit dhe shpërndarjes së letërnjoftimit elektronik dhe pasaportës biometrike.

Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2027-2029

Përgjatë 3 viteve 2027-2029, Ministria e Brendshme do të përmbushë objektivat e saj si vijon:

- Rritja e sigurisë publike dhe sigurisë rrugore përmes patrullimeve në rrugë dhe forcimit të kontrollit të territorit me policimin në komunitet, duke synuar ruajtjen e kohës së reagimit të shërbimit policor në 13 minuta përgjatë gjithë periudhës 2027-2029.
- Rritja e operacioneve policore të hetuara dhe shërbimeve të kryera në 38,798 operacione në vitin 2027, 39,105 operacione në vitin 2028 dhe 39,564 operacione në vitin 2029, ose mesatarisht rreth 39,156 operacione në vit gjatë periudhës 2027-2029.
- Ulja e përqindjes së viktimave të dëmtuara nga dhuna në familje sipas gjinisë, për të cilat është plotësuar kërkesë-padi për urdhër mbrojtjeje, nga 1% në vitin 2026 në 0.8% në vitin 2027 dhe 0.6% në vitet 2028-2029.
- Rritja e sigurisë rrugore nëpërmjet patrullimeve dhe monitorimit inteligjent të trafikut, duke synuar uljen e numrit të aksidenteve me pasojë vdekjen nga 165 raste në vitin 2026 në 160 raste në vitin 2027, 155 raste në vitin 2028 dhe 153 raste në vitin 2029.
- Përmes implementimit të sistemit SMART CITY, synohet ulja e numrit të veprave penale në mbrojtje të jetës dhe pronës në zonat e monitoruara nga kamerat inteligjente nga 20% në vitin 2026 në 80% gjatë viteve 2027-2028 dhe 90% në vitin 2029.
- Ruajtja e kohës së reagimit ndaj rasteve të dhunës në familje në nivelin 13 minuta përgjatë periudhës 2027-2029.
- Rritja e hetimeve proaktive në fushën kundër korrupsionit dhe veprave penale në detyrë nga 429 hetime në vitin 2026 në 437 hetime në vitin 2027, 440 hetime në vitin 2028 dhe 445 hetime në vitin 2029.
- Rritja e hetimeve proaktive për pastrimin e produkteve të veprës penale nga 424 hetime në vitin 2026 në 426 hetime në vitin 2027, 428 hetime në vitin 2028 dhe 430 hetime në vitin 2029.
- Rritja e hetimeve proaktive për individë dhe grupe me tendenca terroriste, nga 7% në vitin 2027, në 8% në vitin 2028 dhe 9% në vitin 2029.
- Rritja e numrit të punonjëseve femra në strukturat e Policisë së Shtetit nga 1,888 punonjëse në vitin 2026 në 1,971 punonjëse në vitin 2027 dhe 2028, dhe 2,054 punonjëse në vitin 2029, në përputhje me objektivat për forcimin e përfaqësimit gjinor.
- Forcimi i kontrollit kufitar dhe luftës kundër trafikimeve të paligjshme, duke synuar uljen e rasteve të trafikimit të lëndëve të parregullta në kufi nga 31 raste në vitin 2026 në 30 raste në vitin 2027, 28 raste në vitin 2028 dhe 26 raste në vitin 2029.
- Përmirësimi i vazhdueshëm i sigurisë së personaliteteve vendase dhe të huaja, si dhe i objekteve të rëndësisë së veçantë, nëpërmjet përafrimit gradual me standardin gjerman të sigurisë, ku niveli i përputhjes parashikohet të rritet nga 39 në vitin 2027, në 40 në vitin 2028 dhe 44 në vitin 2029.
- Përdorimi efektiv i regjistrit kombëtar të gjendjes civile dhe përditësimi në kohë reale i ngjarjeve civile, duke synuar reduktimin e kohës së trajtimit të kërkesave nga sistemi i RKGJ-së nga 0.4 orë në vitet 2027-2028 në 0.35 orë në vitin 2029.
- Rritja e numrit të shërbimeve online të ofruara nga Gjendja Civile nga 31 shërbime në vitin 2027 në 32 shërbime në vitet 2028-2029, në funksion të përmirësimit të aksesit dhe digjitalizimit të shërbimeve publike.
- Rritja e numrit të çështjeve të përfunduara nga institucioni i prefektit kundrejt numrit total të çështjeve të paraqitura nga institucionet dhe qytetarët, nga 66% në vitin 2026 në 67% gjatë periudhës 2027-2029, duke synuar forcimin e rolit koordinues dhe monitorues të prefekturave në nivel vendor.

BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR

Për vitin 2027, Qeveria Shqiptare vijon angazhimin për integrimin e barazisë gjinore në planifikimin dhe përdorimin e burimeve publike, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 dhe kuadrin ligjor të menaxhimit të sistemit buxhetor. Përmes buxhetimit të përgjigjshëm gjinor dhe në zbatim të ligjit nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe procedurave të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), synohet që programet dhe shërbimet publike të marrin në konsideratë nevojat e ndryshme të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve, si dhe të adresojnë pabarazitë e evidentuara në sektorët përkatës.

Qasja e analizës së shpenzimeve buxhetore që adresojnë çështje të pabarazive gjinore, është e orientuar drejt rezultateve duke identifikuar programet që kontribuojnë në barazinë gjinore, produktet dhe treguesit e matshëm, si dhe kostot e lidhura me to, aty ku informacioni e lejon. Gjithsesi shpenzimet e identifikuara nuk barazohen automatikisht me ndikimin real në barazinë gjinore, i cili do të përcaktohet vetëm më anë të monitorimit dhe vlerësimit të ndryshimeve që ndodhin realisht në jetët e grave dhe burrave, vajzave dhe djemve në Shqipëri.

Vlera e shpenzimeve të identifikuara si të lidhura me buxhetimin e përgjigjshëm gjinor për vitin 2027 është rreth 88.36 miliardë lekë cka përben rreth 9.1% të totalit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2027.
Pjesa më e madhe e shumës së identifikuar përqendrohet në arsim (rreth 29.25 miliardë lekë), shëndetësi dhe mbrojtje sociale (rreth 26.02 miliardë lekë), si dhe ekonomi dhe inovacion (rreth 22.65 miliardë lekë). Në sektorë të tjerë përfshihen siguria publike, mbrojtja, bujqësia dhe zhvillimi rural, drejtësia dhe shërbimet e tjera publike.

Më konkretisht, prioritetet dhe rezultatet e pritshme për vitin 2027, parashikohen si më poshtë:

Mbrojtja sociale, përfshirja ekonomike dhe strehimi

Mbështetja e personave dhe familjeve në nevojë, përmirësimi i aksesit në shërbimet sociale dhe rritja e mundësive për pjesëmarrje ekonomike mbeten drejtime të rëndësishme të ndërhyrjes publike. Në programin e strehimit, për vitin 2027 parashikohen 2,200 përfitues nga kategoritë "femra të dhunuara" dhe "gra kryefamiljare". Ky tregues orienton vëmendjen drejt aksesit në strehim të përshtatshëm të kategorive që përballen me rrezik më të lartë përjashtimi social.

Bujqësia dhe zhvillimi rural

Politikat e zhvillimit rural synojnë zgjerimin e aksesit të grave në informacion, këshillim dhe skema mbështetëse. Në vitin 2027 parashikohet që 560 gra fermere të informohen dhe trajnohen nga shërbimi këshillimor publik, me kosto të produktit prej 2.6 milionë lekësh. Për skemat kombëtare të mbështetjes parashikohen 6,650 gra përfituese dhe një tregues prej 15% për pjesëmarrjen e grave sipas përkufizimit të përdorur në PBA me një kosto prej rreth 891.36 milionë lekësh.

Zhvillimi ekonomik, sipërmarrja dhe inovacioni

Mbështetja e sipërmarrjes synon të rrisë mundësitë e grave për të përfituar nga instrumentet publike të zhvillimit ekonomik. Për vitin 2027 synohet që 10% e start-up-eve të mbështetura të jenë të drejtuara ose të themeluara nga gra; në aneks për këtë tregues është përllogaritur një kosto gjinore prej 30 milionë lekësh. Për grantet e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme parashikohen 26 ndërmarrje me drejtuese gra që përfitojnë nga fondet publike, ndërsa kostoja gjinore e përllogaritur e produktit është 65 milionë lekë.

Arsimi, shëndetësia dhe kujdesi

Në arsim dhe shëndetësi, integrimi i perspektivës gjinore synon të përmirësojë aksesin dhe cilësinë e shërbimeve për vajzat dhe djemtë, gratë dhe burrat, përfshirë grupet me nevoja të veçanta. Këta sektorë përbëjnë pjesë të konsiderueshme të kostove të identifikuara në përmbledhjen financiare.

Në sektorin e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, shpenzimet e identifikuara me dimension gjinor arrijnë në rreth 26.02 miliardë lekë, nga të cilat rreth 20.60 miliardë lekë lidhen me përkujdesjen sociale, 5.03 miliardë lekë me shërbimin dytësor, 352.3 milionë lekë me shërbimin parësor dhe 40.9 milionë lekë me shëndetin publik. Në shërbimin parësor, parashikohen 273.6 milionë lekë për shërbimet e kontrollit shëndetësor (check-up) për gratë dhe 78.7 milionë lekë për trajtimin e grave në klinika dhe të fëmijëve 0–1 vjeç, me tregues prej 35,200 përfituesish për produktin e dytë. Në shërbimin dytësor, 4.05 miliardë lekë lidhen me trajtimin e 52,700 pacientëve në maternitete shtetërore; gjithashtu parashikohen 37.5 milionë lekë për paketat e fertilitetit për 200 çifte, 70 milionë lekë për 350 paciente që përfitojnë ndërhyrje të rikonstruksionit të gjirit dhe 868.3 milionë lekë për ndërtimin e materniteteve të reja. Në shëndetin publik, 13.14 milionë lekë lidhen me depistimin e kancerit të gjirit për 5,000 gra dhe 27.79 milionë lekë me depistimin e kancerit të qafës së mitrës për 12,500 gra. Këto alokime tregojnë fokusin te shëndeti riprodhues, diagnostikimi i hershëm dhe kujdesi amtar, ndërsa matja e ndikimit kërkon krahasimin e realizimit faktik me objektivat e planifikuara.

Në sektorin e arsimit, shpenzimet e identifikuara me dimension gjinor për vitin 2027 arrijnë në rreth 29.25 miliardë lekë, sipas tabelës përmbledhëse, të shpërndara në arsimin bazë (18.03 miliardë lekë), arsimin e mesëm të përgjithshëm (5.35 miliardë lekë) dhe arsimin e lartë (5.86 miliardë lekë). Kjo shumë përfaqëson rreth 44.1% të buxhetit të sektorit të arsimit të paraqitur në tabelën Excel (66.27 miliardë lekë). Në arsimin bazë, parashikohen shpenzime të lidhura me arsimimin e 33,120 vajzave në zonat rurale (rreth 4.64 miliardë lekë) dhe 95,680 vajzave në zonat urbane (rreth 13.40 miliardë lekë). Për arsimin e mesëm, parashikohen 5.35 miliardë lekë për 32,097 vajza, ndërsa për arsimin e lartë 5.86 miliardë lekë për 38,500 vajza në ciklin e parë. Këto tregues e vendosin aksesin dhe vijueshmërinë në arsim në qendër të raportimit gjinor.

Siguria publike, drejtësia dhe mbrojtja nga dhuna

Programet në fushën e rendit dhe drejtësisë synojnë forcimin e përgjigjes institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore, aksesin në shërbime dhe përfaqësimin e barabartë. Përfshirja e treguesve të ndarë sipas gjinisë në programet përkatëse lejon monitorimin e rezultateve konkrete për të kuptuar më mirë se si këto politika adresojnë nevojat direkte të grave dhe vajzave.

Ministria e Financave, në bashkëpunim me institucionet buxhetore, do të ndjekë ecurinë e objektivave dhe produkteve me tregues gjinorë gjatë zbatimit të buxhetit. Për treguesit që nuk lidhen drejtpërdrejt me produkte të identifikuara, aneksi i PBA-së parashikon trajtimin e tyre si tregues monitorues; përllogaritja e kostove mund të bëhet pas disponimit të të dhënave faktike. Kjo qasje shmang mbivlerësimin e shpenzimeve gjinore dhe forcon gjurmueshmërinë e rezultateve.

Në përfundim, projektbuxheti i vitit 2027 vijon përfshirjen e dimensionit gjinor në politikat sektoriale dhe në programimin afatmesëm. Konsolidimi i kostove, i treguesve të performancës dhe i të dhënave të ndara sipas gjinisë do të shërbejë për një raportim më të saktë mbi kontributin e buxhetit të shtetit në reduktimin e pabarazive gjinore.

Informacione më të hollësishme rreth shpenzimeve të parashikuara gjatë 2027 për realizimin e politikave gjinore jepen në Kapitullin 9.6 më poshtë.

5. BUXHETI VENDOR 2027

Menaxhimi Financiar Publik në nivel vendor, thellimi i decentralizimit fiskal, forcimi i autonomisë financiare dhe zbatimi i reformës së re administrativo-territoriale përbëjnë prioritete strategjike të Ministrisë së Financave për vitin 2027. Këto reforma synojnë krijimin e njësive të vetëqeverisjes vendore më të qendrueshme financiarisht, me kapacitete më të larta administrative dhe me aftësi më të mira për planifikimin, financimin dhe ofrimin e shërbimeve publike cilësore për qytetarët.

Në kuadër të përgatitjes së Buxhetit Vendor 2027, Ministria e Financave do të vijojë angazhimin për thellimin e decentralizimit fiskal dhe forcimin e autonomisë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me prioritetet e integrimit evropian, standardet e menaxhimit financiar publik dhe objektivat e reformës së re administrativo-territoriale. Kjo reformë synon rritjen e përgjegjshmërisë fiskale, përmirësimin e qeverisjes vendore dhe zgjerimin e kapaciteteve të bashkive për të planifikuar, menaxhuar dhe financuar në mënyrë të qendrueshme zhvillimin lokal.

Politikat e financave vendore gjatë vitit 2027 do të orientohen drejt rritjes së eficiencës dhe efektivitetit në përdorimin e fondeve publike, forcimit të qendrueshmërisë financiare të pushtetit vendor, nëpërmjet rritjes së të ardhurave vendore dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike për qytetarët. Në këtë kuadër do të vijojë mbështetja e bashkive për përmirësimin e performancës financiare, forcimin e disiplinës fiskale dhe zbatimin e praktikave bashkëkohore të menaxhimit financiar.

Një prioritet i rëndësishëm për vitin 2027 do të jetë konsolidimi i reformës së menaxhimit financiar publik në nivel vendor përmes zgjerimit të përdorimit të Sistemit të Integruar të Menaxhimit Financiar (AFMIS), si dhe integrimit të mëtejshëm të proceseve të planifikimit, ekzekutimit, monitorimit dhe raportimit buxhetor. Kjo do të mundësojë rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe kontrollit mbi përdorimin e fondeve publike, përmirësimin e cilësisë së të dhënave financiare dhe forcimin e proceseve të vendimmarrjes bazuar në performancë.

Gjithashtu, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet forcimit të mekanizmave të barazimit fiskal, përmirësimit të sistemit të transfertave ndërqeveritare, rritjes së kapaciteteve institucionale të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe mbështetjes së investimeve vendore, me synim sigurimin e një zhvillimi të balancuar territorial dhe ofrimin e shërbimeve publike më cilësore e më të qendrueshme për komunitetet lokale.

Financat vendore do të orientohen drejt modernizimit të mëtejshëm të sistemit të qeverisjes financiare, në funksion të përballimit të sfidave të zhvillimit ekonomik e territorial dhe përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integrimit evropian. Në këtë kuadër, ato do të shërbejnë si një instrument kyç për promovimin e zhvillimit vendor, garantimin e përdorimit efikas, ekonomik dhe efektiv të fondeve publike, si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për komunitetet lokale.

Në përputhje me objektivat e reformës së re administrativo-territoriale, procesi i konsolidimit institucional të njësive të vetëqeverisjes vendore do të shoqërohet me reforma të thelluara në financat vendore, të fokusuara në rritjen e kapaciteteve administrative dhe financiare, përmirësimin e mekanizmave të planifikimit dhe menaxhimit buxhetor, si dhe forcimin e llogaridhënies ndaj qytetarëve.

Në drejtim të administrimit fiskal vendor, fokusi do të jetë në rritjen e të ardhurave nga burimet e veta përmes reformimit dhe harmonizimit të politikave fiskale vendore, zgjerimit të bazës tatimore, përmirësimit

të administrimit të taksave dhe tarifave vendore dhe shfrytëzimit më efektiv të potencialit fiskal të çdo bashkie. Paralelisht, do të intensifikohet procesi i digjitalizimit të administrimit fiskal vendor, duke synuar përmirësimin e mbledhjes së të ardhurave, uljen e kostove administrative dhe rritjen e transparencës në marrëdhëniet me qytetarët dhe bizneset.

Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet forcimit të kapaciteteve profesionale të administratës vendore, me synim përmirësimin e performancës financiare dhe fiskale, rritjen e cilësisë së planifikimit buxhetor dhe garantimin e zbatimit efektiv të reformave në nivel vendor.

Buxheti Vendor 2027 synon gjithashtu forcimin e lidhjes ndërmjet financimit dhe performancës së njësive të vetëqeverisjes vendore. Në këtë kuadër, do të promovohen mekanizma financimi të bazuara në performancë, që nxisin eficiencën, transparencën, përgjegjshmërinë dhe rezultatet konkrete në ofrimin e shërbimeve publike. Mbështetja financiare do të orientohet gjithnjë e më shumë drejt bashkive që demonstrojnë menaxhim efektiv të burimeve publike, kapacitete të qendrueshme institucionale dhe rezultate të matshme në zhvillimin vendor.

Përmirësimi i treguesve të autonomisë financiare, konsolidimi i të ardhurave nga burimet e veta, rritja e investimeve publike vendore dhe forcimi i disiplinës fiskale do të mbeten tregues kryesorë për vlerësimin e performancës së qeverisjes vendore. Në këtë drejtim, Ministria e Financave do të vijojë reformimin e skemave të financimit vendor, përfshirë transfertën e pakushtëzuar, mekanizmat e barazimit fiskal dhe sistemin e ndarjes së të ardhurave tatimore, me qëllim garantimin e zhvillimit të balancuar territorial dhe reduktimin e pabarazive ndërmjet njësive vendore.

Gjithashtu, do të mbështetet rritja graduale e peshës së të ardhurave dhe shpenzimeve vendore ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe ndaj shpenzimeve të qeverisjes së përgjithshme, në funksion të forcimit të rolit të pushtetit vendor dhe zgjerimit të kapaciteteve të tij financiare për përmbushjen e kompetencave dhe përgjegjësive në rritje.

Përmes këtyre reformave dhe prioriteteve, Buxheti Vendor 2027 do të kontribuojë në ndërtimin e një sistemi të financave vendore më modern, më të qendrueshëm dhe më transparent, duke mbështetur zbatimin e reformës administrativo-territoriale, rritjen e autonomisë vendore, zhvillimin e balancuar të territorit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike për qytetarët në të gjithë vendin. Ndër arritjet më të rëndësishme të viteve të fundit të cilat krijojnë një bazë të qendrueshme për planifikimin dhe realizimin e objektivave të Buxhetit Vendor 2027, janë:

- Forcimi i mbështetjes financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVQV) përmes rritjes së transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe transfertave sektoriale, me synim garantimin e standardeve të unifikuara të shërbimeve publike dhe përballimin e përgjegjësive të reja që rrjedhin nga reforma administrativo-territoriale.
- Konsolidimi fiskal dhe rritja e qendrueshmërisë financiare të pushtetit vendor, në funksion të forcimit të autonomisë vendore dhe rritjes së aftësisë së bashkive për të planifikuar dhe ofruar shërbime publike cilësore e të qendrueshme.
- Mbështetja financiare për politikat e rritjes së pagave në administratën vendore, duke siguruar financimin e efekteve shtesë buxhetore të lidhura me politikat kombëtare të pagave, si dhe përmes rritjes së të ardhurave nga taksat e ndara dhe burime të tjera financiare të transferuara tek njësitë e vetëqeverisjes vendore.

- Përfundimi dhe vënia në funksion e platformave të integruara digjitale për menaxhimin financiar vendor, duke mundësuar hartimin online të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), buxhetit vjetor, monitorimin e performancës financiare dhe raportimin në kohë.
- Zgjerimi i zbatimit të metodologjisë së re të hartimit të programit buxhetor afatmesëm në nivel produkti në të gjitha bashkitë dhe qarqet. Monitorimi i pilotimit të bashkive në përgatitjen e buxhetit me një numër të reduktuar programesh dhe detajimin deri në nivel produkti.
- Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe profesionale të NJVQV-ve, përmes programeve të vazhdueshme të trajnimit, asistencës teknike dhe standardizimit të praktikave të menaxhimit financiar, në përputhje me strukturat e reja administrative që do të rezultojnë nga reforma administrativo-territoriale.
- Përmirësimi i cilësisë së dokumenteve financiare dhe buxhetore, nëpërmjet përdorimit të sistemeve moderne të menaxhimit financiar, automatizimit të proceseve dhe rritjes së kapaciteteve profesionale të administratës vendore.
- Forcimi i disiplinës fiskale dhe parandalimi i krijimit të detyrimeve të prapambetura, përmes ngritjes së mekanizmave të monitorimit dhe paralajmërimit financiar, me qëllim identifikimin në kohë të njësive që paraqesin rrezik financiar.
- Monitorimi i vazhdueshëm i treguesve të performancës fiskale dhe financiare, me fokus eficiencën, efektivitetin dhe cilësinë e përdorimit të fondeve publike në nivel vendor.
- Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të vështirësive financiare të NJVQV-ve, përmes monitorimit periodik të detyrimeve të prapambetura, hartimit të raporteve analitike periodike dhe ndërhyrjeve parandaluese për ruajtjen e stabilitetit financiar vendor.
- Forcimi i mekanizmave të mbikëqyrjes dhe koordinimit financiar ndërmjet qeverisë qendrore dhe qeverisjes vendore, me qëllim mbështetjen e bashkive në përballimin e sfidave financiare dhe përmirësimin e cilësisë së menaxhimit të fondeve publike.
- Ofrimi i asistencës teknike të specializuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore, gjatë gjithë ciklit të menaxhimit financiar, duke përfshirë planifikimin buxhetor, monitorimin e zbatimit të buxhetit, raportimin financiar dhe vlerësimin e performancës.
- Zbatimi gradual i Sistemit të Integruar të Menaxhimit Financiar Vendor (AFMIS) në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, si një nga shtyllat kryesore të modernizimit të financave vendore, duke garantuar transparencë, llogaridhënie, raportim të standardizuar dhe monitorim në kohë të fondeve publike
- Forcimi i sistemit të financimit të bazuar në performancë, duke orientuar gradualisht një pjesë të mbështetjes financiare drejt njësive vendore që demonstrojnë menaxhim të mirë financiar, nivel të lartë të të ardhurave nga burimet e veta, cilësi në ofrimin e shërbimeve dhe realizim të objektivave të zhvillimit vendor.
- Mbështetja e procesit të zbatimit të reformës administrativo-territoriale, përmes harmonizimit të kuadrit financiar dhe buxhetor me strukturat e reja të organizimit vendor, forcimit të ekonomive të shkallës, rritjes së eficiencës administrative dhe garantimit të qendrueshmërisë financiare afatgjatë të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Këto arritje përbëjnë bazën mbi të cilën do të mbështeten politikat dhe prioritetet e Buxhetit Vendor 2027, me synim ndërtimin e një sistemi financiar vendor më të qendrueshëm, transparent, të digjitalizuar dhe të orientuar drejt rezultateve, në funksion të përmirësimit të shërbimeve publike dhe zhvillimit të qendrueshëm lokal.

Objektivat e treguesve të financave publike vendore për vitin 2027

Financat vendore vijojnë të përbëjnë një instrument kyç për thellimin e decentralizimit fiskal dhe forcimin e autonomisë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore. Në kuadër të Buxhetit Vendor 2027, Ministria e Financave do të vijojë procesin e konsolidimit të menaxhimit të financave publike vendore, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e qendrueshmërisë fiskale, në mbështetje të zhvillimit vendor dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve publike për qytetarët.

Në përputhje me objektivat e reformës së Menaxhimit Financiar Publik dhe procesit të integrimit evropian, prioritet do të mbetet modernizimi i sistemit të financave vendore përmes rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, zgjerimit të digjitalizimit të proceseve financiare, si dhe forcimit të buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës. Buxheti Vendor 2027 synon të rrisë efikasitetin në përdorimin e fondeve publike, të forcojë autonominë fiskale të bashkive dhe të mbështesë zhvillimin e qendrueshëm ekonomik, social dhe territorial në të gjithë vendin.

- Në vitin 2027, buxheti vendor parashikohet në masën **114.6 miliardë lekë**, ose **2.4% më i lartë** krahasuar me nivelin e pritshëm të vitit 2026. Ecuria pozitive e të ardhurave vendore dhe rritja e mbështetjes nga buxheti i shtetit pritet të mundësojnë financimin e funksioneve vendore dhe realizimin e investimeve në përputhje me prioritetet e zhvillimit vendor.
- Rritja e mbështetjes nga buxheti i shtetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore do të vijojë edhe në vitin 2027, kryesisht nëpërmjet transfertave ndërqeveritare. Transferta e pakushtëzuar parashikohet në masën **29.3 miliardë lekë**, me një rritje prej **1.4 miliardë lekësh** kundrejt vitit 2026, duke garantuar financim më të lartë për ushtrimin e funksioneve vendore dhe rritjen e autonomisë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore.
- Përmirësimi i menaxhimit të financave vendore synon rritjen e peshës së taksave dhe tarifave lokale në strukturën e të ardhurave vendore, duke forcuar autonominë fiskale të njësive të vetëqeverisjes vendore. Të ardhurat e veta të pushtetit vendor parashikohet të arrijnë në **58.6 miliardë lekë** në vitin 2027, duke shënuar një rritje prej rreth **46.9 miliardë lekësh** krahasuar me vitin 2015. Krahasuar me vitin 2026, të ardhurat e veta parashikohen të rriten me rreth **712 milionë lekë**, ose **1.2%,** duke reflektuar përmirësimin e vazhdueshëm të administrimit fiskal vendor dhe zgjerimin e kapaciteteve për gjenerimin e të ardhurave nga burimet vendore.
- Transferta e pakushtëzuar për çdo bashki në vitin 2027 do të jetë me rritje mesatare në nivelin **rreth 5% dhe për qarqet me një rritje mesatare në nivelin rreth 4%** krahasuar me një vit më parë.
- Vazhdimi i financimit të funksioneve të transferuara në pushtetin vendor, në formën e transfertës së pakushtëzuar sektoriale në **vlerën 15.4 miliardë lekë, ose 2% më shumë se një vit më parë**.
- Rritja e pagave në buxhetin vendor për të mbuluar efektin financiar shtesë për rritjen e kufirit minimal të nivelit të pagave për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe efektin e rritjes së nivelit të pagës minimale, me nje fond shtesë prej **4.5 miliardë lekë**.
- Financimi i grantit të performancës në shumën **200 milion lekë** me qëllim nxitjen e bashkive për të përmirësuar performancën e tyre në qeverisje, menaxhimin më të mirë të financave publike vendore dhe rritjen e transparencës.
- Financimi i shpenzimeve operative për funksionet e transferuara, me një fond shtesë prej **200 milion lekë, ose rreth 1.4 % më shumë se një vit më parë, nga të cilat 100 milionë lekë për arsimin**

parashkollor (kopshtet) dhe 100 milionë lekë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi (përfitojnë 17 bashki me një shtesë prej 83 punonjësish).

- Të ardhurat e bashkive nga taksat e ndara, do të jenë **1.8 miliardë lekë** për vitin 2027, duke përfshirë shpërndarjen e tatimit mbi të ardhurat personale dhe taksën e rentës minerare.
- Reforma e taksës mbi pasurinë vijon të reflektohet në rritjen e të ardhurave të pushtetit vendor. Në vitin 2027, të ardhurat nga kjo taksë parashikohen në **10.6 miliardë lekë**, ose rreth **600 milionë lekë më shumë** krahasuar me vitin 2026, duke kontribuar në forcimin e qendrueshmërisë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore.
- Mbështetja me financim të huaj për njësitë e vetëqeverisjes vendore parashikohet në shumën **1.5 miliardë lekë** për vitin 2027, me qëllim financimin e projekteve të investimeve që zbatohen sipas skemës së plotë të thesarit. Ky financim do të kontribuojë në përmirësimin e infrastrukturës vendore, rritjen e cilësisë së shërbimeve publike dhe avancimin e prioriteteve të zhvillimit vendor.

❖ Transferta e pakushtëzuar 2027 dhe formula e shpërndarjes së saj

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me legjislacionin për financat e vetëqeverisjes vendore, përfitojnë të ardhura nga transfertat e Buxhetit të Shtetit, ku transferta e pakushtëzuar përbën një nga burimet kryesore të financimit, duke mbështetur ushtrimin e funksioneve vendore dhe ekualizimin fiskal ndërmjet bashkive.

Ndarja e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2027 bazohet në një formulë objektive dhe transparente, e cila synon të garantojë financimin e funksioneve të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ofrimin e shërbimeve publike në përputhje me kompetencat e tyre ligjore. Nëpërmjet këtij mekanizmi sigurohet mbulimi i diferencës ndërmjet nevojave për shpenzime të bashkive dhe kapacitetit të tyre për të gjeneruar të ardhura nga burimet e veta.

Për vitin 2027, transferta e pakushtëzuar përbëhet nga dy komponentë kryesorë: a) pjesa e përgjithshme dhe b) pjesa sektoriale. Formula e shpërndarjes mbështet një sistem më të drejtë të ekualizimit fiskal, duke siguruar mbështetje më të madhe për bashkitë me kapacitete më të kufizuara financiare dhe duke kontribuar në reduktimin e pabarazive territoriale. Ndarja e transfertës së pakushtëzuar realizohet mbi bazën e formulës dhe nuk përfshin fondet specifike për konviktet, shërbimet sociale apo fondet për rrugët rurale, të cilat trajtohen nëpërmjet mekanizmave të veçantë të financimit.


Formula identifikon nevojat për shpenzime të bashkive duke u mbështetur në tregues objektivë, si: popullsia rezidente; dendësia e popullsisë, e cila reflekton diferencat në kostot e ofrimit të shërbimeve dhe ushtrimit të funksioneve ndërmjet bashkive; numri faktik i nxënësve në arsimin parauniversitar.

Përveç ekualizimit të nevojave për shpenzime, formula përfshin edhe komponentin e ekualizimit të kapacitetit fiskal, me qëllim ngushtimin e diferencave ndërmjet bashkive për sa i përket aftësisë së tyre për të gjeneruar të ardhura. Ky mekanizëm bazohet në të ardhurat faktike të përfituara nga taksat e ndara ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore, të administruara nga administrata tatimore qendrore dhe të transferuara në buxhetet vendore. Për qëllime të ekualizimit fiskal merren në konsideratë të ardhurat nga: a)tatimi mbi të ardhurat personale; b)taksa vjetore mbi mjetet e përdorura; dhe c) taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme. Formula e transfertës së pakushtëzuar garanton një shpërndarje më të drejtë dhe më të balancuar të burimeve financiare, duke mbështetur funksionimin efektiv

të njësive të vetëqeverisjes vendore, forcimin e autonomisë fiskale dhe realizimin e objektivave të Reformës së Re Administrativo-Territoriale.

Transferta e pakushtëzuar për vitin 2027 parashikohet në masën **29.3 miliardë lekë**, duke shënuar një rritje prej **1.4 miliardë lekësh, ose 5.2%**, krahasuar me vitin 2026. Nëse e krahasojmë me buxhetin fillestar të vitit 2026, transferta e pakushtëzuar në vitin 2027 rritet në shumën 1.5 miliardë lekë, ose 6% më e lartë. Në krahasim me vitin 2015, niveli i kësaj transferte është rritur me rreth **17 miliardë lekë**, ose më shumë se dyfishuar. Siç paraqitet edhe në grafikun e mëposhtëm, kjo ecuri dëshmon angazhimin e vazhdueshëm të Qeverisë për forcimin e decentralizimit fiskal dhe rritjen e kapaciteteve financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore. Rritja e konsiderueshme e transfertës së pakushtëzuar ka kontribuar në përmirësimin e autonomisë financiare vendore, rritjen e cilësisë së shërbimeve publike dhe rritjen e efektivitetit të qeverisjes vendore.

Figura 1: Transferta e pakushtëzuar 2015-2027 (në mln lekë)



Burimi: Ministria e Financave (2026);

Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale përbëjnë një burim të rëndësishëm për financimin e funksioneve të pushtetit vendor. Gjatë vitit 2027, pushteti vendor do të përfitojë në total **49.4 miliardë lekë** në formën e transfertave, nga të cilat **29.3 miliardë lekë** ose 60% është transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme e cila shpërndahet përmes formulës, **20.1 miliardë lekë** ose 40% është në formën e transfertës së pakushtëzuar sektoriale për financimin e funksioneve të transferuara në nivel vendor dhe për rritjen e pagave.

❖ Detyrimet e prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore

Detyrimet e prapambetura përbëjnë një nga risqet kryesore fiskale për njësitë e vetëqeverisjes vendore, pasi akumulimi i tyre mund të krijojë probleme likuiditeti, të kufizojë kapacitetin për financimin e shërbimeve publike dhe të cenojë qendrueshmërinë financiare të tyre. Për këtë arsye, Ministria e Financave i ka kushtuar vëmendje të veçantë monitorimit dhe reduktimit të detyrimeve të prapambetura, duke ndërmarrë masa të vazhdueshme për përmirësimin e disiplinës fiskale dhe forcimin e menaxhimit financiar në nivel vendor. Në kuadër të menaxhimit të financave publike vendore, Ministria e Financave, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, harton çdo vit raportin mbi gjendjen financiare të tyre, nëpërmjet të cilit vlerësohen treguesit kryesorë fiskalë, niveli i detyrimeve të prapambetura dhe rreziqet që lidhen me to. Bazuar në rezultatet e këtij vlerësimi, njësitë vendore hartojnë dhe zbatojnë plane veprimi për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, përmirësimin e performancës financiare dhe rikthimin e qendrueshmërisë

fiskale në rastet kur evidentohen vështirësi financiare. Ky proces do të vijojë edhe gjatë vitit 2027, me fokus në parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja të prapambetura, forcimin e monitorimit financiar dhe zbatimin e masave korrigjuese për njësitë që paraqesin tregues financiarë me risk.

Në kuadër të masave të ndërmarra për menaxhimin dhe reduktimin e detyrimeve të prapambetura, stoku i tyre është ulur ndjeshëm, nga **12.1 miliardë lekë** në fillim të vitit 2016 **në rreth 3.1 miliardë lekë** në fund të gjatëmujorit të parë vitit 2026, duke shënuar një reduktim prej mbi 70%.

Në fund të muajit qershor 2026, stoku i detyrimeve të prapambetura, i cili parashikohet të shlyhet në një periudhë afatmesme sipas planeve të shlyerjes të paraqitura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore në Ministrinë e Financave, është **rreth 3.1 miliardë lekë.** Vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura ka mbetur e pandryshuar krahasuar me stokun e detyrimit në fund të tremujorit të parë të vitit 2026. Sipas strukturës së detyrimeve, peshën më të madhe e zë kategoria "Investime" me 40.1% të totalit, e ndjekur nga kategoria "Të tjera" me 21.4%, "Shërbime" me 16.4% dhe "Vendime gjyqësore" me 10.7%. Sa i përket kështillave të qarqeve, stoku i detyrimeve përbëhet kryesisht nga vendimet gjyqësore, të cilat përfaqësojnë rreth 94% të totalit të detyrimeve të tyre.


Në muajin qershor 2026, Ministria e Financave publikoi raportin mbi gjendjen financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2025. Sipas këtij raporti, katër bashki dhe një këshill qarku u vlerësuan me probleme financiare, ndërsa një bashki dhe një këshill qarku u vlerësuan në status vështirësie financiare. Për këto njësi janë hartuar plane rehabilitimi financiar dhe shlyerjeje të detyrimeve, me synim rikthimin e qendrueshmërisë fiskale dhe përmirësimin e treguesve financiarë. Zbatimi i këtyre planeve do të vijojë edhe gjatë vitit 2027, në përputhje me masat e përcaktuara për daljen nga statusi i problemeve dhe vështirësive financiare.

Gjatë vitit 2026 janë kryer vlerësime dhe raportime periodike mbi ecurinë financiare dhe nivelin e detyrimeve të prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore. Bazuar në analizën e treguesve fiskalë, janë dhënë rekomandime për njësitë që kanë shfaqur tendencë të rritjes së stokut të detyrimeve ndaj të tretëve, me qëllim përmirësimin e disiplinës financiare dhe parandalimin e përkeqësimit të situatës fiskale. Ky proces monitorimi dhe vlerësimi do të vijojë edhe gjatë vitit 2027, në zbatim të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi, duke synuar identifikimin e hershëm të vështirësive financiare dhe forcimin e qendrueshmërisë fiskale të njësive të vetëqeverisjes vendore.

❖ Treguesit Fiskal e Buxhetor të Pushtetit Vendor

Buxheti vendor për vitin 2027 parashikohet të arrijë në **114.6 miliardë lekë**, duke shënuar një rritje prej rreth **2.2%** krahasuar me nivelin e pritshëm të vitit 2026 dhe duke zënë **3.9% të Prodhimit të Brendshëm Bruto**. Ky nivel financimi garanton mbështetjen e ushtrimit të funksioneve të transferuara dhe të funksioneve të tjera të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Nëpërmjet këtij buxheti do të sigurohet financimi i shërbimeve publike vendore, realizimi i investimeve prioritare dhe përmbushja e detyrimeve ligjore të bashkive, me synim përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe forcimin e zhvillimit vendor të qendrueshëm.

Figura 2: **Buxheti Vendor 2026-P/Buxhet 2027**



Burimi: Ministria e Financave (2026);

Buxheti vendor për vitin 2027 krahasuar me buxhetin vendor 2026**,** parashikohet me një rritje me **rreth 2.6 miliardë lekë.** Në këtë zë është përllogaritur transferta e pakushtëzuar e përgjithshme për njësitë e vetëqeverisjes vendore, financimi i funksioneve të reja, financimi i shtesës për të mbuluar një pjesë të efektit financiar të rritjes së pagave, financimi i grantit të performancës, si dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore.

Të ardhurat nga taksat vendore për vitin 2027 parashikohen të arrijnë në **58.6 miliardë lekë**, duke shënuar një rritje prej rreth **712 milionë lekësh, ose 1.2%,** krahasuar me planin e vitit 2026. Në krahasim me vitin 2015, të ardhurat e veta vendore parashikohen të jenë rreth **46.9 miliardë lekë më të larta**, duke reflektuar forcimin e vazhdueshëm të autonomisë fiskale dhe kapaciteteve financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore.


Gjithashtu, të ardhurat jotatimore për vitin 2027 parashikohen në masën **3.4 miliardë lekë**, me një rritje prej rreth **6% krahasuar me vitin paraardhës**. Ecuria pozitive e këtyre burimeve të financimit pasqyron përmirësimin e menaxhimit financiar vendor, forcimin e kapaciteteve për mbledhjen e të ardhurave, si dhe konsolidimin e mekanizmave të financimit të funksioneve të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Rritja e të ardhurave vendore është mbështetur nga përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit të financimit vendor, shpërndarja më e drejtë dhe transparente e burimeve financiare, si dhe zgjerimi i bazës së të ardhurave të njësive të vetëqeverisjes vendore. Ndërkohë, efektet e reformës së taksës mbi pasurinë vijojnë të kontribuojnë në rritjen e të ardhurave vendore dhe në forcimin e qendrueshmërisë fiskale të pushtetit vendor.

Referuar grafikut të mëposhtëm, evidentohet një rritje e qendrueshme e peshës së të ardhurave të pushtetit vendor gjatë periudhës 2015-2027. Në vitin 2027, të ardhurat vendore parashikohen të zënë rreth **2% të Prodhimit të Brendshëm Bruto, kundrejt 0.82% në vitin 2015**, duke shënuar **një rritje prej 1.18%.** Kjo ecuri pasqyron forcimin gradual të autonomisë fiskale vendore dhe zgjerimin e kapaciteteve për gjenerimin e të ardhurave nga burimet e veta. Po ashtu, pesha e të ardhurave të pushtetit vendor në raport me totalin e të ardhurave të buxhetit të shtetit paraqet një tendencë pozitive ndër vite. **Nga 3.09% në vitin 2015, ky tregues arrin në 6.46% në vitin 2027,** duke dëshmuar rritjen e rolit të pushtetit vendor në administrimin e financave publike dhe konsolidimin e procesit të decentralizimit fiskal.

Tendenca në rritje e të dy treguesve reflekton përmirësimin e kuadrit të financimit vendor, rritjen e transfertave ndërqeveritare, zgjerimin e bazës së të ardhurave vendore, si dhe efektet pozitive të reformave të ndërmarra për forcimin e qendrueshmërisë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Figura 3: Pesha specifike e të ardhurave të buxhetit vendor ndaj të ardhurave të buxhetit qendror dhe PBB-së




Burimi: Ministria e Financave (2026)

Grafiku nr.4 evidencon rritjen e vazhdueshme të shpenzimeve të buxhetit vendor gjatë periudhës 2015-2027, si në terma nominalë ashtu edhe në raport me treguesit kryesorë makroekonomikë. Shpenzimet e pushtetit vendor janë rritur nga rreth **30 miliardë lekë në vitin 2015** në rreth **114.6 miliardë lekë** në vitin 2027, duke reflektuar zgjerimin e përgjegjësive funksionale të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe forcimin e kapaciteteve të tyre financiare. Pesha e shpenzimeve të pushtetit vendor ndaj totalit të shpenzimeve buxhetore ka njohur një rritje të konsiderueshme gjatë kësaj periudhe. Nga **7.79% në vitin 2015**, ky tregues parashikohet të arrijë në **11.75% në vitin 2027**, duke dëshmuar rritjen e rolit të pushtetit vendor në administrimin e financave publike dhe avancimin e procesit të decentralizimit fiskal. Po ashtu, pesha e shpenzimeve vendore ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) paraqet një tendencë të qartë rritëse. Nga **2.38% e PBB-së** në vitin 2015, ky tregues parashikohet të arrijë në **3.9%** në vitin 2027, ose rreth **1.5% më i lartë se niveli i vitit 2015**. Kjo ecuri reflekton rritjen e burimeve financiare të disponueshme për pushtetin vendor dhe zgjerimin e investimeve dhe shërbimeve publike në nivel lokal.

Treguesit e paraqitur në grafik dëshmojnë se, pas reformës administrativo-territoriale, financat vendore kanë njohur një proces të qendrueshëm konsolidimi, i cili është shoqëruar me rritjen e kapaciteteve financiare të bashkive, zgjerimin e hapësirës fiskale vendore dhe përmirësimin e aftësisë për të financuar funksionet dhe investimet në shërbim të zhvillimit ekonomik e social të komuniteteve lokale.

Figura 4: Pesha specifike e shpenzimeve të buxhetit vendor ndaj shpenzimeve të buxhetit të shtetit dhe PBB-së




Burimi: *Ministria e Financave (2026);*

Grafiku nr. 5 paraqet tendencën rritëse të rolit të pushtetit vendor në financat publike gjatë periudhës 2015-2027. Të dhënat tregojnë se pesha e shpenzimeve të pushtetit vendor në ekonomi dhe në totalin e financave publike ka shënuar një rritje të vazhdueshme përgjatë kësaj periudhe, duke reflektuar progresin e reformës

së decentralizimit fiskal dhe zgjerimin e kompetencave të njësive të vetëqeverisjes vendore. Për vitin 2027, shpenzimet e pushtetit vendor parashikohet të arrijnë në **3.9% të Prodhimit të Brendshëm Bruto** dhe **11.75%** të totalit të shpenzimeve publike, duke konfirmuar forcimin gradual të rolit të qeverisjes vendore në ofrimin e shërbimeve publike dhe menaxhimin e burimeve financiare. Kjo ecuri dëshmon për rritjen e autonomisë financiare vendore, përmirësimin e kapaciteteve fiskale të bashkive dhe konsolidimin e mëtejshëm të procesit të decentralizimit në vend.

Figura 5: Tendenca e buxhetit vendor 2015-P/Buxhet 2027



Burimi: Ministria e Financave (2026);

❖ Objektivat kryesorë për buxhetin vendor të vitit 2027

Pushteti vendor ka konsoliduar ndjeshëm gjatë viteve të fundit treguesit financiarë të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke forcuar kapacitetet për ofrimin e shërbimeve publike dhe përmbushjen e funksioneve në interes të qytetarëve. Përmirësimet metodologjike, asistenca teknike dhe konsolidimi i kuadrit ligjor e rregullator kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e autonomisë financiare vendore, përmirësimin e performancës fiskale dhe rritjen e eficiencës në përdorimin e fondeve publike.

Buxheti Vendor 2027 hartohet në kushtet e zbatimit të reformës së re territoriale të miratuar në vitin 2026, e cila synon forcimin e qeverisjes vendore, rritjen e eficiencës administrative dhe krijimin e njësive të vetëqeverisjes vendore më të afta për të përmbushur përgjegjësitë e tyre zhvillimore. Në këtë kuadër, financat vendore do të luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e zbatimit të reformës, rritjen e kapaciteteve institucionale dhe financiare, si dhe në garantimin e ofrimit të shërbimeve publike cilësore dhe të qendrueshme për qytetarët.

Ministria e Financave do të vijojë gjatë vitit 2027 procesin e modernizimit të financave publike vendore, me fokus forcimin e autonomisë fiskale, rritjen e të ardhurave nga burimet e veta, zgjerimin e investimeve publike vendore, përmirësimin e mekanizmave të financimit ndërqeveritar dhe konsolidimin e skemave të financimit të bazuara në performancë. Paralelisht, prioritet do të mbetet ruajtja e qendrueshmërisë së transfertave ndërqeveritare, forcimi i disiplinës fiskale dhe parandalimi i krijimit të detyrimeve të prapambetura.

Një drejtim strategjik i rëndësishëm do të jetë avancimi i procesit të digjitalizimit të financave vendore përmes shtrirjes së sistemit AFMIS në nivel vendor. Implementimi i këtij sistemi do të mundësojë automatizimin dhe integrimin e proceseve të planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe raportimit buxhetor,

menaxhimit të investimeve publike, si dhe administrimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore. Kjo reformë pritet të rrisë transparencën, llogaridhënien dhe efektivitetin në përdorimin e fondeve publike, duke mbështetur një qeverisje vendore moderne dhe në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

Nëpërmjet këtyre masave, Buxheti Vendor 2027 synon të konsolidojë arritjet e deritanishme të decentralizimit fiskal, të mbështesë zbatimin e reformës territoriale të vitit 2026 dhe të forcojë më tej rolin e pushtetit vendor si një faktor kyç për zhvillimin ekonomik, social dhe territorial të vendit.

Në vijim të këtyre prioriteteve, objektivat kryesore të Buxhetit Vendor 2027 paraqiten si më poshtë:

- **Rishikimi i formulës së transfertës së pakushtëzuar**

- Përfshirja në një kuadër më të integruar e transfertave nga Buxheti i Shtetit për pushtetin vendor, duke përfshirë edhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale. Kjo do të mundësojë një qasje më të plotë dhe koherente ndaj financimit të funksioneve vendore.
- Forcimi i mekanizmit të ekualizimit fiskal, duke marrë në konsideratë jo vetëm diferencat në nevojat për shpenzime, por edhe diferencat në kapacitetin potencial fiskal të bashkive. Në këtë mënyrë synohet një shpërndarje më e drejtë e burimeve dhe mbështetje më e madhe për njësitë me kapacitete fiskale më të kufizuara.

- **Modernizimi i skemës së financimit të qeverisjes vendore**

- Forcimi i financimit të bazuar në performancë për njësitë e vetëqeverisjes vendore, përmes rishikimit të mekanizmave të shpërndarjes së fondeve publike, me qëllim rritjen e eficiencës në përdorimin e burimeve financiare, përmirësimin e menaxhimit financiar, forcimin e llogaridhënies dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara për qytetarët.

- **Zgjerimi i sistemit AFMIS në nivel vendor**

- Implementimi gradual i sistemit AFMIS në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, me synim digjitalizimin dhe integrimin e plotë të proceseve të menaxhimit financiar publik. Ky proces do të mundësojë automatizimin e planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe raportimit buxhetor, duke rritur eficiencën, saktësinë dhe transparencën në administrimin e fondeve publike.
- Përmes zgjerimit të sistemit AFMIS, synohet forcimi i lidhjes ndërmjet planifikimit strategjik, Programit Buxhetor Afatmesëm, investimeve publike, strategjive sektoriale dhe administrimit të të ardhurave vendore, duke krijuar një platformë të integruar për menaxhimin e financave vendore. Gjithashtu, sistemi do të mbështesë përmirësimin e kontrollit financiar, rritjen e cilësisë së të dhënave, monitorimin në kohë reale të treguesve financiarë dhe përforcimin e llogaridhënies së njësive të vetëqeverisjes vendore.

- **Forcimi i buxhetimit të orientuar drejt performancës dhe produkteve**

- Konsolidimi i mëtejshëm i modelit të buxhetimit të orientuar drejt performancës në njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke forcuar lidhjen ndërmjet burimeve financiare, produkteve të ofruara dhe rezultateve të arritura. Ky objektiv synon përmirësimin e planifikimit dhe menaxhimit të shpenzimeve publike, rritjen e eficiencës dhe efektivitetit në përdorimin e fondeve buxhetore, si dhe orientimin e financimit drejt prioriteteve dhe nevojave konkrete të qytetarëve.

- Nëpërmjet zhvillimit të treguesve të matshëm të performancës, monitorimit sistematik të rezultateve dhe forcimit të mekanizmave të raportimit, synohet rritja e transparencës, llogaridhënies dhe cilësisë së shërbimeve publike vendore. Në kuadër të Reformës së Re Administrativo-Territoriale, ky proces do të kontribuojë në krijimin e një sistemi më efikas të menaxhimit financiar, duke mundësuar vlerësimin e ndikimit të politikave publike dhe përdorimin më të mirë të burimeve në funksion të zhvillimit vendor.

- **Forcimi i autonomisë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore**

- Forcimi i kapaciteteve administrative dhe teknologjike për administrimin e të ardhurave vendore, me fokus taksat dhe tarifat vendore
- Rritja e peshës së të ardhurave të veta vendore në financimin e funksioneve vendore.
- Përmirësimi i administrimit fiskal vendor dhe zgjerimi i bazës së taksave e tarifave vendore.
- Reduktimi gradual i varësisë së bashkive nga transfertat e buxhetit të shtetit.
- Vazhdimi i reformës së taksës mbi pasurinë, me qëllim rritjen e qendrueshme të të ardhurave të veta dhe uljen graduale të varësisë nga transfertat ndërqeveritare.

- **Ruajtja e qendrueshmërisë fiskale dhe forcimi i disiplinës financiare**

- Ruajtja e qendrueshmërisë fiskale dhe forcimi i disiplinës financiare, nëpërmjet përmirësimit të monitorimit financiar, respektimit të rregullave fiskale, parandalimit të krijimit të detyrimeve të prapambetura dhe forcimit të transparencës e llogaridhënies, me synim garantimin e stabilitetit afatgjatë të financave vendore.

- **Zvogëlimi i pabarazive territoriale dhe financiare ndërmjet bashkive**

- Mbështetja e bashkive me kapacitete të kufizuara fiskale përmes mekanizmave të përmirësuar të ekualizimit fiskal.
- Sigurimi i një shpërndarjeje më të balancuar të burimeve financiare dhe investimeve publike në të gjithë territorin.

- **Rritja e kapaciteteve institucionale të qeverisjes vendore**

- Rritja e kapaciteteve institucionale të qeverisjes vendore, nëpërmjet programeve të vazhdueshme të trajnimit dhe asistencës teknike për bashkitë dhe qarqet në fushën e planifikimit buxhetor, menaxhimit financiar, raportimit, monitorimit të performancës dhe kontrollit të brendshëm financiar, me synim forcimin e eficiencës, transparencës dhe qendrueshmërisë së administrimit vendor.

- **Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare**

- Thellimi i praktikave të transparencës dhe llogaridhënies përmes zgjerimit të buxhetimit me pjesëmarrje, publikimit të "Buxhetit të Qytetarit" dhe përfshirjes më të madhe të komunitetit në proceset e planifikimit dhe monitorimit të buxheteve vendore.

- **Mbështetja e zhvillimit ekonomik lokal dhe reduktimi i pabarazive territoriale**

- Përshtatja e mekanizmave të financimit me strukturën e re territoriale dhe zhvillimet demografike, me synim forcimin e kohezionit territorial, uljen e pabarazive ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe mbështetjen e zhvillimit të qendrueshëm ekonomik lokal.

  - **Përafrimi me standardet e Bashkimit Evropian**

- Përafrimi i sistemit të financave vendore me standardet e Bashkimit Evropian, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve financiare dhe administrative të bashkive, rritjes së transparencës dhe përmirësimit të gatishmërisë për përthithjen e fondeve të BE-së, në funksion të zbatimit të Reformës së Re Administrativo-Territoriale.

Buxheti Vendor 2027 do të mbështesë zbatimin e **Reformës së Re Administrativo-Territoriale**, duke synuar forcimin e autonomisë fiskale të njësive të vetëqeverisjes vendore, reduktimin e pabarazive territoriale, rritjen e investimeve publike vendore dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve. Nëpërmjet konsolidimit financiar dhe institucional të njësive të vetëqeverisjes vendore, përmirësimit të mekanizmave të financimit dhe forcimit të kapaciteteve administrative, synohet krijimi i njësive vendore më të qendrueshme financiarisht, më efikase dhe më të afta për të mbështetur zhvillimin ekonomik e social të territorit.

6. POLITIKAT E TAKSAVE PËR VITIN 2027

6.1 PAKETA TATIMORE pËR VITIN 2027

Ministria e Financave, paralelisht me Buxhetin 2027, ka hartuar Paketën tatimore 2027 me ndryshimet në ligjet tatimore, të cilat mbështesin realizimin e këtij buxheti, si në drejtim të rritjes së të ardhurave, ashtu edhe në drejtim të përmirësimit të procedurave me qëllim reduktimin e shmangieve dhe evazionit.

Këto propozime adresojnë disa objektiva kryesorë:

1. **Zbatimin e rekomandimeve të FMN-së**, të dhëna ndër vite në kuadër të rishikimit dhe përmirësimit të politikës tatimore.
2. **Përafrimin e politikës tatimore me acquis dhe objektivat e Bashkimit Evropian**, veçanërisht në fushën e TVSH-së.
3. **Marrjen në konsideratë të rekomandimeve të Bankës Botërore dhe FMN-së** për formalizimin e ekonomisë, nëpërmjet rishikimit të politikave dhe instrumenteve tatimore.
4. **Rishpërndarjen e barrës tatimore**, veçanërisht në fushën e TVSH-së, me synim përmirësimin e efektivitetit dhe të neutralitetit të sistemit tatimor.

Efekti i përgjithshëm i vlerësuar i masave të propozuara në Paketën Fiskale 2027 është **4.4 miliardë lekë të ardhura shtesë** nga tatimet dhe doganat.

Paketa tatimore për vitin 2027 parashikon një sërë ndryshimesh ligjore, por më poshtë është një përmbledhje e projektligjeve me ndikim në të ardhura.

1. Projektligji "*Për disa shtesa dhe një ndryshim në ligjin nr. 29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat*", të ndryshuar"

Projektligji parashikon;

- saktësimin, zgjerimin dhe unifikimin e trajtimit tatimor favorizues për individët dhe të vetëpunësuarit e vetëm që kanë statusin e personit të verbër, invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, personit me surdomutizëm dhe invalidit të punës, duke siguruar vijimësinë e lehtësive për kategoritë që i kanë gëzuar ato më parë dhe një trajtim të njëjtë tatimor për kategoritë e përfshira në këtë dispozitë;
- unifikimin në 15% të normës tatimore për të ardhurat nga dividendi me të ardhurat e tjera pasive nga investimi dhe tatimin e mbajtur në burim duke e rritur normën e tatimit mbi dividendin nga 8% në 15% me synim reduktimin e diferencës ndërmjet tatimit të të ardhurave nga kapitali dhe atyre nga punësimi, parandalimin e arbitrazhit tatimor dhe nxitjen e riinvestimit të fitimeve.
- efekti pozitiv në të ardhura vlerësohet në shumën rreth 3 miliardë lekë, duke marrë ë konsideratë edhe faktin se rritja e normës së tatimit mbi divientin do të ndikojë në vendimarrjet e kompanive në estimimin e fitimit.
- Rishikimin e formulës dhe shkallës progresive të tatimit mbi të ardhurat personale (TAP) nga punësimi (neni 24, pika 1), ku parashikohet lehtësimi i barrës tatimore për shtresën e mesme dhe profesionistët e kualifikuar përmes rritjes së pragut të fashës së parë tatimore (që tatohet me normën 13%) nga paga bruto 200 000 lekë/muaj në 300 000 lekë/muaj (bazë tatimore vjetore nga 2 040 000 lekë në vit në 3 240 000 lekë në vit pasi është aplikuar zbritja tatimore në bazë të nenit 22 në një shumë prej 360 000 lekë në vit), zbatimi i normës tatimore prej 23% për fashën e pagës bruto nga 300 001 lekë/muaj deri në 700 000 lekë/muaj (bazë tatimore vjetore nga 3 240 001 lekë deri në 8 040 000 lekë), si dhe vendosja e një shkalle të tretë progresive me normë marxhinale 30% për individët me të ardhura më të larta, konkretisht për pagat bruto mbi 700 000 lekë/muaj (bazë tatimore vjetore mbi 8 040 000 lekë në vit). Ky ndryshim synon një shpërndarje më të drejtë dhe të balancuar të barrës tatimore mbi të ardhurat nga punësimi, duke lehtësuar tatimin për shtresën e mesme dhe profesionistët e kualifikuar, si dhe duke forcuar progresivitetin e sistemit në përputhje me aftësinë paguese të individëve.
- Rritja e pragut të fashës 13% nga 200 000 në 300 000 lekë/muaj përkthehet në një lehtësim tatimor të drejtpërdrejtë për 25 704 punonjës në vlerën rreth -1,98 miliardë lekë në vit, kosto e cila zbutet më tej nga të ardhurat shtesë prej 0,76 miliardë lekë në vit që gjeneron aplikimi i normës marxhinale prej 30% për pagat bruto mbi 700 000 lekë/muaj për 1,293 punonjës, pra me një efekt neto prej -**1.22 miliardë lekë në vit.**
- Eliminimin e dorëzimit të dyfishtë të pasqyrave financiare pranë administratës tatimore, duke filluar me pasqyrat financiare që i përkasin vitit tatimor 2027, për tatimpaguesit që kanë detyrimin për depozitimin e tyre pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. QKB ia përcjell administratës tatimore elektronikisht.

2. Projektligji "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar"

Projektligji synon forcimin e kuadrit procedural dhe të masave administrative në funksion të përmbushjes së detyrimeve tatimore, rritjes së efektivitetit të administrimit tatimor dhe kufizimit të mundësive për mospërmbushje të detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin tatimor. Në mënyrë të veçantë, ndërhyrjet e propozuara janë:

1. Përfshirja e parapagimeve në kompetencat e administratës tatimore për mbledhjen me forcë.
2. Përmirësimi i procedurës së kontrollit në kuadër të çregjistrimit të subjekteve/tatimpaguesve.
3. Forcimi i kuadrit ligjor për kufizimin e pagesave dhe arkëtimeve me para në dorë.
4. Përcaktimi i masës administrative për mosparaqitjen në afat të dokumentacionit të transferimit të çmimit.
5. Forcimi i masave ndaj refuzimit të përsëritur për dhënien e informacionit tatimor.

3. Projektligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 92/2014, 'Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar"

Ky projektligj ka si qëllim ridimensionimin e politikës tatimore në fushën e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH), nëpërmjet aplikimit të një shkallë të reduktuar prej 6% për produktet ushqimore, ndryshimit në 10% të shkallës së reduktuar që aplikohet për furnizimin e shërbimeve në sektorin e turizmit si dhe përcaktimit të shkallës standarde në masën 21%. Gjithashtu, pjesë e këtij projektligji është edhe zgjatja e afatit të zbatimit të regjimit të veçantë për Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike.

Ndryshimet kryesore janë:

1) Diferencimi i trajtimit të produkteve ushqimore, nga trajtimi i konsumit të përgjithshëm, nëpërmjet aplikimit të një shkalle të reduktuar të TVSH-së prej 6% dhe konkretisht aplikimi i normës nga 20% në normë të reduktuar 6% për kategorinë e produkteve ushqimore, si mish(vici, derri, qingji e pule) peshk (te gjitha llojet), qumesht, kos, veze, oriz , miell gruri, miell misri, vaj ulliri, vaj luledielli, vaj misri, sheqer dhe makarona dhe fruta perime dhe ushqime bazë për foshnja. Efekti në total në tvsh (e brendshme dhe në import) është rreth minus 12,8 miliardë lek

2) Rritja e normës së tvsh nga 20% në 21%. Vlerësohet se rritja me 1% e normës standarte të TVSH të sjell një ndikim pozitiv në të ardhurat nga tvsh me rreth 10,6 miliardë lekë.

3) Rritja e normës së reduktuar të TVSH-së për akomodimin dhe hotelerinë nga 6% në 10%. Vlerësohet se zbatimi i kësaj mase pritet të gjenerojë të ardhura shtesë në buxhet me rreth 0.56 miliardë lekë në vit.
4) Sigurimi i vazhdimësisë së zbatimit të regjimit të veçantë për Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike deri në momentin e anëtarësimit.

4.Projektvendimi "Për disa ndryshime në vendimin nr. 953, datë 29.12.2014, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, 'Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar", ka si qëllim uljen e kufirit minimal të regjistrimit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), nga 10 (dhjetë) milionë lekë, në vlerën 5 (pesë) milionë lekë.
Nga zbatimi i kësaj politike, rreth 17,516 subjekte me qarkullim nga 5-10 milionë lekë do të futen në skemën e tvsh-së dhe efekti në buxhet vlerësohet 4,5 miliardë lek

5. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012 'Për akcizat në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar"

Qëllimi kryesor i këtij projektligji është

1) Propozimi i kalendarit të ri **të akcizave për duhanin dhe nënproduktet e tij, për periudhën 2027-2033, du**ke qenë se kalendari aktual përfundon në dhjetor 2026, duke synuar përafrim të mëtejshëm me Direktivën e Këshillit 2011/64/EU, datë 21 qershor 2011, "Mbi strukturën dhe normat e akcizës që zbatohen për duhanin e përpunuar (kodifikim)", e cila ndër të tjera përcakton edhe nivelet minimale të akcizës për të gjitha kategoritë e duhanit të përpunuar.

Nëpërmjet këtij kalendari synohet konsolidimi i të ardhurave nga akciza, ruajtja e qëndrueshmërisë fiskale dhe krijimi i kushteve për arritjen graduale të niveleve minimale të taksimit të parashikuara nga legjislacioni i Bashkimit Evropian, duke mundësuar një tranzicion të qëndrueshëm dhe të përshtatur me kushtet ekonomike e fiskale të vendit.

2) **Shtohen produkte të reja në kategorinë** e duhanit dhe nënprodukteve të tij, të cilat rezultojnë të pranishme në treg dhe është evidentuar nevoja për rregullim.
3) Propozohet që për taksimin e dieselit të misheluar me një përqindje bio (biodiesel), që i përket kategorisë E460, duke përcaktuar që **njësia matëse e taksimit të jetë litër dhe jo kilogram.**

Miratimi dhe zbatimi i projektligjit për akcizat parashikohet të sjellë efekte pozitive në të ardhurat buxhetore, si rezultat i rritjes graduale të normave të akcizës e akcizës mbi cigaret dhe produktet e tjera të duhanit, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të të ardhurave, shoqëruar me efekte plotësuese pozitive edhe nga TVSH-ja.
Konkretisht, nga kalendari për produktet e duhanit parashikohet një efekt në të ardhura rreth 2.24 miliardë lekë nga akciza dhe rreth 448 milionë nga TVSH-ja, në total rreth 2.69 miliardë lekë. Nga ndryshimi i taksimit për produktin e akcizës biodiesel me vajra nafte, të kategorisë E460, parashikohet një efekt në të ardhura rreth 1.19 miliardë lekë nga akciza, gjithashtu 239.28 milionë nga TVSH-ja, në total rreth 1.43 miliardë lekë.
Efekti total në buxhetin e shtetit për akcizat dhe tvsh për vitin 2027, parashikohet rreth **4.12 miliardë lekë.**

6.Ndryshimi i ligjit për taksat kombëtare

Kjo politikë ka për qëllim uljen e çmimit të karburanteve në tregun vendas, nëpërmjet rishikimit të politikës fiskale dhe reduktimit të barrës tatimore që ndikon drejtpërdrejt në çmimin e karburanteve. Në këtë kuadër, masa **parashikon heqjen e taksës së qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin, prej 27 lekë/ litri, me synim reduktimin e barrës tatimore mbi këto produkte, si dhe rishikimin e taksave që zbatohen mbi automjetet, në kuadër të ristrukturimit të skemës tatimore në sektorin e transportit**.

Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje synohet krijimi i kushteve për uljen e çmimit të karburanteve për konsumatorët, lehtësimi i kostove të transportit për qytetarët dhe subjektet ekonomike, si dhe zbutja e ndikimit të këtyre kostove në çmimet e mallrave dhe shërbimeve. Gjithashtu, rishikimi i taksave të automjeteve synon të mundësojë një rishpërndarje të barrës tatimore, duke marrë në konsideratë nevojën për ruajtjen e qëndrueshmërisë së të ardhurave të buxhetit të shtetit.
Konkretisht, ndryshimet synojnë:

1) Heqja e taksës së qarkullimit në **masën 27 lekë për litër për** benzinën dhe gazoilin, e cila, duke marrë në konsideratë edhe efektin e TVSH-së në masën 20%, sjell një reduktim të barrës **tatimore mbi karburantet prej 32,4 lekë për litër,** nga të cilat **27 lekë përfaqësojnë taksën e qarkullimit dhe 5,4 lekë efektin** e TVSH-së mbi këtë taksë.

Tabela: Detyrimet fiskale mbi benzinën dhe gazoilin, viti 2026

Lloji i detyrimit	Benzinë	Gazoil
Akciza	39,376230 lekë/litër	39,376230 lekë/litër
Taksa e qarkullimit	27 lekë/litër	27 lekë/litër
Taksa e karbonit	1,5 lekë/litër	3 lekë/litër
TVSH	20%	20%

**Shënim: TVSH-ja në masën 20% zbatohet mbi bazën e tatueshme, e cila përfshin edhe detyrimet përkatëse tatimore.*

2) Rishikimi i taksimit të automjeteve luksoze;
3) Rishikimi i elementëve të formulës së taksë vjetore të mjeteve të përdorura të transportit;
4) Vendosja e një takse fikse për mjetet elektrike në varësi të llojit;
5) Vendosja e taksës për rimorkiot dhe gjysëm rimorkio, në varësi të peshës së tyre;

Ky projektligj **parashikon të** sjellë efekte negativ në buxhetin e shtetit, **me rreth minus 5 miliardë lek, të ardhura këto të cilat do të kompensohen nga politikat në fushën** e **tatimeve direkte dhe të tvsh-së.**

Përpos masave të Paketës Fiskale, jana parashikuar masa buxhetore me efekte në të ardhurat tatimore dhe konketisht;

8.Politika buxhetore rritjes së pagave për efektivët e Policisë së Shtetit.
Politika e rritjes së pagave për efektivët e Policisë së Shtetit pritet të ketë ndikim pozitiv në të ardhurat buxhetore, duke gjeneruar rreth 0.5 miliardë lekë shtesë nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale (TAP), si dhe rreth 0.9 miliardë lekë nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

9. Politika e pagesës së konributeve të kujdestarëve të shtresave në nevojë, me efekt në kontribute në shumën 1.4 miliardë lekë.

6.2 STRATEGJIA AFATMESME E TË ARDHURAVE (SAA) DHE PLANI I VEPRIMIT, 2024-2027

Për vitin 2027, në SAA janë parashikuar rreth 17.8 miliardë lekë ose 0.63% e PBB-së, ku pjesa më e madhe e të ardhurave shtesë vjen nga marrja e masave për mirëadministrimin tatimor, prej rreth 10.7 miliardë lekë. Sikurse shpjeguar më lart, pjesë e parashikimeve të buxhetit 2027, sipas zërave të taksave, janë edhe të ardhurat e parashikuara në SAA.

Tabela 11 ***Në % të PBB-së[2]***

Shtyllat e Strategjisë	**2027**
Shtylla 1: Rishikimi i politikës tatimore	0.23%
Shtylla 2: Mirëadministrimi tatimor	0.38%

[2]Vlerësimet e të ardhurave tatimore (si % e PBB-së) bazohen në vlerat nominale të PBB-së para rishikimit të të dhënave të Shtatorit 2024

Shtylla 3: Mirëadministrimi doganor	0.02%
Totali	**0.63%**
Në milionë lekë	
Shtyllat e Strategjisë	**2027**
Shtylla 1: Rishikimi i politikës tatimore	6,473
Shtylla 2: Mirëadministrimi tatimor	10,665
Shtylla 3: Mirëadministrimi doganor	664
Totali	**17,802**

Për vitin 2027, të ardhurat shtesë të parashikuara në SAA mbështeten në masat e programuara në të tre shtyllat e Strategjisë.

1) Në Shtyllën 1, efektet në të ardhura lidhen kryesisht me rritjen e akcizës së cigareve sipas kalendarit të parashikuar, vijimin e kalendarit të taksës së karbonit për qymyrin dhe rritjen e të ardhurave nga tatimi mbi ndërtesat. Në këtë parashikim, nuk janë të përfshirë efektet e politikës së rritjes së të e të ardhurave nga tatimi mbi ndërtesat nga zbatimi i ligjit për asye se ky projektligj është ende në proces konsultimi.

2) Në Shtyllën 2, të ardhurat shtesë burojnë nga përmirësimi i pajtueshmërisë tatimore, zvogëlimi i hendekut të TVSH-së, trajtimi i sektorëve me risk, zgjerimi i bazës së tatueshme dhe forcimi i masave kundër shmangies dhe mashtrimit tatimor.

3) Ndërsa, në Shtyllën 3, rritja e të ardhurave mbështetet në përmirësimin e menaxhimit dhe profilizimit të riskut doganor, forcimin e luftës kundër informalitetit dhe kontrabandës, si dhe zgjerimin e shkëmbimit të informacionit me partnerët vendas dhe ndërkombëtarë.

6.3 PËRJASHTIMET NGA TAKSAT ("TAX EXPENDITURES")

Shpenzimet tatimore, ose të njohura ndryshe si të ardhura të munguara, përfaqësojnë ato "të ardhura" që nuk arkëtohen në buxhetin e shtetit si shkak i zbatimit të përjashtimeve dhe lehtësirave të tjera tatimore të ndryshme nga trajtimet standarde tatimore, të përcaktuara në ligjet fiskale.

Ministria e Financës ka hartuar Raportin e Shpenzimeve Tatimore për vitin 2023 dhe 2024 duke bërë një vlerësim të shpenzimeve tatimore që rrjedhin nga:

- "Tatimi mbi Vlerën e Shtuar", i rregulluar me ligjin nr. 92/2014 "Për Tatimin mbi vlerën e shtuar" në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.
- "Tatim Fitimi" dhe "Tatimi mbi të Ardhurat Personale" të rregulluar me ligjin Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar.

- Tatimi i Thjeshtuar i Fitimit që trajtohet sipas ligjit nr. 9632, datë 30.08.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar.
- Akciza, shkallët e reduktuara dhe lehtësirat fiskale të së cilës janë përcaktuar në ligjin nr. 61/2012 "Për Akcizën në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Hartimi i raportit, analiza e përjashtimeve ligjore dhe përcaktimi i benchmark-ut (përjashtime që janë normë në të gjithë vendet) u asistua edhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

Modeli i Tvsh-së i përdorur për vlerësimin e shpenzimeve tatimore ka pësuar përmirësime të dukshme krahasuar me vitet e mëparshme dhe është përshtatur me zhvillimet e fundit ekonomike dhe ligjore, për të rritur saktësinë e vlerësimit të të ardhurave të munguara nga Tvsh-ja. Modeli përdor një qasje "Top -Doun" duke u bazuar në Tabelat e Burim - Përdorimit të publikuar nga INSTAT për vitin 2023, ndërkohë për vitin 2024, duke qenë se këto tabela janë publikuar ende janë përdorur tabelat e vitit 2023, të cilat janë shkallëzuar përmes aplikimit të rritjes nominale të PBB-së. Modeli i Tvsh-së është zgjeruar më tej duke përfshirë 65 kategori produktesh në 65 sektorë (nga 35 kategori të ndara në 35 sektorë në vitin 2022). Misioni i FMN-së rishikoi të gjitha ndarjet e produkteve në model, bazuar në të dhëna të reja të marra nga DPT për t'iu përshtatur trajtimeve të ndryshme të ligjit të TVSH-së për produktet që i përkasin një kategorie të vetme në Tabelat e Burim – Përdorimit. Është rishikuar gjithashtu edhe metodologjia për shpërndarjen e furnitorëve të vegjël sipas nivelit vjetor të qarkullimit në sektorin bujqësor, duke përdorur të dhënat e fiskalizimit, janë rishikuar përcaktimet e mëparshme për ato që do të konsiderohen shpenzime tatimore dhe ato që do trajtohen si pjesë e standardit (benchmark), si dhe është ripërcaktuar pragu i regjistrimit të tvsh-së që konsiderohet si shpenzim tatimor në këtë raport.

Akciza

Shpenzimet tatimore prej akcizës, janë llogaritur duke bërë diferencat në normat më të larta për çdo kategori mallrash të akcizueshme me normat reale që janë akcizuar, pasi për disa kategori mallrash nën regjimin e akcizës, ekzistojnë shkallë të ndryshme të taksimit dhe trajtime preferenciale (për verën, duhanin etj).
Shpenzimet tatimore = (Norma më e lartë e përcaktuar me ligj – Normën efektive) * Sasinë e hedhur në konsum

Tatimi mbi Fitimin, Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin, Tatimi mbi të Ardhurat Personale dhe Tatimi mbi të Ardhurat e Korporatës

Tatimi mbi Fitimin dhe Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin trajtohen në mënyrë të njëjtë sa i takon llogaritjes së shpenzimit tatimor, si dhe normës standarde prej 15%. Duke ruajtur linjën e konceptit të të ardhurave të munguara, shpenzimi tatimor që buron nga TF dhe TTHF do të llogaritet si një diferencë mes të ardhurave tatimore që do të mblidheshin teorikisht nëse do zbatonim normat standarde, me të ardhurat tatimore të mbledhura realisht. Në të njëjtën linjë trajtohet edhe CIT dhe TAP.

- Shpenzimi tatimor TF = TF teorik – TF i paguar
  TF teorik = fitimin e tatueshëm x norma standarde e përcaktuar për TF
  TF i paguar = Të ardhurat tatimore nga Tatimi mbi Fitimin që kanë paguar tatimpaguesit
- Shpenzimi tatimor TTHF = TTHF teorik – TTHF i paguar
  TTHF teorik = fitimin e tatueshëm x norma standarde e përcaktuar për TF

TTHF i paguar = Të ardhurat tatimore nga Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin që janë paguar nga tatimpaguesit

- Shpenzimi tatimor CIT = CIT teorik – CIT i paguar
  CIT teorik = fitimin e tatueshëm x norma standarde e përcaktuar për CIT
  CIT i paguar = Të ardhurat tatimore nga Tatimi mbi të Ardhurat e Korporatës që janë paguar nga tatimpaguesit
- Shpenzimi tatimor TAP = TAP teorik – TAP i paguar
  TAP teorik = e ardhura e tatueshme x normat standarde të përcaktuara për Tap
  TAP i paguar = Të ardhurat tatimore nga tatimi mbi të ardhurat personale që janë paguar nga tatimpaguesit

Rezultatet nga ky proces vlerësimi, në mënyrë të përmbledhur, pasqyrohen në tabelën më poshtë:

Tabela 12: Totali i Shpenzimeve tatimore për vitet 2023-2024, në vlerë dhe në % të PBB-së ***në milionë lekë***

Vlera e SHT Shpenzimeve tatimore	**2023**	**2024**
TVSH	38,958	42,833
Tatimi mbi fitimin	4,572	-
CI-Tatimi mbi të ardhurat e koorporatës	-	3,531
TAP-Tatimi mbi të ardhurat personale	1,283	16,887
TTHF-Tatimi i thjeshtur mbi fitimin	14,125	-
Akciza	1,052	989
Total	**59,990**	**64,240**
ndryshimi nga viti paraardhës	4,401	4,250
PBB	***2,364,276***	***2,517,820***
TVSH	1.65%	1.70%
Tatimi mbi fitimin	0.19%	0.00%
CI-Tatimi mbi të ardhurat e koorporatës	0.00%	0.14%
TAP-Tatimi mbi të ardhurat personale	0.05%	0.67%
TTHF-Tatimi i thjeshtur mbi fitimin	0.60%	0.00%
Akciza	0.04%	0.04%
Total	**2.54%**	**2.55%**

Burimi: Ministria e Financave (2026)

Bazuar në modelet e vlerësimit, vlera e shpenzimeve tatimore për vitin 2023 llogaritet rreth 60 miliardë lekë ose 2.54% e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB). Nga totali i shpenzimeve tatimore për këtë vit rezulton se rreth 65 % e tyre rrjedhin nga: përjashtimet tatimore, aplikimi i shkallëve të reduktuara dhe kufiri minimal i regjistrimit të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar. Shpenzimi tatimor i TVSH-së përbën rreth 1.65% të PBB-së. Përveç rolit të tij si tatimi me peshën më të madhe në të ardhurat tatimore, TVSH-ja gjeneron edhe nivelin më të lartë të shpenzimeve tatimore si rezultat i numrit të madh të përjashtimeve dhe normave të reduktuara të parashikuara në ligjin për TVSH-në, si edhe nga pragu relativisht i lartë i regjistrimit.
Shpenzimet tatimore që krijohen nga përjashtimet apo aplikimet e normave të reduktuara në tatimet e tjera, si tatimi mbi fitimin (rreth 0.2% e PBB-së), tatimi i thjeshtuar mbi fitimin(0.6 % e PBB-së), tatimi mbi të ardhurat personale(0.05% e PBB-së), dhe akciza (0.04% e PBB-së) kanë një rol më të vogël në totalin e SHT për vitin 2023.

Për vitin 2024, shpenzimet tatimore arrijnë vlerën 64.2 miliardë lekë, ose rreth 2.55% e PBB-së. Peshën më të madhe edhe për këtë vit e zenë shpenzimet tatimore nga Tvsh-ja, të cilat përbëjnë rreth 67 % të totalit ose rreth 1.7 % të PBB-së.

Tabela 13: Totali i shpenzimeve tatimore gjatë 2023-2024, sipas përqindjes së zërave tatimorë

SHT në % ndaj totalit	2023	2024
TVSH	65%	67%
Tatimi mbi fitimin	8%	0%
CI-Tatimi mbi të ardhurat e koorporatës	0%	5%
TAP-Tatimi mbi të ardhurat personale	2%	26%
TTHF-Tatimi i thjeshtur mbi fitimin	24%	0%
Akciza	2%	2%
Total	**100%**	**100%**

Burimi: Ministria e Financave (2026)

Raporti i Shpenzimeve Tatimore hartohet me periodicitet dyvjeçar, në përputhje me metodologjinë dhe procesin e mbledhjes së të dhënave të nevojshme për vlerësimin e të ardhurave të munguara nga përjashtimet dhe lehtësitë fiskale. Në këtë kuadër, raporti i radhës do të përfshijë vlerësimin e shpenzimeve tatimore për vitet 2025 dhe 2026 dhe do të hartohet gjatë vitit 2027, pasi të jenë siguruar të dhënat statistikore dhe administrative të nevojshme për kryerjen e analizës sipas metodologjisë së miratuar.

7. RREZIQET FISKALE DHE MASAT MBROJTËSE

Risku i normave të interesit

Gjatë viteve të fundit, deri në fund të vitit 2021, ekspozimi ndaj riskut të normave të interesit ka ardhur duke u zbutur, kryesisht për shkak të rikompozimit të portofolit të borxhit të brendshëm në drejtim të titujve afatgjatë me norma interesi fikse, si edhe bazuar në normat e interesit në nivele të ulëta në tregun e brendshëm dhe atë të huaj. Në periudhën nga viti 2021 deri në fund të vitit 2023, risku i normave të interesit ka qenë në nivele të konsiderueshme, duke marrë në konsideratë zhvillimet në tregjet e huaja dhe atë vendas. Normat e interesit në tregun e brendshëm pësuan rritje të ndjeshme në 2022 dhe vijuan edhe gjatë 2023. Banka e Shqipërisë ka rritur 5 herë normën bazë të interesit gjatë vitit 2022 duke arritur në nivelin prej 2.75%, krahasuar me 0.5% që ishte në fund të vitit 2021. Më pas, gjatë vitit 2023, BSH ka rritur 2 herë normën bazë të interesit, duke arritur në nivelin prej 3.25% në nëntor 2023. Pas rritjeve të njëpasnjëshme, në vitin 2024, BSH filloi të ulë normën bazë të interesit duke filluar me një ulje nga 3.25% në 3.0% e duke vijuar me ulje të mëtejshme. Aktualisht norma bazë e interesit qëndron në nivelin prej 2.5%.

Rritja e normave të interesit të tregut referencë përbën një ndikim të rëndësishëm në zërin e shpenzimeve për interesa. Ky ndikim është zbutur nga struktura ekzistuese e normave të interesit, ku më shumë se 98% e stokut të borxhit të brendshëm përbëhet nga instrumente me normë interesi fikse si dhe në portofolin e borxhit të jashtëm, mbi 60% të peshës e mban borxhi me normë interesi fikse. Në këtë aspekt, përveç masave për reduktimin e peshës së titujve afatshkurtër, do të vijojë të mbahet nën kontroll pesha e titujve me norma interesi të ndryshueshme, në linjë me hapësirat e tregut dhe preferencat e investitorëve.

Projeksionet në lidhje me shpenzimet e interesave në buxhetin e vitit 2027 vlerësohen të jenë realiste, bazuar në zhvillimet më të fundit të tregjeve. Megjithatë, duke filluar nga viti 2017 në zbatim të detyrimit ligjor të përcaktuar në Ligjin Organik të Buxhetit, në buxhetin e shtetit janë programuar kontigjenca të veçanta për të absorbuar rritjen e shërbimit të borxhit që mund të burojë nga rritja e normave të interesit përtej pritshmërive si dhe prej luhatjes në kursin e këmbimit të valutave të huaja. Në këtë drejtim, në buxhetin e vitit 2027 janë parashikuar 6.85 miliard Lekë kontigjenca, një nivel ky i mjaftueshëm për të përballuar rritje të normave të interesit në krahasim me normat e supozuara në llogaritjet e bëra nga Ministria e Financave.

Risqet në krahun e të ardhurave

Risqet në parashikimin e të ardhurave nga Tatimet dhe Doganat dhe kontributet:

- Devijimet në ulje nga projeksionet e nivelit të inflacionit të projektuar;
    - TVSH si tatim indirekt i cili ndikohet nga indeksi i rritjes së çmimeve, i cili është projektuar 3%. Nëse nuk realizohet, do të ndikojë në mosrealizimin e shtesës së të ardhurave nga ky faktor.
- Ndryshimet e paparashikuara në kurset e këmbimit të lekut me monedhat e tjera;
    - Ulja e kursit të këmbimit të monedhave Euro apo USD krahasuar me projeksionin, ndikon në uljen e vlerës së mallrave tek importet, për rrjedhojë edhe TVSH-në mbi këto mallra. Ky faktor pati ndikim negativ përgjatë vitit 2026 në të ardhurat doganore
- Sjellja e konsumatorëv nga masat Paketës Fiskale 2027 në ulje e tvsh së produketve të shportës.
- Elasticiteti i uljes së normës tatimore në uljen e çmimeve në treg dhe ndikimi në fuqinë blerëse.

- Ndikimi në sjelljen e tatimaguesve në vendimmarrjet për shpërndarjen e dividentit
- Ndikimi që do të ketë në rritjen e çmimeve, rritja e normës së tvsh nga 20% në 21%.
- Çmimet e mallrave në tregjet ndërkombëtare Luhatjet në çmimet ndërkombëtare të produkteve me ndikim në të ardhurat e buxhetit;
- Parashikimet lidhur me efekte e disa politikave si kompensimi nga skema e fermerit apo kompensimet në zbatim të ligjit për tatimin mbi të ardhurat janë bërë në bazë të vlerësimit të të dhënave për vitin 2025 ose 2026, të cilat mund të ndryshojnë përgjatë vitit 2027;
- Risqet fiskale në të ardhurat nga lojrat e fatit;
    - Nëse aktet nënligjore të parashikuara për tu bërë në vitin 2027 nuk realizohen.
- Mosmiratimi/ndryshimi i ndonjë elementi të paketës tatimore ose buxhetore mbi bazën e së cilës janë bërë parashikimet për vitin 2027.

Kontratat Koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore

Ministria e Financave vlerëson dhe miraton paraprakisht të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP) si edhe çdo ndryshim të tyre, nga pikëpamja e implikimeve individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale.

Shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontratat koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 përqind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor.

Në rast tejkalimi të këtij kufiri, Këshilli i Ministrave merr masa korrektuese në krahun e të ardhurave buxhetore, të nevojshme dhe të mjaftueshme për t'u rikthyer brenda kufirit të lejuar, gjatë dy viteve të ardhshme buxhetore.

Aktualisht, janë aktive 8 kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), përkatësisht sipas Tabelës 17 të mëposhtme:

Tabela 14: Koncesionet/PPP aktive me mbështetje financiare nga buxheti i shtetit

në mijë Lekë

Autoriteti Kontraktor	Nr.	Emërtimi i Kontratës PPP	Viti i fillimit	Viti i përfundimit	Programi	Lloji i shpenzimit	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029
							Fakt	Fakt	Fakt	I rishikuar	Parashikimi	Parashikimi	Parashikimi
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1	Ndertimi dhe Operimi i Rruges se Arbrit	2018	2031	04520	Investime	2,844,000	3,504,000	3,360,000	3,360,000	3,360,000	3,360,000	3,360,000
	2	Subvencionimi i kontrates koncesionare per ndertimin, permiresimin, shfrytezimin, mirembajtjen dhe rehabitimin e autostrades Milot - Morine	2019	2032	04520	Investime	666,563	608,601	588,670	660,000	590,000	590,000	590,000
	3	Ndertimi dhe Operimi i Porti Jahteve Orikum - Dukat	2021	2034	04520	Investime	726,787	786,380	762,548	860,000	767,000	767,000	767,000
	4	Ndertimi dhe Mirembajtja e Portit te Integruar te Triportit Vlore	2023	2032	04520	Investime	0	0	0	0	0	0	0
Ministria e Financave	1	Shërbimi i Skanimit në Dogana	2013	2030	01150	Korrente	1,540,310	1,411,985	1,441,412	1,480,235	1,476,189	1,520,475	1,566,089
Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale		Konçesioni/PPP Kontrolli baze i popullsise 35-70 vjeç (jo-aktive)	2015	2026	07220	Korrente	876,083	876,083	860,158	699,823	0	0	0
		Konçesioni/PPP Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale (jo-aktive)	2016	2026	07330	Korrente	1,749,982	1,755,835	1,899,982	582,770	0	0	0
		Konçesioni/PPP Ofrimi i sherbimit te dializes ne 5 spitale rajonale (jo-aktive)	2016	2026	07330	Korrente	849,129	894,392	931,978	822,230	0	0	0
	1	Ofrimi i Shërbimeve laboratorike spitalore	2020	2030	07330	Korrente	1,718,879	1,802,818	1,893,575	2,200,000	2,200,000	2,350,000	2,500,000
Bashkia Tiranë / Ministria e Arsimit	1	Për përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë Tiranë	2018	2029	09120	Investime	698,074	722,121	707,568	716,178	655,427	625,570	321,279
Ministria e Mjedisit / Bashkia Tiranë	1	Ndërtimi i Landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimit të venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike	2017	2047	06220	Korrente	989,797	931,363	913,112	1,333,710	1,000,000	1,100,000	1,200,000
	8	TOTALI					12,659,602	13,293,576	13,359,003	12,714,946	10,048,617	10,313,045	10,304,369
Totali i të Ardhurave Tatimore për periudhën 2023-2029							598,661,930	658,847,210	716,283,250	798,087,905	852,962,132	896,288,848	937,972,095
Respektimi i Rregullit Fiskal (përpjesa e pagesave të PPP ndaj totalit të të ardhurave tatimore të vitit paraardhës buxhetor më pak se 5%)							2.3%	2.2%	2.0%	1.8%	1.3%	1.2%	1.1%

Burimi: Ministria e Financave (2026)

Për sa i përket respektimit i paragrafit të parafundit të nenit 4/2 të Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor, ku përcaktohet se: "...*shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 përqind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor...*", rezulton se:

- *Për vitin 2027, kufiri i lejuar i pagesave neto për kontratat koncesionare/PPP, prej 5% i të ardhurave tatimore të pritshme të vitit 2026, është rreth 39.9 miliardë lekë.*
- *Për vitin 2027, pagesat vjetore neto që parashikohet të kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme për kontratat koncesionare/PPP, kapin vlerën rreth 10.05 miliardë lekë.*
- *Rrjedhimisht, në buxhetin 2027 respektohet kufizimi ligjor i sipërcituar në zbatim të rregullit fiskal respektiv, pasi vlera e parashikuar prej rreth 10.05 miliardë lekë për pagesat vjetore neto të kontratave koncesionare apo PPP për vitin 2027, përbën vetëm 1.3% të totalit të të ardhurave tatimore të pritshme për vitin 2026 prej rreth 798.1 miliardë lekë.*

Ky rregull vijon të respektohet rigorozisht edhe për vitet 2028 dhe 2029, ku përqindja e pagesave buxhetore të kontratave koncesionare/PPP ndaj totalit të parashikuar të të ardhurave tatimore të një viti më parë, **ulet respektivisht në 1.2% dhe 1.1%**.

Monitorimi dhe raportimi mbi kontratat koncesionare/PPP është institucionalizuar përmes përfshirjes në Udhëzimin Plotësues nr.2 datë 14.01.2026 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026*", të skedulit të detyrueshëm kohor të raportimit të tyre nga çdo Autoritet Kontraktor dhe të formateve standarde respektive, me qëllim thellimin e analizës dhe rritjen e transparencës. Ky monitorim është kryer në bazë të rregullt mujore.

Përsa i përket ecurisë faktike të pagesave koncesionare për 9M 2026, në vijim tabloja përmbledhëse:

- Fondet buxhetore të alokuara sipas planit me ndryshime për vitin 2026, të raportuara nga Autoritetet Kontraktore përkatëse me destinacion mbështetjen buxhetore për kontratat koncesionare/PPP, rezultojnë në total rreth 12.72 miliardë lekë. Nga këto, rreth 7.12 miliardë lekë shpenzime korente dhe rreth 5.6 miliardë lekë investime.
- Krahasuar me pagesat faktike të 12M 2025, të cilat arritën vlerën rreth 13.36 miliardë lekë, plani i pagesave për vitin 2026 është rreth 4.8% më i ulët ose rreth 644 milionë lekë më pak.
- Pagesat faktike për periudhën 9 mujore 2026 rezultojnë në masën rreth 8 miliardë lekë ose 62.9% e planit vjetor me ndryshime të vitit 2026. Nga këto, niveli më i lartë i pagesave është realizuar në muajin Prill me rreth 1.97 miliardë lekë ose 24.6% të pagesave faktike 9M, nga të cilat:

- *Pagesa më e lartë është ajo prej 960 milionë lekë për kontratën "Përmirësimi, Ndërtimi, Operimi dhe Mirëmbajtja e Rrugës së Arbrit", e cila përbën 48.8% të totalit të pagesave faktike të realizuara në muajin Prill 2026.*

- Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, pagesat faktike për 9M 2026 rezultojnë rreth 1.61 miliardë lekë më të ulëta ose rreth 17% më pak, ulje e cila i dedikohet kryesisht:
  - Përfundimit të kontratës *"Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale",* në muajin Mars 2026.
  - Mosrealizimit të kësteve vjetore të pagesave buxhetore deri në fund të periudhës 9M 2026 për *"Subvencionin e kontratës koncesionare "Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e autostradës Milot - Morinë"*, për shkak të mungesës së plotësimit të dokumentacionit teknik-financiar nga Shoqëria Koncesionare.
- Nga ana tjetër, për disa kontrata koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore për periudhën 9M 2026 ka patur rritje të pagesave buxhetore krahasuar me 9M 2025, ku veçojmë kontratën "*Ofrimi i shërbimeve laboratorike mjekësore*". Rritja e pagesave faktike për 9M 2026 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 (195.7 milionë lekë më të larta) për këtë kontratë vjen si pasojë e rritjes së numrit të analizave dhe vlerës përkatëse të tyre.

Sektori Energjitik

Ky sektor strategjik ka qenë dhe mbetet nën monitorimin e Ministrisë së Financave, duke patur parasysh ndikimin e konsiderueshëm fiskal dhe impaktin e ndjeshëm të tij në ekonomi. Ky monitorim, i cili kryhet periodikisht mbi bazë tremujore, konsiston në analizimin e treguesve të performancës financiare të secilës prej tre kompanive energjetike KESH, OST dhe OSHEE Group.

Në mbështetje të nenit 4/2 të ligjit 57 datë 02.06.2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar", sipas së cilit: "*...Planet financiare vjetore dhe pasqyrat financiare mbi bazë tremujore, të çdo njësie jo të qeverisjes së përgjithshme, dorëzohen në Ministrinë e Financave...*", Ministria e Financave, periodikisht mbi bazë tremujore, mbledh, përpunon dhe analizon informacionin e nevojshëm në lidhje me treguesit e performancës financiare të tre kompanive të sektorit energjetik dhe ndërmarrjeve shtetërore të cilat mund të kenë një impakt të mundshëm në buxhetin e shtetit. Kjo, me qëllim identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e risqeve fiskale që rezultojnë nga ndërmarrjet publike me kapital shtetëror në tërësi dhe nga sektori energjetik në veçanti, duke konsideruar rëndësinë strategjike të tij dhe problematikat sensitive që e karakterizojnë.

Më poshtë paraqiten në mënyrë të përmbledhur tabelat e ekspozimit ndaj sektorit të energjisë elektrike dhe madhësia aktuale e detyrimeve kontigjente në lidhje me këtë sektor.

Tabela 15: Të dhëna mbi financimin nga buxheti i shtetit për 12M 2022-9M 2026 (në milionë lekë)

Sektori Energjetik	2023		2024		2025		9M 2026	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Financim nga buxheti i shtetit	**14,000**	**873**	**2,000**	**308**	**2,000**	**0**	**2,000**	**0**
Garancitë Sovrane për Sektorin e Energjisë (OSHEE Group sh.a)	-	-	-	-	-	-	-	-
Hua e dhenë për Sektorin e Energjisë	-	-	-	-	-	-	-	-
Mbështetjen buxhetore për sektorin energjetik	*12,000*	-	-	-	-	-	-	-
Financimi i huaj për sektorin e energjisë	*2,000*	*873*	*2,000*	*308*	*2,000*	-	*2,000*	-

Burimi: MF 2026

Tabela 16: Të dhëna mbi impaktin e sektorit në financat publike për 12M 2021-9M 2026 (në milion lekë)[3]

Sektori Energjetik	2022	2023	2024	2025	9M 2026
Ndikimi në financat publike:	**33,017**	**5,286**	**6,045**	**5,277**	**2,501**
1. Garancitë dhe nënhuatë e paguara nga MF	**12,973**	**5,285**	**6,045**	**5,277**	**2,497**
Garanci të paguara nga MF	*2,989*	*1,149*	*1,631*	*2,256*	*955*
Projekte me financim të huaj të nënhuazuara	*2,077*	*4,136*	*4,414*	*3,021*	*1,542*
Hua e dhënë për energjinë	*7,907***	-	-	-	-
2. Mbështetje buxhetore për sektorin energjetik	***20,000*****	-***	-	-	-
3. Detyrimet Tatimore (të papaguara vjetore)	**43.4**	**0.1**	**0.5**	**0.02**	**3.92**

Në terma të riskut fiskal, impakti i sektorit si kosto apo të ardhura të munguara në financat publike deri në përiudhën 9M 2026, vlerësohet rreth 2.5 miliardë lekë, nga rreth 5.28 miliardë lekë në vitin 2025, duke treguar një përmirësim të gjendjes së detyrimeve.

Projektet e investimeve me financim të huaj për Sektorin e Energjisë për vitin 2026 u miratuan në nivelin 2 miliardë lekë sipas buxhetit fillestar të miratuar me Ligjin nr.87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", dhe nuk kanë pësuar rishikime gjatë periudhës Janar-Shtator 2026.

Parashikimet deri në fund të vitit 2026 dhe problematika të tjera

Nisur nga raportimet më të fundit të ndërmarrjeve energjetike, parashikimet për risqet finaciare të cilat potencialisht mund të ndikojnë në aktivitetin e sektorit, deri në fund të vitit 2026, janë si më poshtë:

- ✓ **Risku i Tregut të Energjisë:** Tregjet ndërkombëtare të energjisë vijojnë të mbeten të ekspozuara ndaj zhvillimeve gjeopolitike dhe luhatjeve të çmimeve. Krahas konfliktit të zgjatur Rusi–Ukrainë, shpërthimi i konfliktit ushtarak SHBA/Izrael–Iran në fund të shkurtit 2026 dhe ndërprerjet e flukseve energjetike përmes Ngushticës së Hormuzit kanë shtuar ndjeshëm pasigurinë dhe presionet mbi çmimet ndërkombëtare të energjisë. Në këtë kontekst, rritja e çmimeve në tregjet europiane rrit potencialisht ekspozimin e KESH ndaj kostove të importit. Për zbutjen e këtij risku, KESH ka parashikuar rritjen e prodhimit vendas, sigurimin e energjisë nga Karavasta Solar me çmim të rregulluar dhe shfrytëzimin e tepricave nga prodhuesit fotovoltaikë, duke parashikuar importe rreth 465 GËh për vitin 2026, ose rreth 35% më të ulëta krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2025.
- ✓ **Risku Hidrik:** Risku hidrik vijon të mbetet një faktor i rëndësishëm për aktivitetin e KESH, për shkak të varësisë së prodhimit nga kushtet hidrometeorologjike dhe paparashikueshmërisë së prurjeve. Megjithatë, viti 2026 ka nisur me një situatë hidrike të favorshme, me rezervë hidrike prej 727 GËh dhe prurje të larta gjatë periudhës janar–shkurt, duke mundësuar prodhim prej 1,204 GËh, rreth 56% më të lartë se e njëjta periudhë e vitit 2025. Kjo situatë ka mundësuar rritjen e shitjeve dhe reduktimin e ndjeshëm të nevojës për importe, duke ulur ekspozimin e KESH ndaj riskut hidrik dhe atij të tregut. Megjithatë, për shkak të natyrës së paparashikueshme të kushteve hidrike, risku monitorohet në mënyrë të vazhdueshme, duke synuar optimizimin e prodhimit dhe administrimin e rezervës hidrike për përballimin e periudhave të thata të vitit..
- ✓ **Risku i Portofolit të Prodhimit:** Risku i portofolit të prodhimit lidhet me varësinë e lartë të KESH nga prodhimi hidroenergjetik, i cili, për shkak të mospërputhjes sezonale ndërmjet prodhimit dhe kërkesës, si dhe ndikimit të ndryshimeve klimatike, krijon nevojë për importe, veçanërisht gjatë periudhave të thata. Për reduktimin e këtij ekspozimi, KESH po diversifikon portofolin përmes zhvillimit të

[3] ***"Hua e dhënë për energjinë" planifikuar në shumën 8,000 milionë lekë për vitin 2022 (realizimi faktik 7,907 milionë lekë) dhe "Mbështetje buxhetore për sektorin e energjisë" planifikuar në shumën 20,000 milionë lekë për vitin 2022 (realizimi faktik 20,000 milionë lekë).*
****Mbështetje buxhetore për sektorin e energjisë" planifikuar në shumën 12,000 milionë lekë për vitin 2023, nuk u përdor dhe, nëpërmjet Aktit Normativ nr.5 datë 18.10.2023, u rishpërnda për zërat e tjerë të shpenzimeve publike, bazuar në situatën e qëndrueshme të sektorit.*

kapaciteteve të reja fotovoltaike, përfshirë projektet në Vaun e Dejës, Belsh dhe Tragjas, si dhe përmes marrëveshjeve afatgjata të blerjes së energjisë (PPA) nga prodhuesit vendas të burimeve të rinovueshme të energjisë (BRE), si Karavasta Solar dhe projekti i Spitallës. Megjithatë, duke qenë se një pjesë e këtyre investimeve pritet të japë efekt në periudhën afatmesme, risku i portofolit të prodhimit mbetet sërisht i pranishëm gjatë vitit 2026, ndërsa diversifikimi gradual synon të reduktojë varësinë nga prodhimi hidro dhe ekspozimin ndaj importeve dhe çmimeve të tregut.

- ✓ **Risku i Likuiditetit:** Për vitin 2026, risku i likuiditetit për KESH pritet të mbetet i pranishëm dhe i lidhur ngushtë me ecurinë e arkëtimeve nga operatorët e tjerë të sektorit, veçanërisht OSHEE Grup sh.a. dhe OST sh.a. Niveli ende i lartë i llogarive të arkëtueshme, rreth 60.2 mld lekë në fund të vitit 2025, si dhe vonesat apo luhatjet në shlyerjen e detyrimeve mund të ushtrojnë presion mbi flukset monetare të Korporatës, aftësinë për të përmbushur detyrimet dhe financimin e aktivitetit operativ e të investimeve. Nga ana tjetër, kushtet e favorshme hidrike të fillimvitit, reduktimi i nevojës për importe dhe rritja e aktivitetit tregtar përmes ALPEX krijojnë premisa për përmirësimin e likuiditetit gjatë vitit 2026. Megjithatë, ky përmirësim mbetet i kushtëzuar nga vijueshmëria e arkëtimeve dhe performanca financiare e operatorëve të tjerë të sektorit. Për KESH sh.a. ky risk kushtëzohet kryesisht nga shlyerja e detyrimeve të prapambetura prej OSHEE Group sh.a. dhe OST sh..a. Ndërkohë që, për OST sh.a risku i likuiditetit lidhet me detyrimet e prapambetura ndaj shoqërive të tjera të sektorit energjetik.

Detyrimet e ndërsjella mes ndërmarjeve të sektorit energjetik, ML/IB, MF dhe DPT

Në kuadër të reformës në sektorin e energjisë, në muajin Dhjetor të vitit 2020 u finalizua me sukses plani i masave për reduktimin e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike. Ky plan masash, sipas Urdhërit të Përbashkët të MF dhe MIE nr.304/2020 "*Për miratimin e planit të masave të reduktimit të detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike*", i vënë në zbatim që prej Janarit 2021 e në vijim, shërben si instrument kryesor për realizimin e një prej elementeve kryesore të reformës në këtë sektor jetik për ekonominë e vendit, siç është arritja e konsolidimit financiar të sektorit elektroenergjetik.

Ky plan ofron një seri masash për parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura dhe disiplinimin e pagesave ndërmjet kompanive të sektorit energjetik dhe palëve kryesore të lidhura me to. Me qëllim zbatimin me sukses të këtij plani, Ministria e Financave dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, bashkëfirmosën Urdhërin e Përbashkët nr.379 datë 30.09.2021 "*Mbi zbatimin e planit të masave për reduktimin e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike*", që ngarkon ndërmarrjet e sektorit energjetik për raportim mujor mbi shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe statusin e detyrimeve ndërmjet sektorit të energjisë dhe entiteve të tjera publike. Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë tabelare detyrimet e ndërsjella në sektorin e energjisë elektrike:

Tabela 17: ***Detyrimet e ndërsjella midis ndërmarjeve të sektorit energjetik, ML/IB,MF dhe DPT***

Deri në Gusht 2026 (në mld Lekë)	KESH	OST	OSHEE	MF	DPT	Total
KESH ndaj:		0		46.07		**46.07**
OST ndaj:	9.28		0.11	7.52		**16.91**
OSHEE ndaj:	44.51	7.83		2.84	4.89	**60.07**
Ndërmarrjet UK ndaj:			34.4	11.39		**45.79**
ML/IB			6.80			**6.80**
Total	**53.79**	**7.83**	**41.31**	**67.82**	**4.89**	**175.6**

Burimi: KESH, OST, OSHEE Group, AKUK 2026

Detyrimet e shoqërive të Ujësjellës - Kanalizimeve ndaj OSHEE Group sh.a

Deri në muajin Qershor 2026, OSHEE Group sh.a raporton se detyrimet e akumuluara të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve rezultojnë të jenë në vlerën rreth 34.4 miliardë lekë. Nga të cilat, rreth 17.41 miliardë lekë janë detyrime të faturuara ndaj kompanisë dhe rreth 16.99 miliardë lekë janë detyrime për kamatëvonesa. Në tabelën e mëposhtme listohen pesë ndërmarrjet që kanë pjesën më të madhe të detyrimeve (principal pa kamata) ndaj OSHEE Group sh.a, deri në 6 mujorin e parë të vitit 2026:

Tabela 18: ***Ujësjellësat me stokun më të lartë të detyrimeve të prapambetura (principal pa kamata) ndaj OSHEE Group sh.a për 6M 2026 (në mld lekë).***

	(miliardë/lekë)
Ndërmarrjet U-K kryesore me detyrime ndaj OSHEE Group sh.a	**10.09**
Njësia Durrës UK sh.a	5.72
Njësia Vlorë UK sh.a	1.77
Njësia Patos UK sh.a	0.88
Njësia Fier UK sh.a	0.88
Njësia Shkodër UK sh.a	0.84

Burimi: AKUK, Qershor 2026

Problematikë mbetet stoku i detyrimeve të akumuluara nga ndërmarrjet UK sh.a ndaj sektorit të energjisë (OSHEE Group), kryesisht për shkak të performancës së ulët të pjesës më madhe të shoqërive UK sh.a. Procesi i reformimit dhe riorganizimit të sektorit të Ujit, i startuar në 2022, vazhdon në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë e Kanalizime 2020-2030.

Në zbatim të VKM nr.302/2022 "*Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura*", reforma për sektorin e ujësjellës kanalizimeve ka hyrë tashmë në një faze konsolidimi. Synimi i kësaj reforme ishte ridimensionimi i 58 ndërmarrjeve U-K aktuale nëpërmjet rigrupimit të tyre në 15 shoqëri SKP-UK (*Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta*) rajonale, me qëllim rritjen e mirëmenaxhimit dhe performancës financiare. Aktualisht janë krijuar 14 shoqëri SKP-UK rajonale dhe procesi ka përparuar edhe në drejtim të strukturimit të brendshëm të këtyre shoqërive.

Ndërkohë, subvencioni nga buxheti i shtetit për ndërmarrjet UK të cilat nuk arrijnë të mbulojnë koston/shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes i planifikuar në vlerën 350 milionë lekë në programin përkatës të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, deri në fund të periudhës 9 mujore është akorduar në vlerën 17.59 milionë lekë.

Të tjera Ndërmarrje Shtetërore (NSH) të monitoruara gjatë 6M 2026:

Përveç sektorit të energjisë, Ministria e Financave monitoron në mënyrë periodike ndërmarrje të tjera shtetërore të cilat kanë impaktin më të lartë financiar për buxhetin e shtetit apo që mund të paraqesin risqe të konsiderueshme fiskale, duke analizuar mbi baza tremujore performancën e tyre. Referuar analizës mbi raportimin më të fundit të treguesve financiarë të raportuar nga ndërmarrjet shtetërore në monitorim, vlen të veçojmë:

- ***UKT sh.a (Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a):***

Gjatë T2 2026, të ardhurat e UKT sh.a (Ujësjellës Kanalizime Tiranë) rezultuan në rreth 2.47 miliardë lekë, ndërsa shpenzimet e përgjithshme në rreth 1.68 miliardë lekë. Për rrjedhojë, shoqëria regjistroi një fitim neto pozitiv për periudhën prej rreth 782.8 milionë lekë, duke treguar një vazhdimësi të ecurisë financiare pozitive. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, fitimi neto rezulton 219.9 milionë lekë më i lartë.

Subvencioni buxhetor për NSH-të e sektorit Ujësjellës Kanalizime, për vitin 2026 është planifikuar në vlerën 350 milionë lekë dhe, deri në fund të periudhës 9 mujore të vitit 2026, është akorduar në vlerën rreth 17.59 milionë lekë.

- ***Hekurudha Shqiptare sh.a:***

Gjatë T2 2026, të ardhurat e Hekurudhës Shqiptare sh.a rezultuan në rreth 251.6 milionë lekë, ndërsa shpenzimet e përgjithshme në rreth 481.6 milionë lekë. Për rrjedhojë, shoqëria rezultoi me një humbje neto për periudhën prej rreth 230 milionë lekë ose 95.5 milionë lekë më e ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.
Subvencioni buxhetor për Hekurudhën Shqiptare sh.a për vitin 2026 është planifikuar në vlerën 500 milionë lekë dhe, deri në fund të periudhës 9 mujore të vitit 2026, është akorduar në vlerën rreth 392.3 milionë lekë.

- ***AlbGaz sh.a:***

Gjatë T2 2026, të ardhurat e Albgaz rezultuan në rreth 3.8 milionë lekë ndërsa shpenzimet e përgjithshme në rreth 67.2 milionë lekë, duke regjistruar një humbje neto për periudhën prej rreth 63.3 milionë lekë. Ky nivel humbje rezulton 18.2 milionë lekë më e ulët krahasuar me të njëtën periudhë të një viti më parë.

- ***Autoriteti Portual Durrës Sh.a (APD):***

Gjatë T2 2026, të ardhurat e APD rezultuan në rreth 1.61 miliardë lekë, ndërsa shpenzimet e përgjithshme në rreth 1.34 miliardë lekë, duke regjistruar një fitim neto për periudhën prej rreth 263.8 milionë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë fitimi neto rezulton në rreth 89.8 milionë lekë më i ulët.

- ***Albpetrol Sh.a:***

Gjatë T2 2026, të ardhurat e Albpetrol sh.a rezultuan në rreth 2.17 miliardë lekë, ndërsa shpenzimet e përgjithshme në rreth 1.77 miliardë lekë, duke regjistruar një fitim neto në rreth 397.4 milionë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë fitimi neto rezulton në rreth 1.08 miliardë lekë më i lartë.

Detyrimet Kontigjente:

Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ), kryesisht për çështje dhe vendime që lidhen me kthimin dhe kompensimin e pronave tek ish-pronarët.

- Sipas Avokaturës së Shtetit, risqet financiare që burojnë nga vendimet e GJEDNJ janë të kushtëzuara nga një aftësi e dobët parashikuese, përsa kohë që kjo Gjykatë nuk funksionon me një kalendar të përcaktuar për komunikimin e çështjeve dhe nxjerrjen e vendimeve.
- Ministria e Financave ka respektuar në vazhdimësi të gjitha vendimet e miratuara nga GJEDNJ përmes zbatimit të VKM-ve respektive miratuar në mbështetje të tyre, me përpikmëri dhe brenda afateve strikte të përcaktuara prej këtij organi. Kjo, duke konsideruar faktin se kur pagesat nuk kryhen brenda afatit tre mujor nga data kur vendimi përkatës merr formën e prerë, shteti shqiptar ngarkohet me pagesën e një kamatë-vonese për çdo ditë vonesë.
    - ✓ *Sidoqoftë, për garantimin e shlyerjes në kohë të këtyre vendimeve, MF ka rekomanduar vazhdimisht përdorimin e të gjitha kanaleve të mundshme institucionale dhe proceduriale, brenda hapësirave që siguron kuadri ligjor në fuqi, duke sugjeruar sipas mundësive të buxhetit të shtetit skedulimin me këste të detyrimit financiar, në negocim me përfituesit. Edhe*

për vitin 2026, likuidimi i detyrimeve të këtij lloji përballohet nga Fondi Rezervë i buxhetit të shtetit.

- Hyrja në fuqi më datë 30.12.2018 e ndryshimeve në ligjin "*Për Avokaturën e Shtetit*", përmban një kre të veçantë dedikuar ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së, ku specifikisht në nenin 19/5 përcaktohen dy mënyra ekzekutimi të shpërblimit:
  - ✓ *Detyrimet financiare që burojnë nga vendimet e GJEDNJ-së mbulohen nga buxheti i shtetit, sipas përcaktimeve të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për ekzekutimin e vendimit përkatës të GJEDNJ.*
  - ✓ *Përjashtimisht, për detyrimet financiare deri në 10.000 (dhjetë mijë) euro, pagesa ekzekutohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ministria përgjegjëse për financat, pas njoftimit nga Avokatura e Shtetit.*

Në vijim, paraqitet tabela përmbledhëse e detyrimeve për vendimet e GJEDNJ, bazuar në informacionin zyrtar të raportuar pranë Ministrisë së Financave:

Tabela 19*: Detyrimet faktike dhe kontigjente nga vendimet e GJEDNJ deri në Shtator 2026 (në Euro)*[4]

[4] *Detyrimi sipas vendimit të GJEDNJ/VKM është detyrimi përkatës nga një vendim i formës së prerë të GJEDNJ/VKM-së respektive, i cili rezulton ende i papaguar deri në fund të periudhës 9M 2026.*
Detyrim kontingjent është detyrimi i pritshëm/potencial nga një vendim në shqyrtim ose në pritje për të marrë formë të prerë nga GJEDNJ, i raportuar nga Avokatura e Shtetit deri në fund të periudhës 9M 2026.

Data e vendimit	Vendimet e GJEDNJ	Detyrimi sipas vendimit të GJEDNJ/VKM	Detyrimi kontingjent	Totali i detyrimit
14.09.2015	Delijorgji kundër Shqipërisë	15,600 €		15,600 €
17.03.2016	Rista dhe të tjerë kundër Shqipërisë (Kërkesa: Dhimërtika dhe Nika k. Shqipërisë)	4,417,750 €		4,417,750 €
28.05.2018	Sharxhi kundër Shqipërisë	13,447,300 €		13,447,300 €
05.06.2024	Iliria s.r.l kundër Shqipërisë	10,800 €		10,800 €
11.09.2024	Zela kundër Shqipërisë	60,000 €		60,000 €
05.05.2026	Metalla kundër Shqipërisë	32,400 €		32,400 €
23.06.2026	Osmani kundër Shqipërisë	11,000 €		11,000 €
23.06.2026	Elezi kundër Shqipërisë	11,000 €		11,000 €
30.06.2026	Lepuri dhe të tjerë kundër Shqipërisë	28,855 €		28,855 €
25.08.2026	Papandile kundër Shqipërisë	3,000 €		3,000 €
Vendim në pritje nga GJEDNJ	Ledi Binaku kundër Shqipërsë		1,800 €	1,800 €
Vendim në pritje nga GJEDNJ	Ramaj kundër Shqipërisë		2,095,122 €	2,095,122 €
	Totali	**18,037,705 €**	**2,096,922 €**	**20,134,627 €**

Burimi: Avokatura e Shtetit, Ministria e Financave (2026)

Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, që kanë të bëjnë me zgjidhjen e konflikteve në mosmarrëveshjet dy ose shumëpalëshe, në ngarkim të shtetit shqiptar.

- Duke patur parasysh efektet e qënësishme financiare që rëndom shoqërojnë këto vendime, ato vlerësohen me risk të konsiderueshëm për buxhetin e shtetit. Në pjesën më të madhe, efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtyre vendimeve janë përballuar nga buxheti i vetë institucioneve buxhetore (kryesisht ministri linje), të cilat kanë qenë edhe palë e paditur në gjykimet respektive. Ndërkohë që, në rastet kur palë e paditur cilësohet 'shteti shqiptar' apo 'qeveria shqiptare', këto vendime likujdohen përmes buxhetit të MF dhe/ose Fondit Rezervë të buxhetit të shtetit, nëse lind nevoja.
    - ✓ *Ministria e Financave, në vazhdimësi, ka rekomanduar forcimin e rolit negociues të institucioneve buxhetore dhe Avokaturës së Shtetit në çështjet e kësaj natyre, si edhe disiplinimin e procesit të shlyerjes financiare të përfituesve. Kjo, me qëllimin final të lehtësimit, reduktimit dhe/ose shmangies së barrës financiare mbi buxhetin e shtetit.*

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse e detyrimeve për vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar, bazuar në informacionin që disponon Ministria e Financave.

Tabela 20: ***Detyrimet faktike dhe kontingjente nga vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar deri në Shtator 2026[5] (në Euro)***

Ministria e Linjës	Përshkrimi i Vendimeve të Arbitrazhit	Detyrimi i mbetur nga vendimet e Arbitrazhit/kosto ligjore (A)	Detyrime Kontigjente (B)	Totali i detyrimit (C=A+B)
MIE/ARRSH	ICC Case no. 23998/MHM (c-24011/MHM/HBH). *JV Copri-Aktor vs ARRSH.*	41,144,749	0	41,144,749
	Kosto ligjore dhe shpenzime gjyqësore ICC Case no. 23998/MHM (c-24011/MHM/HBH)	150,000	0	150,000
MIE/AKUK	ICC Case 24140/MHM Construzioni DONDI S.P.A	13,282,845	0	13,282,845
	Kostot administrative, të përfaqësimit dhe kosto ligjore për çështjen ICC Case no.24140/MHM/HBH *Construzioni DONDI S.P.A*	28,500	0	28,500
MIE/AKBN/ Albpetrol Sh.a	ICC Case no.22676/GR GBC Oil Company LTD vs MIE, AKBN dhe Albpetrol	11,855,415	0	11,855,415
	Kosto ligjore për procedurat e përfaqësimit në çështjen ICC Case no. 22676/GR	1,455,400	0	1,455,400
MF	Shpenzime përfaqësimi dhe gjyqësore/administrative në kuadër të ICC case 29845/ICA7 LK invest shpk & Novomatic AG v. RSH	1,600,000	0	1,600,000
	Përfaqësimi i Shqipërisë në çështjen e arbitrazhit Mimoza Ndroqi kundër RSH	330,000	295,000	625,000
	Arbitrazhi ICSID nr.ARB/15/28 "Hydro dhe të tjerët kundër Shqipërisë"	0	108,302,807	108,302,807
	Kosto ligjore lidhur me vendimin e Arbitrazhit ICSID nr.ARB/15/28 "Hydro dhe të tjerët kundër Shqipërisë"	2,771,575	1,180,000	3,951,575
	Kosto ligjore për proceset e kundërshtimit të Dekretit Ekzekutues R.G.n 27416/2024	30,000	410,000	440,000
MTKS	Kosto lidhur me përfaqësimin për çështjen ICC Case 29714/ICA7 Erjoni shpk v. MTM/RSH	1,900,000	0	1,900,000
	Total	**74,548,483**	**110,187,807**	**184,736,290**

Burimi: Avokatura e Shtetit, Ministritë e Linjës/Institucionet Buxhetore, Ministria e Financave (2026)

Monitorimi dhe raportimi i vendimeve të GJEDNJ dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar është institucionalizuar përmes përfshirjes në Udhëzimin Plotësues nr.2 datë 14.01.2026 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026*", të skedulit të detyrueshëm kohor të raportimit të tyre nga ML/IB dhe Avokatura e Shtetit, si edhe të formateve standarde respektive për qëllim analize, transparence dhe raportimi të detyrimeve kontingjente të qeverisjes së përgjithshme.

[5] *Detyrim Faktik është e detyrimi i cituar në një vendim përfundimtar të gjykatës së gjednj/arbitrazhit/, i formës së prerë, per të cilin nuk janë finalizuar procedurat juridike brenda shtetit shqiptar.*
Detyrim Kontigjent është detyrimi i cituar në një vendim të gjykatës së gjednj/arbitrazhit/, dhe/ose kontrata eventuale të studiove ligjore, për të cilin nuk kanë përfunduar procedurat ligjore.

Detyrimet e Prapambetura - Bazuar në VKM nr.50 datë 05.02.2014 "*Për miratimin e Strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit*", Ministria e Financave ka ndërmarrë disa hapa konkretë në drejtim të monitorimit, raportimit dhe parandalimit të detyrimeve të prapambetura. Tashmë ky është një proçes i konsoliduar në kohë dhe cilësi, përmes gjenerimit automatik nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ) sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr.37/2020 "*Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme*". Ky format i raportimit të detyrimeve të prapambetura, përveçse rrit saktësinë dhe siguron të dhënat në kohë, është gjithashtu një format gjithëpërfshirës duke unifikuar modalitetin e raportimit për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Prioriteti kryesor në periudhën afatmesme të Ministrisë së Financave mbetet reduktimi i stokut të detyrimeve të prapambetura dhe parandalimi i akumulimit të tyre. Duke filluar nga viti 2018, stoku vjetor i detyrimeve të prapambetura ka ndjekur një trend rënës, edhe pse faktorë të tillë si efektet e krizës globale energjetike, lufta në Ukrainë, luhatjet e çmimeve të energjisë, karburanteve dhe inputeve, kanë sjellë luhatje të përkohshme. Ky trend rënës pritet të vijoj edhe për vitin 2026. Duke konsideruar që procesi i shlyerjes së detyrimeve nga ana e institucioneve kryhet në respektim të parimit FIFO, rezulton se detyrimet që mbeten për t'u shlyer gjatë vitit 2026 karakterizohen nga një "*moshë mesatare*" e re e krijimit të tyre.

Për periudhën 9M 2026, në total, stoku paraprak i detyrimeve të prapambetura të qeverisë së përgjithshme krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë rezulton rreth 6.26 miliardë lekë më i ulët. Deri në fund të muajit Shtator 2026, u regjistrua një stok paraprak kumulativ prej rreth 6.41[6] miliardë lekë i detyrimeve të prapambetura nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, nga të cilat:

- ✓ *Totali detyrimeve të prapambetura të NJQQ rreth 2.1 miliardë lekë, nga të cilat:*
  - *Investimet zënë peshën më të madhe të stokut të detyrimit rreth 28.8%,*
  - *Detyrime të prapambetura të tjera[7] zënë rreth 28.3%,*
  - *Vendimet Gjyqësore zënë rreth 22.4%,*

[6] *Pa përfshirë detyrimet e prapambetura të Ujësjellës Kanalizime dhe Universiteteve.*
[7] *Në zërin detyrime të tjera përfshihen: Energjia elektrike, Paga, Shpronësime, Transferta për individët, Transferta për subjektet, të tjera.*

- *Shërbimet me rreth 6.9%,*
- *Mirëmbajtje me rreth 4.9%,*
- *Mallra me rreth 2.8%,*
- *Të Ardhurat Personale me rreth 2%,*
- *Detyrimet për sigurimet shoqërore me rreth 2%,*
- *Rimbursimi i TVSH-së me rreth 1.1%.*
- *Detyrimet për sigurimet shëndetsore me rreth 0.9%,*

✓ *Totali detyrimeve të prapambetura të NJVQV rreth 2.9 miliardë lekë, nga të cilat:*

- *Investimet zënë peshën më të madhe të stokut të detyrimit me rreth 35.6%,*
- *Detyrime të prapambetura të tjera me rreth 22.4%,*
- *Shërbime me rreth 18.1%*
- *Vendimet Gjyqësore rreth 12.3%,*
- *Mallra me rreth 8.1%,*
- *Mirëmbajtje rreth 2.4%,*
- *Detyrimet për sigurimet shoqërore me rreth 0.7%,*
- *Të Ardhurat Personale me rreth 0.3%,*
- *Detyrimet për sigurimet shëndetsore me rreth 0.1%.*

Krahasuar me stokun e detyrimeve të prapambetura të raportuara për 9M 2025, rezulton se *niveli i përgjithshëm i detyrimeve të prapambetura është rreth 6.26 miliardë lekë më i ulët, ku konkretisht:*

✓ *Totali i detyrimeve të njësive të qeverisjes qendrore është ulur me rreth 5.22 miliardë lekë.*


✓ *Totali i detyrimeve të njësive të qeverisjes vendore është rritur me rreth 69.88 milionë lekë.*

✓ *Rimbursimi TVSH për periudhën 9M 2026 rezulton rreth 1.11 miliardë lekë më i ulët në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.*

8. VEPRIMTARITË POTHUAJSE FISKALE

Në fund të muajit qershor 2026, portofoli i borxhit të garantuar vlerësohet në rreth 25.2 miliard Lekë (0.9% e PBB) ose 1.84% e portofolit të borxhit të qeverisjes qendrore, duke u ulur me 3.9 miliard Lekë krahasuar me fundin e vitit 2025. Garancitë në tregun e brendshëm zënë rreth 30.2% të stokut total të borxhit të garantuar ose rreth 7.6 miliardë lekë, ndërsa garancitë e dhëna në favor të kreditorëve të huaj përfaqësojnë 69.8% të stokut të borxhit të garantuar ose rreth 17.5 miliardë lekë.


Figura 6: ***Portofoli i borxhit të garantuar sipas rezidencës së kreditorit (2020-Qershor 2026)***



Burimi: *Ministria e Financave (2026)*

Mbi 80% e totalit të garancive shtetërore i përkasin sektorit të energjisë, duke reflektuar politikat e qeverisë në drejtim të mbështetjes së sektorit të energjisë.

Figura 7: ***Garancitë shtetërore sipas sektorëve ekonomikë (2020–Qershor 2026)***




Burimi: *Ministria e Financave (2026)*

9. SHTOJCA ILUSTRUESE

9.1TREGUESIT E PËRZGJEDHUR MAKROEKONOMIKË DHE FISKAL

Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit (inflacioni) në muajin shtator 2026 shënoi +2.9%, një vit më parë ky ndryshim ishte +2.4%. Ndryshimi mujor i inflacionit në muajin shtator 2026, krahasuar me me një muaj më parë, ishte +0.4%. Inflacioni mesatar për periudhën janar - shtator 2026 është +2.9%.


Figura 8: Ndryshimi vjetor i inflacionit (në përqind)



Burimi: Instat, Tetor 2026

Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE) shënoi nivelin 107.8 në muajin shtator 2026, duke tkurrur me 0.3 pikë përqindje krahasuar me muajin e kaluar dhe duke rritur me 2.3 pikë përqindje në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më pare. Megjithatë, niveli aktual i TNE-së qëndron rreth 7.8 pikë përqindje mbi mesataren historike. Rritja e TNE-së këtë muaj u ndikua kryesisht nga rritja e treguesit të besimit në sektorin e ndërtimit dhe, më pak, nga rritja e besimit të konsumatorit. Ndërkohë, treguesit e besimit në sektorët e industrisë, shërbimeve dhe tregtisë regjistruan rënie.


Figura 9: Treguesi i Ndjesisë Ekonomike



Burimi: Banka e Shqipërisë, Tetor 2026

Indeksi i "Tregtisë me Pakicë" gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026 në terma *Volumi*, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të mëparshëm, u rrit me *6.8%.* Indeksi i Tregtisë me Pakicë gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026 në terma *Vlere*, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të mëparshëm, u rrit me 9.9*%.*

Figura 10: Rritja e vlerës të tregtisë me pakicë (vit-më-vit, në %)



Burimi: Instat, Shtator 2026

Lidhur me të dhënat më të fundit të tregtisë së jashtme, në muajin gusht 2026 eksportet e mallrave arritën vlerën 20.5 miliardë lekë, duke u rritur me 1.6%, në terma vjetor dhe me një rënie prej 39% në terma mujor. Importet e mallrave arritën vlerën 75.6 miliardë lekë, duke u rritur në terma vjetore me 12.6%, dhe duke rënë me 12.6%, në krahasim me muajin korrik 2026. Efekti i çmimeve në rënie, i kombinuar me atë të kursit të mbiçmuar të këmbimit, vijon të jetë një faktor mbështetës i kësaj ecurie. Deficiti tregtar i këtij muaji është 55 miliardë lekë, duke u rritur me 17.4%, krahasuar me Gusht 2025, dhe duke u rritur me 4.3% në krahasim me Korrik 2026.

Në këtë tetëmujor eksportet e mallrave arritën vlerën 247.6 miliardë lekë, duke u zgjeruar me 6.3% krahasuar me një vit më parë, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 611.7 miliardë lekë, duke u rritur me 5.1%, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 364.1 miliardë lekë, duke u rritur me 4.4%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025.

Tabela 21: Eksportet dhe importet në vlerë për periudhën janar-gusht 2026 (krahasuar me të njëjtën periudhë të viti më parë).


	Eksporte		Importe	
Rritja e eksporteve	**Rritja (në %)**	**Kontributi në rritje (në pikë %)**	**Rritja (në %)**	**Kontributi në rritje (në pikë %)**
Ushqime, pije, duhan	3.4	0.6	5.8	1.1
Minerale, lëndë djegëse, en.elektrike	20.9	4.0	10.6	1.2
Produkte kimike dhe plastike	-4.5	-0.2	3.6	0.5
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	-18.2	-0.1	-5.8	-0.1
Prodhime druri dhe letre	-5.1	-0.1	2.3	0.1
Tekstile dhe këpucë	-8.0	-2.4	1.4	0.1
Materiale ndërtimi dhe metale	21.4	2.9	1.3	0.2
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	12.1	1.4	6.0	1.5
Të tjera	9.2	0.3	11.6	0.5
Gjithsej	**6.3**	**6.3**	**5.1**	**5.1**


Burimi: Instat, Shtator 2026

Gjatë muajit gusht të vitit 2026 stoku total i depozitave bankare ka arritur në vlerën 1.58 trilionë lekë, duke shënuar një rritje prej 9.78% krahasuar me muajin gusht të vitit 2025, ku ato shënonin vlerën 1.44 trilionë lekë.

Gjatë muajit gusht të vitit 2026, stoku total i kredive bankare pati një rritje me 11.8%, krahasuar me muajin gusht të vitit 2025. Stoku i kredive në lekë shënoi një rritje prej 16.6%, ndërsa ai në valutë rritje prej 4.9%, krahasuar me muajin gusht të vitit të kaluar.

Figura 11: (a) Ecuria e rritjes së stokut total të depozitave, në %, në terma vjetorë; (b) Ecuria e rritjes së stokut total të kredive, në %, në terma vjetorë.







Burimi: Banka e Shqipërisë, Shtator 2026

Standardet e kreditimit për bizneset mbetën të pandryshuara në tremujorin e dytë të vitit 2026. Ato u raportuan të pandryshuara në kreditë për biznesin e madh, për të dyja llojet e përdorimit të kredisë: mbulimin e nevojave për likuiditet dhe financimin e investimeve. Standardet e kreditimit u lehtësuan disi në kreditë për biznesin e vogël e të mesëm.

Ndërkohë, *standardet për kredinë dhënë individëve* gjatë tremujorit të dytë 2026 për blerje banese u lehtësuan në nivelin 7.5%, ndërsa ato për kredinë dhënë individëve për konsum u lehtësuan në nivelin 10.5%.

Figura 12: (a) Lehtësimi (+) Shtrëngimi (-) Standardeve Kredisë për Biznesin - [Investime]; b) Lehtësimi (+) Shtrëngimi (-) Standardeve të Kredisë për Individët - [Konsum]





Burimi: Banka e Shqipërisë (Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues – T2/2026)

9.2 ZHVILLIMET FISKALE GJATË 8-MUJORIT 2026

- Për periudhën Janar-Gusht 2026, të ardhurat nga tatimet dhe doganat u programuan në shumën 357.5 miliardë lekë, 66.4% e planit vjetor prej 538.3 miliardë lekësh, ndërsa të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore (DPT+ISSH+FSDKSH) u planifikuan në shumën 133.6 miliardë lekë ose 66.5% e planit vjetor të të ardhurave nga kontributet prej 200.9 miliardë lekësh.
- Të ardhurat e arkëtuara nga tatimet dhe doganat u realizuan në shumën 356.5 miliardë lekë, -954 milionë lekë ose -0.3% më pak se shuma e planifikuar. Të ardhurat nga tatimet dhe doganat janë rritur me 25 miliardë lekë krahasuar me 8-mujorin e vitit 2025 ose 7.6% më shumë. Të ardhurat e arkëtuara nga kontributet (DPT, ISSH dhe FSDKSH) u realizuan në shumën 134.1 miliardë lekë, +0.4% ose +494 milionë lekë mbi planin e periudhës. Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë rritur me rreth 15.9 miliardë lekë krahasuar me 8-mujorin e vitit 2025 ose +13.4% më shumë.
- Në total, të ardhurat nga tatimet, doganat dhe nga kontributet u mblodhën në masën 490.7 miliardë lekë, duke rezultuar nën planin e periudhës me -461 milionë lekë ose -0.1% më pak.
- Tejkalimi i planit në kontribute, TVSH-në e brendshme, taksat nacionale dhe akcizë ka neutralizuar në masë të konsiderueshme mosrealizimin në TVSH-në në import, tatimin mbi fitimin, tatimin mbi të ardhurat personale dhe taksën doganore, duke e kufizuar diferencën e totalit të të ardhurave ndaj planit në vetëm -0.1%.

Të ardhurat nga Tatimet dhe Doganat sipas zërave:

- Për periudhën Janar-Gusht 2026 konstatohet se të ardhurat nga tvsh neto janë në shumën 165.4 miliardë lekë ose -254 milionë lekë nën plan. Ndikim në këtë performancë ka ecuria jo pozitive e tvsh së mbledhur në import që megjithëse janë +4.2% më të larta në krahasim me vitin e kaluar, gjatë vitit 2026 janë ndikuar negativisht nga kursi i këmbimit. Ky efekt ka qënë rreth -4.95 miliardë lekë (rënie e Dollarit Amerikan me -7.2% dhe rënia e Euros me -3% krahasuar me vitin e kaluar). Megjithë ecurinë e mirë pozitive që ka pasur tvsh e mbledhur brenda vendit, nuk është neutralizuar efekti negativ nga kursi i këmbimit.

Tabela 22 *në milionë lekë*

Totali i të ardhurave	Progresive Janar - Gusht			Dif Fakt Progresive 2026-2025		Dif Progresiv-Fakt-Plan	
	Fakt 2025	Fakt 2026	Plan 2026	Në vlerë	Në %	Në vlerë	Në %
Total TVSH Neto	149,939	165,382	165,636	15,443	10.3%	-254	-0.2%
Tatimi mbi fitimin	40,712	38,628	39,249	-2,083	-5.1%	-621	-1.6%
Akciza	46,235	48,333	48,226	2,098	4.5%	106	0.2%
Tatimi mbi të ardhurat personale	56,703	65,481	66,003	8,778	15.5%	-521	-0.8%
Taksa Nacional Total	31,637	31,908	31,417	271	0.9%	491	1.6%
Taksë doganore	6,244	6,812	6,968	568	9.1%	-155	-2.2%

TOTALI TATIME + DOGANA	**331,469**	**356,544**	**357,499**	**25,075**	**7.6%**	**-954**	**-0.3%**
Kontributet e mbledhura	118,267	134,138	133,644	15,870	13.4%	494	0.4%
TOTALI TATIME(përfshirë kontributet)	**449,737**	**490,682**	**491,143**	**40,945**	**9.1%**	**-461**	**-0.1%**

- Të *ardhurat nga* ***tvsh neto e brendshme*** janë më të larta në krahasim me 8M 2025, në shumën +11.1 miliardë lekë dhe në krahasim me planin e 8M 2026 në shumën prej +2.5 miliardë lekë më shumë. Ndikim ka pasur:

o Për 8M 2026, realizimi mbi plan i TVSH-së neto të brendshme vjen kryesisht si rezultat i nivelit më të ulët të rimbursimeve të kryera gjatë periudhës, efekti i rimbursimeve më të ulëta se planifikimi, me rreth -2.3 miliardë lekë, ka kompensuar këtë ecuri duke bërë që TVSH-ja neto të rezultojë rreth +2.5 miliardë lekë ose +4.5% mbi planin. TVSH-ja bruto e arkëtuar rezulton rreth +136 milionë lekë mbi plan.

o Gjatë 8M 2026 janë dhënë 9.6 miliardë lekë rimbursime ose -2.3 miliardë lekë më pak se planifikimi dhe -4.7 miliardë lekë më pak se 8M 2025.

Në fund të muajit Gusht 2026, stoku i kërkesave të miratuara për rimbursim, por të parimbursuara deri më 31 Gusht 2026 është 3 miliardë lekë.

- Të ardhurat nga ***tatimi mbi të ardhurat personale*** vijojnë trendin rritës krahasuar me 8M e vitit të kaluar, si rrjedhojë e:
  - Ecurisë pozitive të *tatimit mbi të ardhurat nga sektori publik* (+12.1%) dhe sektori privat (+18.4%) në krahasim me 8 M 2025 si rezultat i zbatimit të masave të SAA-së për deklarimin real të pagave në sektorin privat dhe eleminimin e punës së padeklaruar;
  - Rritja e të *ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat nga Dividentët dhe Aksionet* me rreth +688 milionë lekë ose +14.3% më shumë, krahasuar me 8M 2025;
  - Tatimit mbi të ardhurat *nga Interesat e tjera* me rritje prej +33.7% ose rreth +66 milionë lekë më shumë në krahasim me 8M 2025;
  - Rritja e të ardhurave *nga* Honoraret me +29.4%;
  - Rritja e të ardhurave nga *tatimi mbi të ardhurat nga qeratë* me +9.3% ose +354 milionë lekë më shumë, por ende me nënperfomancë në krahasim me planifikimin sipas MTRS, prej 1 miliardë lekë për gjithë periudhën e vitit 2026.
  - Të ardhurat nga *shitja e pasurisë së paluajtshme* përfshijnë të ardhura nga shitja dhe rivlerësimi. Në Shkurt 2026 u miratuan aktet ligjore për rivlerësimin e pasurisë, nga zbatimi i të cilave janë arkëtuar deri në fund të muajit Gusht 2026, +6.5 miliardë lekë. Për periudhën 8 mujore, rezulton se të dy nënzërat së bashku, janë afërsisht +1.9 miliardë lekë më shumë se 8M 2025 (ose +34.4%), megjithëse procesi filloi në mesin e muajit Shkurt nga 1 Janar 2026 që ishte parashikuar.
  - Ecuria pozitive e *tatimit mbi të ardhurat personale biznesore*, i cili për 8 mujorin 2026 ka qënë në masën 3.2 miliardë lekë, ose +73.3% më shumë se në 8M2025, me rritje rreth +1.3 miliardë lekë.
- *Të ardhurat* ***nga tatimi mbi fitimin*** janë me nën performancë në krahasim me planin me rreth -621 milionë lekë ose -1.6%. Problematike është që këto të ardhura janë më të ulta se e njëjta periudhë e vitit të kaluar, me rreth -2.1 miliardë lekë më pak. Me përjashtim të sektorit të shërbimit dhe ndërtimit, i cili regjistron një rritje të lehtë të pagesave të kësteve paraprake të tatim fitimit, të gjithë sektorët e tjerë paraqesin nivele më të ulëta pagese krahasuar me 8M 2025. Ndikimin më të

konsiderueshëm e ka dhënë sektori i prodhimit, me rreth -2.2 miliardë lekë më pak pagesa të kësteve paraprake në raport me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

- **Të *ardhurat nga kontributet*** që mbledh administrata tatimore janë +163 milionë lekë mbi planin ose rreth +0.1% më shumë. Ndërsa në total, (përfshirë ISSH dhe FSDKSH) të ardhurat janë realizuar me +494 milionë lekë më shumë se plani i 8 mujorit ose +0.4 %.
- ***Të ardhurat nga taksa nacionale*** kanë një realizim prej +445 milionë lekësh, ose rreth +1.5% më shumë se plani, si dhe +406 milionë lekë, ose rreth +1.3% më shumë se niveli i regjistruar në 8-mujorin e vitit 2025, ndër zërat me nënperformancë më të theksuar janë: të ardhurat nga taksa e qarkullimit (nga rënia e sasive të karburantit) me rënie prej -5.7% ose rreth -0.9 miliardë lekë më pak se 8M 2025, ndikuar kryesisht nga luhatjet dhe rritja e çmimeve të karburanteve. Megjithatë, rritja e zërave të tjerë ka kompensuar këtë ulje, ku veçohen taksa për automjetet e përdorura të transportit me rritje +32.4%, taksa për ambalazhet plastike +5.8% krahasuar me 8M 2025.
- Ndikimi *negativ i kursit të këmbimit në të ardhurat doganore* gjatë 8M 2026 ka qënë rreth – 4.95 miliardë lekë, ndërkohë konflikti në Lindjen e Mesme ka ndikuar pozitivisht në të ardhurat nga tvsh e karburanteve në import, me rreth +2.5 miliardë lekë më shumë, për 8 mujorin 2026.
- Të *ardhurat nga TVSH në import* kanë patur një devijim krahasuar me planin e periudhës Janar – Gusht 2026 me -2.7 miliardë lekë mosrealizim (-2.4%), me një rritje me rreth +4.4 miliardë lekë (+4.2%), kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2025. Mosrealizimi i planit lidhet kryesisht me efektet e kursit të këmbimit, rënies së sasisë së importit të energjisë elektrike me -47% dhe rënia e çmimit, e cila ka ndikuar negativisht në Tvsh me rreth -1,6 miliardë lekë.
- Për 8M 2026, importi i tatueshëm në peshë është rritur me +1% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, ndërsa në vlerë është rritur me rreth +6%. Eksporti definitiv ka shënuar një rënie prej -5% në peshë, ndërkohë që në vlerë ka regjistruar një rritje prej rreth +19%.
- *Të ardhurat nga akciza* janë me rritje rreth +2 miliardë lekë ose +4.5% më shumë se 8-mujori 2025, dhe me realizim me planin e periudhës me rreth +106 milionë lekë ose +0.2% më shumë. Rritja krahasuar me vitin 2025 ka ardhur kryesisht si pasojë e:
    - Rritjes së sasisë së hedhur për konsum të cigareve me +5% ose +111 ton , zbatimit të kalendarit të rritjes së akcizës për cigaret dhe duhanin si dhe indeksimit të normës së akcizës me normën zyrtare të inflacionit për produktet e tjera të akcizueshme në përputhje me parashikimet e ligjit për akcizën.
    - Rënie e sasisë së karburantit të hedhur për konsum me rreth -0.9% në krahasim me vitin e kaluar ose rreth -4.6 mijë ton më pak. Sipas administratës doganore, kjo rënie lidhet me rritjen e çmimeve të karburantit.
- ***Renta minerare*** për 8M 2026 rezulton me rënie -9.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe rritje +3.7% krahasuar me planin, ndikuar nga rritja e çmimit të eksportit për naftën bruto dhe minerale te tjera.
- ***Të ardhurat nga taksat doganore*** kanë rezultuar nën planin me rreth -155 milionë lekë, ndërkohë që kanë shënuar rritje prej rreth +568 milionë lekësh krahasuar me tetëmujorin e parë të vitit 2025.

Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore-8 M 2026:

Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mblidhen nga administrata tatimore për të punësuarit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH) për derdhjen e kontributeve vullnetare për fermerët nga F.S.D.K.SH që paguajnë në mënyrë vullnetare.

Për periudhën 8-mujore 2026, të ardhurat e mbledhura nga kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, u realizuan në masën 134.2 miliardë lekë, nga të cilat 116.5 miliardë lekë sigurime shoqërore dhe 17.7 miliardë lekë sigurime shëndetësore.

- Krahasuar me 8M 2025, janë mbledhur 15.9 miliardë lekë ose 13.4% më shumë.
- Krahasuar me planin për 8M 2026, janë mbledhur 494 milionë lekë më shumë me realizim 100.4% të planit.

Rritja e të ardhurave në kontributet e sigurimeve mbështetet në këta faktorë:

- Rritjen e pagave të administratës publike për vitin 2026 për disa kadegori punëmarrësish si dhe indeksimi i tyre me normën e inflacionit, shoqëruar kjo dhe me rritjen e fondit të pagave edhe për sektorin privat përgjatë gjithë vitit 2025 por edhe për 8M 2026.
- Masat e marra në Stategjinë Afatmesme të të Ardhurave dhe Planit të veprimit për vitin 2026 në kuadër të mirëadministrimit tatimor.

9.3 TË ARDHURAT E PRITSHME PËR VITIN 2026

Bazuar në performancën e të ardhurave sipas zërave të 8 mujorit 2026, është bërë parashikimi i të ardhurave të pritshme për vitin 2026. Për vitin 2026, të ardhurat nga tatimet dhe doganat priten të arkëtohen në shumën 535.4 miliardë lekë, ose 4.3 miliardë lekë më shumë se parashikimi në fillim të vitit.

Tabela 23 :Parashikimi i të ardhurave nga tatimet dhe doganat për vitin 2026 ***Në milionë lekë***

Totali i të ardhurave	**Plani Fillestar**	**Parashikimi i të ardhurave të pritshme për vitin 2026**	**Dif Plani Rishik/Plani fillestar**
TVSH Neto	242,546	249,901	7,355
Tatimi mbi fitimin	65,078	56,943	-8,135
Akciza	74,672	73,660	-1,012
Tatimi mbi të ardhurat personale	88,339	97232	8,893
Taksa Nacionale	49,589	48,296	-1,293
Taksë doganore	10,912	10,529	-383
Totali i të ardhurave nga tatimet dhe dogana	**531,137**	**536,561**	5,424

1. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

Të ardhurat nga "T.V.SH-ja neto" për vitin 2026 parashikohen rreth **249.9 miliardë lekë**, ose **7.4 miliardë lekë më shumë** se plani fillestar. Rritja e parashikimit bazohet në ecurinë pozitive të TVSH-së së brendshme gjatë 8-mujorit 2026, e cila rezultoi mbi plan si pasojë e rritjes së aktivitetit ekonomik, masave të mirëadministrimit tatimor dhe realizimit të rimbursimeve në nivel më të ulët se planifikimi. Ndërkohë,

TVSH-ja në import vijon të ndikohet nga efektet e kursit të këmbimit dhe ecuria e importit të disa mallrave kryesore.

2. **Tatimi mbi Fitimin**

Të ardhurat nga "Tatimi mbi Fitimin" për vitin 2026 parashikohen në rreth **56.9 miliardë lekë**, ose **8.1 miliardë lekë më pak** se plani fillestar. Rishikimi në ulje reflekton ecurinë e këtij zëri gjatë periudhës janar-gusht 2026, ku të ardhurat rezultuan **1.6% nën plan** dhe **5.1% më të ulëta** krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, të ndikuara kryesisht nga rënia e pagesave të tatim fitimit në sektorin e prodhimit.

3.Akciza

Të ardhurat nga akciza për vitin 2026 parashikohen në rreth **73,66 miliardë lekë**, ose **1.1 miliardë lekë më pak** se plani fillestar. Rishikimi në ulje reflekton pritshmëritë për ecurinë e konsumit të produkteve të akcizueshme gjatë pjesës së mbetur të vitit. Megjithatë, për periudhën janar-gusht 2026 të ardhurat nga akciza janë realizuar **0.2% mbi planin e rishikuar AN**, dhe **4.5% më shumë** krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025. Kjo performancë është mbështetur kryesisht nga rritja e të ardhurave nga **cigaret**, si rezultat i rritjes së sasisë së hedhur për konsum dhe zbatimit të kalendarit të rritjes së normës së akcizës.

4.Tatimi mbi të ardhurat personale

Të ardhurat nga **tatimi mbi të ardhurat personale** për vitin 2026 parashikohen në rreth **97,23 miliardë lekë**, ose **8.89 miliardë lekë më shumë** se plani fillestar. Rritja e parashikimit mbështetet në ecurinë pozitive të këtij zëri gjatë periudhës janar-gusht 2026, ku të ardhurat u rritën me **15.5%** krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kjo performancë është ndikuar kryesisht nga rritja e të ardhurave nga **tatimi mbi pagat**, si rezultat i rritjes së nivelit të pagave dhe masave të mirëadministrimit tatimor, si dhe nga rritja e të ardhurave nga **tatimi mbi të ardhurat biznesore**, **dividentët** dhe **shitja e pasurive të paluajtshme**, përfshirë efektin e procesit të rivlerësimit të pasurive.

5.Taksat nacionale

Të ardhurat nga **taksat nacionale** për vitin 2026 parashikohen në rreth **48.3 miliardë lekë**, ose **1.3 miliardë lekë më pak** se plani fillestar. Ulja e parashikimit lidhet kryesisht me mosrealizimin e të ardhurave të planifikuara nga aktiviteti i **lojërave të fatit**, me një efekt të vlerësuar prej rreth **2 miliardë lekësh**, për shkak të mosmiratimit të akteve nënligjore përkatëse. Si rrjedhojë, kjo vlerë konsiderohet si të ardhura të munguara për vitin 2026. Në të njëjtën kohë, ecuria e të ardhurave nga **taksa e qarkullimit për karburantin**, e ndikuar nga rënia e sasive të karburantit të hedhura për konsum, ka ushtruar presion shtesë në këtë zë. Megjithatë, rritja e të ardhurave nga **taksa për automjetet e përdorura të transportit**, **taksa kombëtare e karbonit**, **taksa për ambalazhet plastike** dhe **taksa mbi primet e shkruara** ka kompensuar pjesërisht këto efekte negative.

6.Taksa Doganore

Të ardhurat nga **taksat doganore** për vitin 2026 parashikohen në rreth **10.5 miliardë lekë**, ose **383 milionë lekë më pak** se plani fillestar. Rishikimi në ulje mbështetet në ecurinë e këtij zëri gjatë periudhës janar-

gusht 2026, ku të ardhurat, megjithëse rezultojnë **9.1% më të larta** krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, janë realizuar nën plan. Nënperformanca lidhet kryesisht me rënien e importeve të disa mallrave kryesore, veçanërisht verës, si dhe me ecurinë e importeve të frutave dhe perimeve dhe të sheqerit, të cilat kanë gjeneruar të ardhura më të ulëta se sa ishte parashikuar

7. Parashikimi i të ardhurave nga Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për vitin 2026

Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2026 parashikohen në masën 201.2 miliardë lekë, ose 4.2 miliardë lekë mbi planin fillestar. Rishikimi në rritje mbështetet në performancën pozitive të arkëtimeve gjatë vitit, të ndikuar nga zgjerimi i fondit të deklaruar të pagave, rritja e bazës kontribuese, si dhe efektet e masave të parashikuara në kuadër të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave dhe forcimit të administrimit fiskal.

Tabela 24: Parashikimi i pritshëm i të ardhurave nga Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore


Totali i të ardhurave	Plani Fillestar 2026	Të ardhurat e pritshme për vitin 2026	Dif I pritshëm/Plani fillestar
Sigurimi Shoqëror	170,621	174,819	4,198
Sigurimi Shëndetësor	26,345	26,353	8
Totali Shoqëror & Shëndetësor	**196,967**	**201,172**	**4,206**

9.4 ANALIZA E SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN JANAR-SHTATOR 2026

9.4.1 BUXHETI QENDROR

Shpenzimet e përgjithshme publike për periudhën 8 mujore të vitit 2026, arritën në rreth 496.2 miliardë lekë me një realizim në masën 95.7 përqind të planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 ky zë ka rezultuar 8.2 përqind më i lartë ose rreth 37.8 miliardë lekë më shumë. Në terma vjetor, shpenzimet e përgjithshme për 8M 2026 u realizuan në masën 54.7 përqind të planit vjetor të rishikuar.

Figura 13: ***Shpenzimet e përgjithshme korrente dhe kapitale (miliardë LEK) dhe ritmi i rritjes për periudhën 8 mujore (në %)***




Burimi: Ministria e Financave (2026)

a. Shpenzimet sipas natyrës ekonomike

Shpenzimet korrente dhe ato kapitale, për 8M 2026 kanë shënuar një realizim respektivisht:

- ✓ *Shpenzimet korrente 97% të planit të periudhës dhe 60.4% të planit vjetor të rishikuar.*
- ✓ *Shpenzimet kapitale 86.7% të planit të periudhës dhe 32.3% të planit vjetor të rishikuar.*

Figura 14*: Shpenzimet korrente dhe kapitale fakt dhe plan 8 mujor (në milionë LEK)*




Burimi: Ministria e Financave (2026)

Shpenzimet korente për periudhën 8 mujore të vitit 2026 rezultuan në rreth 439.3 miliardë lekë, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ky zë ka rezultuar 7.7 përqind më i lartë ose rreth 31.3 miliardë lekë më shumë. Shpenzimet korente për periudhën 8 mujore të vitit 2026 zënë rreth 88.5% të totalit të shpenzimeve ndërkohë që, krahasuar me PBB zënë 15.8%. Për shpenzimet korente, për periudhën 8 mujore ndër vite, raporti kundrejt PBB ka një nivel mesatar prej 15%.

Shpenzimet kapitale për periudhën 8 mujore të vitit 2026 rezultuan në rreth 56.9 miliardë lekë, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ky zë ka rezultuar 12.7 përqind më i lartë ose rreth 6.4 miliardë lekë më shumë. Shpenzimet kapitale për periudhën 8 mujore të vitit 2026 zënë 11.5% të totalit të shpenzimeve ndërkohë që, krahasuar me PBB zënë 2%. Për shpenzimet kapitale, për periudhën 8 mujore ndër vite, raporti kundrejt PBB ka një nivel mesatar prej 2.5%.

Figura 15*: Struktura e shpenzimeve të përgjithshme dhe raporti me PBB-në për periudhën 8 mujore*




Burimi: Ministria e Financave (2026)

Shpenzimet korente në raport me planin 8 mujor të këtij viti, paraqesin një realizim prej 97 përqind. Disa nga zërat kryesorë që ndikuan në nivelin e realizimit të shpenzimeve korente kundrejt planit 8 mujor janë përkatësisht:

- ✓ *Shpenzimet për fondet speciale me 101.7 përqind të planit të periudhës dhe 64.5 përqind të planit vjetor të rishikuar.*
- ✓ *Shpenzimet për personelin me 96.5 përqind të planit të periudhës dhe 61.8 përqind të planit vjetor të rishikuar.*
- ✓ *Shpenzimet për buxhetin vendor me 89.9 përqind të planit të periudhës 52.6 përqind të planit vjetor të rishikuar.*


Figura 16*: Struktura e shpenzimeve korente (në milionë LEK dhe në përqindje)*



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Shpenzimet e Personelit për periudhën 8 mujore të vitit 2026, përfaqësuan 20 përqind të totalit të shpenzimeve korente. Niveli i shpenzimeve faktike të personelit prej rreth 87.7 miliardë lekë, realizon nivelin e parashikuar për këtë zë në planin e periudhës 8 mujore në masën 96.5 përqind ose 61.8 përqind e planit vjetor të rishikuar. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, ky zë është 5.5 përqind më i lartë ose 4.5 miliardë lekë më shumë.


Figura 17*: Shpenzimet e Personelit dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliard LEK)*



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Shpenzimet për Interesa për periudhën 8 mujore të vitit 2026 kanë përfaqësuar 9.3 përqind të shpenzimeve korente. Niveli faktik i tyre prej rreth 44.2 miliardë lekë ka rezultuar në masën 98.4 përqind të planit të periudhës ose 69.2 përqind e planit vjetor të rishikuar. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, ky zë ka rezultuar 3.6 përqind më i lartë ose rreth 1.5 miliardë lekë më shumë.


Figura 18*: Shpenzimet për Interesa (në miliardë lekë)*



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Shpenzimet Operative & Mirëmbajtje për periudhën 8 mujore të vitit 2026, kanë shënuar një realizim në masën rreth 42.1 miliardë lekë ose 88.7 përqind të planit të periudhës. Niveli faktik i tyre ka rezultuar në masën 47.8 përqind e planit vjetor të rishikuar. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, ky zë ka rezultuar 2 përqind më i ulët, ose rreth 852 milionë lekë më pak.


Figura 19*: Shpenzimet Operative e Mirëmbajtje dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)*



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Shpenzimet për Subvencione, për periudhën 8 mujore të vitit 2026, arritën nivelin 1.5 miliardë lekë, me një realizim në masën 87.3 përqind të planit të periudhës ose 62.3 përqind të planit vjetor të rishikuar. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, shpenzimet për subvencione rezultojnë 19.7 përqind më të larta ose 251 milionë lekë më shumë.

Figura 20*: Shpenzimet për Subvencione dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)*



Burimi: Ministria e Financave (2026)


Shpenzimet për Fondet Speciale për periudhën 8 mujore të vitit 2026, rezultuan në nivelin rreth 186.6 miliardë lekë, me një realizim prej 101.7 përqind kundrejt planit të periudhës ose 64.5 përqind të planit vjetor të rishikuar. Përkatësisht:

- *shpenzimet për Sigurime Shoqërore u realizuan në masën rreth 142.1 miliardë lekë,*

- *shpenzimet për sigurime shëndetësore në rreth 43.7 miliardë lekë dhe*
- *shpenzimet për kompensimin e pronarëve në rreth 879 milionë lekë.*

Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2025, shpenzimet për sigurime shoqërore rezultojnë 13.8 miliardë lekë më të larta, shpenzimet për sigurime shëndetësore 2.8 miliardë lekë më të larta dhe shpenzimet për kompensimin e pronarëve 196 milionë lekë më të larta.

Figura 21*: Shpenzimet për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore (në miliardë lekë)*



Burimi: Ministria e Financave (2026)


Shpenzimet për Papunësinë për periudhën 8 mujore të vitit 2026 janë realizuar në masën 775 milionë lekë, duke rezultuar 111.3 përqind e planit të periudhës ose 77.5 përqind e planit vjetor të rishikuar. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2025 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 78.8 përqind, ose 342 milionë lekë më shumë.

Shpenzimet për Ndihmën Ekonomike dhe Pagesën e Paaftësisë (PAK) për periudhën 8 mujore të vitit 2026 u realizuan në masën rreth 15.6 miliardë lekë duke rezultuar rreth 97.5 përqind e planit të periudhës ose 61.5 përqind e planit vjetor të rishikuar. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2025 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 5.6 përqind ose 825 milionë lekë më shumë.

Shpenzimet për kompensimin e ish-të përndjekurve politik, për periudhën 8 mujore të vitit 2026 u realizuan në masën rreth 1 miliardë lekë duke rezultuar rreth 94.3 përqind e planit të periudhës ose 64.1 përqind e planit vjetor të rishikuar. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2025 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 107.5 përqind ose 531 milionë lekë më shumë.

Shpenzimet për bonusin e lindjeve për periudhën 8 mujore të vitit 2026 u realizuan në masën 1 miliardë lekë duke rezultuar rreth 81 përqind e planit të periudhës ose 43.5 përqind e planit vjetor të rishikuar. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2025 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 25 përqind ose 200 milionë lekë më shumë.


Figura 22*: Shpenzimet për Ndihmën Ekonomike, PAK dhe Papunësinë (në miliardë lekë)*



Burimi: Ministria e Financave (2026)

Shpenzimet për Pushtetin Vendor, për periudhën 8 mujore të vitit 2026 kanë arritur në masën rreth 58.8 miliardë lekë, duke rezultuar 89.9 përqind e planit të periudhës ose 52.6 përqind e planit vjetor të rishikuar. Shpenzimet për pushtetin vendor, për periudhën 8 mujore të vitit 2026, përbëjnë 13.5 përqind të totalit të shpenzimeve korente. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2025 ky nivel rezulton 14 përqind më i lartë ose rreth 7.2 miliardë lekë më shumë.

Figura 23*: Shpenzimet e Pushtetit Vendor dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)*




Burimi: Ministria e Financave (2026)

Shpenzimet kapitale, për periudhën 8 mujore të vitit 2026 kanë një realizim në masën rreth 56.9 miliardë lekë ose 86.7 përqind në raport me fondet e planifikuara për këtë periudhë.

- Financimi i brendshëm (*përfshirë investimet nga të ardhurat e arsimit të lartë, transferimet kapitale dhe fondin e rindërtimit*) është realizuar në masën rreth 46.6 miliardë lekë, duke rezultuar 89.7 përqind e planit të periudhës.
- Financimi i huaj është realizuar në masën rreth 10.3 miliardë lekë, duke rezultuar 75.5 përqind e planit të periudhës.

Krahasuar me planin vjetor 2026, për periudhën 8 mujore të vitit 2026 është konstatuar një realizim i përgjithshëm i shpenzimeve kapitale në masën 32.3 përqind të planit vjetor të rishikuar. Financimi i brendshëm është realizuar në masën 34.8 përqind të planit vjetor të rishikuar. Financimi i huaj është realizuar në masën 24.5 përqind të planit vjetor të rishikuar.

Figura 24*: Shpenzimet Kapitale dhe burimi i financimit të tyre (në miliardë lekë)*



Shënim: Financimi i Brendshëm përfshin investimet e brendshme, transferimet kapitale, investimet nga të ardhurat e arsimit të lartë dhe fondin e rindërtimit
Burimi: Ministria e Financave (2026)

Fondi Rezervë, është miratuar me Ligjin nr.87/2025 "*Për buxhetin e vitit 2026, të ndryshuar*" në masën 2.8 miliardë lekë, për t'u përdorur me vendim të Këshillit të Ministrave për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme. Deri me date 30 Shtator 2026, ky fond është përdorur si më poshtë:

Fondi Rezervë i planifikuar për raste të paparashikuara të njësive të qeverisjes së përgjithshme është përdorur nëpërmjet 8 Vendimeve të Këshillit të Ministrave (VKM) dhe AN nr 3 datë 6.07.2026 *"Për financimin e pjesshëm të organizimit të një aktiviteti kulturor-turistik me përmasa ndërkombëtare",* me vlerë totale prej rreth 549.9 milionë lekë, nga 2.8 miliardë lekë të planifikuara ose në rreth 80.4% përqind të planit.

- ✓ *Shuma prej 549.9 milionë lekë është përdorur për shpenzime të tjera korrente* (*shpenzime operative dhe transferta të brendshme si edhe transferta tek individët).*
- ✓ *Gjendja e papërdorur e fondit rezervë të buxhetit të shtetit, për raste të paparashikuara, deri më datë 30 Shtator 2026, rezulton rreth 2.25miliardë lekë.*

Fondi i Kontigjencës për Risqet e Borxhit, i planifikuar në masën 6.4 miliardë lekë, deri në fund të 9 mujorit 2026, nuk është përdorur.

Fondi i Rindërtimit prej 5 000 milionë lekë, deri në fund të 9 mujorit 2026, është përdorur rreth 1.64 miliardë lekë ose 33% e planit. Gjëndja e papërdorur e Fondit të Rindërtimit deri në fund të 9 mujorit rezulton rreth 3.36 miliardë lekë.

NDRYSHIMET E LIGJIT TË BUXHETIT GJATË VITIT 2026

Gjatë vitit 2026, buxheti i shtetit u ndryshua nëpërmjet Aktit Normativ Nr.2 datë 30.06.2026 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.87/2025 "Për buxhetin 2026*". Pas analizimit të performancës 5M të ecurisë së zbatimit të treguesve të konsoliduar makrofiskal dhe buxhetor, si edhe vlerësimit të pritshmërive të realizimit të tyre deri në fund të vitit, u përgatit skenari i rishikimit të buxhetit 2026.

Të ardhurat e përgjithshme, bazuar në performancën pozitive të 5M 2026 dhe parashikimin për periudhën e mbetur, u rritën në nivelin 843.1 miliardë lekë, 20.1 miliardë lekë ose +2.4% ndaj planit fillestar, dhe konkretisht:

- *Të ardhurat nga tatimet dhe doganat parashikohen të arrijnë në 538.3 miliardë lekë, me një rritje prej 7.12 miliardë lekë ose +1.3% kundrejt planit fillestar.*
- *Të ardhurat nga kontributet parashikohen në 200.9 miliardë lekë, me një rritje prej 3.9 miliardë lekë ose +2.0% mbi planin.*

Shpenzimet e përgjithshme u rritën në të njëjtin nivel me të ardhurat, duke ruajtur kësisoj të njëjtin nivel të defiçitit buxhetor me atë të miratuar në buxhetin fillestar 2026. Rishikimi i buxhetit nëpërmjet këtij Akti Normativ, synoi të balancojë prioritetet sociale me detyrimet strategjike të vendit, duke ruajtur njëkohësisht qëndrueshmërinë fiskale, nëpërmjet:

- ✓ *Rritjes së hershme të pensioneve – Përshpejtimi i indeksimit vjetor në 1 korrik, nga tetori kur ishte planifikuar fillimisht, për zbutjen më të shpejtë të efekteve të inflacionit.*
- ✓ *Forcimit të mbështetjes për Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK) – Rritje e financimit për përfitimet, shërbimet dhe masat e integrimit social, në funksion të përfshirjes dhe mirëqenies sociale, përmes:*
  - *Dyfishimit të pagesës për fëmijët me aftësi të kufizuara, me efekt nga data 1 Korrik 2026, me një kosto të vlerësuar prej 750 milionë LEK.*
  - *Pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga shteti për të gjithë kujdestarët e personave me aftësi të kufizuara, me efekt 674 milionë LEK nga data 1 Tetor 2026.*
- ✓ *Mbështetjes financare për procesin e integrimit evropian, me qëllim garantimin e burimeve të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve dhe angazhimeve lidhur me të.*
- ✓ *Përmbushjes së angazhimeve ndaj NATO – Sigurimi i kriterit të financimit të sektorit të mbrojtjes në nivelin 2.6% të PBB për vitin 2026, në përmbushje të objektivave të Aleancës dhe modernizimit të kapaciteteve mbrojtëse të vendit.*
- ✓ *Garancisë së re Shtetërore – Tashmë duke përfshirë politikën e mbështetjes me garanci të huasë jo vetëm për bizneset në sektorin e bujqësisë dhe fermerët e regjistruar dhe pajisur me çertifikatën e NIPT-it të fermerit, por edhe për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në të gjithë sektorët e ekonomisë.*
- ✓ *Përshtatjes së buxhetit me zhvillimet ekonomike dhe fiskale – Reflektimi i performancës së realizimit të të ardhurave dhe nevojave shtesë për financim buxhetor, në përputhje me dinamikat ekonomike të vitit, me qëllim optimizimin e shpërndarjes së fondeve për të adresuar nevojat prioritare, duke ruajtur qëndrueshmërinë fiskale dhe disiplinën buxhetore.*

9.4.2 BUXHETI VENDOR

Menaxhimi i financave publike në nivel vendor përbën një element kyç për garantimin e ofrimit të qëndrueshëm dhe cilësor të shërbimeve publike, si dhe për përmbushjen e objektivave të zhvillimit ekonomik dhe social në nivel lokal. Në këtë drejtim, pas miratimit të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ministria e Financave ka ndërmarrë një sërë reformash që kanë kontribuar në forcimin e kuadrit të menaxhimit financiar vendor, duke përmirësuar dhe unifikuar proceset e planifikimit, monitorimit, raportimit dhe zbatimit të buxhetit në nivel vendor.

Bazuar në të dhënat e treguesve fiskalë të konsoliduar dhe në informacionin e administruar në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë, është përgatitur analiza e realizimit faktik të të ardhurave dhe shpenzimeve vendore për periudhën janar-gusht 2026, e cila synon të vlerësojë ecurinë e financave vendore, performancën në mbledhjen e të ardhurave, si dhe përdorimin e burimeve financiare në funksion të ofrimit të shërbimeve publike dhe realizimit të investimeve në nivel vendor.

Të dhënat e 8 mujorit 2026 tregojnë një vijim të tendencës pozitive të financave vendore, të karakterizuar nga rritja e të ardhurave të veta dhe zgjerimi i nivelit të shpenzimeve, veçanërisht në drejtim

të financimit të personelit, shërbimeve operative dhe investimeve kapitale. Kjo ecuri pasqyron forcimin gradual të autonomisë fiskale vendore dhe konsolidimin e rolit të njësive të vetëqeverisjes vendore në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.


1. Të ardhurat e pushtetit vendor

Për vitin 2026 të ardhurat e pushtetit vendor me ligjin nr. 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026" u planifikuan në rreth 43.9 miliard lekë, megjithatë nxitur nga ecuria e realizimit të tyre gjatë vitit 2026, plani i të ardhurave të pushtetit vendor u rishikua nëpërmjet Aktit Normativ Nr. 2, datë 30.6.2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 87/2025,"Për buxhetin e vitit 2026", me 14 miliard lekë më shumë, në **57.9 miliard lekë**.

Referuar rezultatit të 8 mujorit 2026 vërejmë se të ardhurat tatimore të pushtetit vendor janë arkëtuar në rreth **44.45 miliard lekë** ose një realizim prej **77% të planit vjetor** të rishikuar, ku taksa e pasurisë është mbledhur në vlerën rreth 7.3 miliard lekë që përbën 73% të planit vjetor dhe taksat lokale në masën rreth 37.2 miliard lekë ose rreth 78% e planit. Referuar këtij realizimi pritshmëria është që deri në fund të vitit 2026 plani rishikuar prej 57.9 miliard lekë të realizohet plotësisht madje edhe të mund të tejkalohet.

Realizimi prej 44.45 miliard lekë për 8 mujorin 2026, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar rezulton rreth **19.2 miliardë lekë** ose **rreth 76% më i lartë** se vlera e të ardhurave tatimore të mbledhura gjatë 8M 2025, që përfaqëson një rritje të të ardhurave vendore jashtë trendit të zakonshëm të rritjes gjatë këtyre viteve. Realizimi i të ardhurave vendore gjatë 8M 2026, kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2025, tregon rritje të mbledhjes së të ardhurave të veta për secilin nga zërat e taksave vendore, por rritja më e madhe është realizuar tek të ardhurat nga taksat lokale, kryesisht të ardhurat nga *'taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja'*, e cila në 8M 2026 krahasuar me 8M 2025 ka një rritje prej 15.3 miliard lekë, ku konkretisht vërehet një rritje e arkëtimeve të kësaj takse kryesisht në bashkinë Tiranë si dhe bashkitë ku ka ndërtime të reja në zhvillim.

Figura 25: Të ardhurat e përgjithshme tatimore të pushtetit vendor dhe ritmi i ndryshimit të tyre në vite



Burimi: Ministria e Financave, https://financa.gov.al/treguesit-fiskale-sipas-buxhetit-te-konsoliduar/


- ***Taksat lokale***

Nga të ardhurat që sigurojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore peshën më të madhe e zënë taksat lokale. Për 8 mujorin 2026 këto taksa zënë rreth 83.6% të shumës totale të të ardhurave tatimore të pushtetit vendor. Të ardhurat nga taksat lokale kanë konsoliduar trendin kryesisht në rritje nga viti në vit pas reformës administrativo-territoriale, ndërsa sa i përket 8 mujorit 2026 këto taksa janë mbledhur në vlerën **37.2 miliard lekë**, kundrejt 19.4 miliard lekë mbledhur gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2025, pra rreth **17.7 miliard lekë më shumë ose 91% më tepër se vlera e mbledhur një vit më parë**. Në këtë rezultat ndikimi

më i madh vjen nga të ardhurat nga *'taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja'*, nga e cila në 8M 2026 janë arkëtuar rreth 23.9 miliard lekë, ose 15.3 miliard lekë më shumë krahasuar me 8M 2025.

Në grupin e taksave lokale, pjesën më të madhe të tyre e zënë të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, me rreth 64.3% të taksave lokale, ku të ardhurat e realizuara nga bashkia Tiranë zënë një peshë të konsiderueshme prej 69% sipas të dhënave të 8 mujorit 2026 të totalit të të ardhurave të kësaj takse. Në grupin e taksave lokale sipas peshës që zënë, më pas renditen të ardhurat nga tarifa e pastrimit dhe higjenës që zënë rreth 14% të taksave lokale për këtë periudhë.

Figura 26: Të ardhurat nga Taksat Lokale dhe ritmi i ndryshimit të tyre në vite




Burimi: Ministria e Financave, https://financa.gov.al/treguesit-fiskale-sipas-buxhetit-te-konsoliduar/

- ***Taksa e pasurisë***

Të ardhurat nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të pushtetit vendor. Për 8 mujorin 2026, grupi i taksave mbi pasurinë, ku përfshihet ndërtesa, trualli, toka bujqësore dhe transaksionet mbi pasurinë, përbën 16.4 % të totalit të të ardhurave të veta tatimore të pushtetit vendor. Në vlerë absolute, ato janë mbledhur në rreth **7.3 miliardë lekë** në 8 mujorin 2026, shifër kjo që është rreth **1.4 miliard lekë më e lartë**, ose me një rritje prej rreth 24.8%, krahasuar me vlerën e mbledhur gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2025.

Figura 27: Të ardhurat nga Taksa e pasurisë dhe ritmi i ndryshimit të tyre në vite



Burimi: Ministria e Financave, https://financa.gov.al/treguesit-fiskale-sipas-buxhetit-te-konsoliduar/

- ***Taksa e biznesit të vogël***

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël pas ndryshimeve fiskale ligjore është bërë zero (ligji nr.112/2020 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar"). Nga realizimi faktik gjatë 8 mujorit 2028, rezulton se nga ky zë janë mbledhur rreth 9 milion lekë, që zënë vetëm 0.02% të të ardhurave vendore, të cilat përfaqësojnë detyrime të prapambetura të

paguara me vonesë. Disa nga njësitë e vetëqeverisjes vendore mbledhin detyrime nga ky burim për ato subjekte të cilat nuk kanë kryer pagesat brenda afatit dhe rezultojnë debitorë.

- ***Të ardhura të tjera jotatimore të pushtetit vendor***

Një burim tjetër i rëndësishëm i të ardhurave të veta vendore që lidhet drejtëpërdrejtë me aktivitetin e pushtetit vendor, janë të ardhurat jotatimore. Për 8 mujorin 2026, njësitë e vetëqeverisjes vendore në shkallë kombëtare kanë mbledhur të ardhura jo tatimore në masën mbi **2.7 miliard lekë** ose rreth 122 milion lekë më shumë se 8 mujori 2025.

2. Shpenzimet e pushtetit vendor

Shpenzimet e pushtetit vendor edhe në vitin 2026 paraqesin vijimësinë e procesit të konsolidimit të financave vendore dhe të forcimit të rolit të njësive të vetëqeverisjes vendore në ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët. Rritja progresive e kompetencave dhe përgjegjësive të qeverisjes vendore, e shoqëruar me rritjen e kapaciteteve administrative dhe financiare, ka ndikuar në zgjerimin e nivelit të shpenzimeve të realizuara nga bashkitë, si në drejtim të mbulimit të kostove operacionale, ashtu edhe në financimin e investimeve publike.


Referuar të dhënave të treguesve fiskalë të pushtetit vendor për 8-mujorin 2026, shpenzimet vendore janë realizuar në masën prej rreth **58.8 miliard lekë**, ose rreth **53% të planit të rishikuar** të shpenzimeve të buxhetit vendor për vitin 2026, plan i cili është rishikuar nëpërmjet Aktit Normativ Nr. 2, datë 30.6.2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 87/2025,"Për buxhetin e vitit 2026".

Realizimi prej **58.8 miliard lekë**, shënon **një rritje prej rreth 7.2 miliard lekë** ose **14.0%** krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, kur ato rezultuan në nivelin prej rreth 51.6 miliard lekë. Kjo rritje dëshmon vijimin e tendencës pozitive të financave vendore, ndërkohë që rritja e burimeve kërkon njëkohësisht kapacitete më të larta absorbuese të njësive të vetëqeverisjes vendore në përdorimin e burimeve financiare për financimin e funksioneve dhe shërbimeve publike në përgjegjësi të tyre. Ecuria e shpenzimeve të buxhetit vendor gjatë periudhës 8 mujore, është mbështetur nga burimet: të ardhura të veta vendore, ashtu edhe nga transfertat e pakushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit.

Krahasuar me vitet e mëparshme, shpenzimet e pushtetit vendor vijojnë të ndjekin një trajektore të qëndrueshme rritëse. Në 8 mujorin 2026 niveli i shpenzimeve ka arritur vlerën më të lartë të regjistruar historikisht për këtë periudhë, duke reflektuar ndikimin pozitiv të reformave të ndërmarra në kuadër të decentralizimit fiskal, rritjen graduale të autonomisë financiare vendore, si dhe përmirësimin e kapaciteteve të bashkive për planifikimin dhe zbatimin e buxheteve të tyre.

Sipas grafikut të mëposhtëm, paraqitet vizualisht trendi i qëndrueshëm i rritjes ndër vite të buxhetit të pushtetit vendor, duke shmangur luhatjet e theksuara të evidentuara në periudha më të hershme. Kjo ecuri pozitive konfirmon forcimin gradual të financave vendore dhe rritjen e rolit të qeverisjes vendore në zhvillimin ekonomik dhe social.

Figura 28: Shpenzimet për pushtetin vendor dhe ritmi i ndryshimit të tyre në vite




Burimi: Ministria e Financave, https://financa.gov.al/treguesit-fiskale-sipas-buxhetit-te-konsoliduar/

- **Struktura e shpenzimeve sipas llogarive ekonomike**

Sa i përket strukturës së shpenzimeve, peshën më të madhe e zënë **shpenzimet për personelin**, të cilat përbëjnë rreth **51%** të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor. Më pas renditen **shpenzimet operative** me rreth **24%**, ndërsa **shpenzimet kapitale** zënë rreth **20%** të totalit. Pjesa e mbetur përbëhet nga **subvencionet 2%** dhe **shpenzimet e tjera korente 3%**. Struktura e shpenzimeve tregon se njësitë e vetëqeverisjes vendore vazhdojnë të ruajnë një balancë ndërmjet mbulimit të kostove operative dhe financimit të investimeve publike.

Në krahasim me 8 mujorin 2025, pothuajse të gjithë zërat e shpenzimeve kanë shënuar rritje, ku rritja më e lartë në vlerë absolute evidentohet tek shpenzimet për personelin dhe ato kapitale, siç konstatohet edhe nga grafiku më poshtë.

Figura 29: Shpenzimet e pushtetit vendor sipas klasifikimit ekonomik



Burimi: Ministria e Financave, SIFQ, https://financa.gov.al/realizimi-accrual_cash/

- **Shpenzimet e personelit**

Shpenzimet për personelin gjatë 8 mujorit 2026 janë realizuar në masën **29.9 miliard lekë**, kundrejt 26.5 miliard lekë në të njëjtën periudhë të vitit 2025, duke shënuar një rritje prej rreth **3.4 miliard lekë** ose **12.9%**. Nga kjo shumë, **25.7 miliard lekë** janë paga dhe **4.3 miliard lekë** kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Rritja e këtij zëri lidhet kryesisht me vazhdimin e politikave të rritjes së pagave në sektorin publik vendor, rritjen e kapaciteteve administrative për përmbushjen e funksioneve dhe shërbimeve të transferuara në nivel vendor.

Shpenzimet për paga përbëjnë rreth 51% të totalit të buxhetit, duke mbetur zëri me peshë më të madhe në strukturën e shpenzimeve të buxhetit vendor. Niveli i lartë i këtij treguesi evidenton peshën e

konsiderueshme të kostove të personelit në burimet financiare, ndërkohë që kufizon në një masë të caktuar hapësirën buxhetore të disponueshme për financimin e investimeve.

- **Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes**

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes janë realizuar në vlerën prej **14.0 miliard lekë**, duke rezultuar rreth **1.8 miliard lekë** ose **15.0% më të larta** se në 8 mujorin 2025. Rritja e këtij treguesi lidhet me zgjerimin e gamës së shërbimeve publike të ofruara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe me rritjen e kostove të mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe aseteve publike të krijuara në vitet e fundit. Në total, këto shpenzime përfaqësojnë rreth **24%** të shpenzimeve të pushtetit vendor për periudhën në analizë.

- **Shpenzimet për subvencione dhe shpenzime të tjera korente**

Shpenzimet për subvencione janë realizuar në masën **1.27 miliard lekë**, duke regjistruar një rritje prej rreth **172 milion lekë** ose **15.8%** krahasuar me 8 mujorin 2025. Ndërkohë, shpenzimet e tjera korente rezultojnë në nivelin **1.96 miliard lekë**, me një rritje të lehtë prej **40 milion lekë** ose **2.1%** kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Këto zëra të shpenzimeve vijojnë të përbëjnë një peshë relativisht të kufizuar në strukturën e përgjithshme të shpenzimeve vendore, megjithatë luajnë rol të rëndësishëm në mbështetjen e politikave sociale dhe funksioneve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore.

- **Shpenzimet kapitale**

Shpenzimet kapitale për 8 mujorin 2026 janë realizuar në vlerën prej **11.7 miliard lekë**, duke dëshmuar në realizim më të lartë me rreth **2.5 miliard lekë** ose **18%**, kundrejt 9.9 miliard lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2025.

Investimet publike vendore vazhdojnë të mbeten një ndër komponentët më të rëndësishëm të buxhetit vendor, me një **peshë prej rreth 20%** të totalit të shpenzimeve për periudhën në analizë. Rritja e këtij zëri tregon përpjekjet e bashkive për përmirësimin e infrastrukturës publike, zgjerimin e investimeve në shpenzimet vendore dhe realizimin e projekteve me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe social të komuniteteve. Pritshmëritë mbeten pozitive për përshpejtimin e realizimit të investimeve gjatë muajve të mbetur të vitit buxhetor 2026.

Më poshtë paraqitet në mënyrë të përmbledhur tabela e të ardhurave tatimore vendore dhe shpenzimeve në financat publike vendore gjatë 8 mujorit të vitit 2026 dhe 8 mujorit të vitit 2025 dhe ndryshimet mes tyre në vlerë dhe në përqindje.

Tabela 25: **Të ardhurat dhe shpenzimet faktike të pushtetit vendor sipas natyrës (*në milion lekë*)**

Nr	E M Ë R T I M I	Realizimi faktik		Diferenca	
		8 M 2026	8 M 2025	në vlerë 2026-2025	në % 2026 - 2025
I.	**Të ardhura nga Pushteti vendor**	**44,450**	**25,296**	**19,154**	**75.7%**
I.1	*Taksa mbi pasurinë*	7,279	5,834	1,445	24.8%
I.2	*Taksa e biznesit të vogël*	9	18	-9	-51.4%
I.3	*Taksa Lokale*	37,162	19,443	17,719	91.1%
II.	**Shpenzime nga Pushtetit Vendor**	**58,844**	**51,599**	**7,245**	**14.0%**
II.1	***Shpenzime Korente***	**47,156**	**41,693**	**5,462**	**13.1%**
	Personeli	29,919	26,495	3,424	12.9%
	Shpenzime Oper. Mirmbajtje	14,006	12,180	1,826	15.0%
	Subvencione	1,266	1,094	172	15.8%
	Te tjera	1,964	1,924	40	2.1%
II.2	***Shpenzime Kapitale***	**11,688**	**9,906**	**2,487**	**18.0%**

Burimi: Ministria e Financave, https://financa.gov.al/treguesit-fiskale-sipas-buxhetit-te-konsoliduar/

Analiza e treguesve të paraqitur në tabelën nr.1, evidenton rritjen e ndjeshme të të ardhurave të veta vendore gjatë 8 mujorit 2026, e shoqëruar gjithashtu me rritje edhe të shpenzimeve të pushtetit vendor. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, të ardhurat vendore rezultojnë me ritëm rritjeje më të lartë se shpenzimet.

Për vitin 2026 pushteti vendor ka përfituar nga buxheti qendror transfertë të pakushtëzuar (të përgjithshme dhe sektoriale) më të lartë në vlerë, si dhe ka realizuar të ardhura të veta më të larta se parashikimet fillestare. Në këtë kuadër sfida që paraqitet është, që këto burime financiare të shtuara të materializohen në shpenzime reale për më shumë shërbime dhe investime të kryera në shërbim të qytetarëve.

3. Fondi i rindërtimit

Fondi i rindërtimit vijon të përbëjë një burim të rëndësishëm financimi për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Për 8 mujorin 2026, buxheti i disponueshëm për këtë fond rezulton në **6.6 miliard lekë**, ndërsa realizimi faktik ka arritur në **977 milion lekë**, ose rreth **14.8%** të fondit të programuar.

Nga realizimi total, 285 milion lekë janë përdorur për shpenzime kapitale, 8 milion lekë për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, ndërsa 684 milion lekë janë përdorur në formën e transfertave për familjet dhe individët përfitues. Struktura e realizimit tregon se pjesa më e madhe e fondeve të përdorura deri në këtë periudhë është orientuar drejt mbështetjes së familjeve dhe individëve të prekur, ndërkohë që pjesa e investimeve pritet të intensifikohet gjatë pjesës së mbetur të vitit.

Njëkohësisht, vihet re se ritmi i realizimit të fondit mbetet relativisht i ulët krahasuar me fondin e disponueshëm, megjithatë ekziston potenciali për përshpejtim të zbatimit të projekteve të rindërtimit gjatë muajve në vijim rritje të realizimit të shpenzimeve nga ky fond.

Tabela 26: **Detajimi i fondit të rindërtimit sipas llojit të shpenzimeve** ***(në milion lekë)***


Nr	E M Ë R T I M I	8 mujori 2026	
		Buxheti operativ	Realizimi faktik
III.	**Fondi i Rindërtimit**	**6,617**	**977**
	Shpenzime kapitale	2,693	285
	Shpenzime Opereative & Mirëmbajtje	470	8
	Transferta për familjet dhe individët	3,454	684

Burimi: Ministria e Financave, SIFQ, https://financa.gov.al/realizimi-accrual_cash/

9.5 ECURIA E BORXHIT PUBLIK PËR PERIUDHËN JANAR-SHTATOR 2026

Në fund të muajit qershor 2026, borxhi publik u vlerësua në nivelin 1,367.9 miliard Lekë ose 49.0%[8] e PBB-së, duke u ulur me 3.9 p.p krahasuar me fundin e vitit 2025. Në vijim, raporti i borxhit ndaj PBB-së do të vazhdojë të planifikohet më i ulët se niveli i vitit të kaluar, derisa niveli i borxhit të arrijë dhe të qëndrojë nën 45% të PBB-së, kjo në përputhje me parimin përkatës fiskal të përcaktuar në kuadrin ligjor.

Figura 25: ***Borxhi publik në vlerë absolute dhe relative ndaj PBB (2020- Qershor 2026)***




Burimi: *Ministria e Financave (2026)*


Përbërja e Borxhit Shtetëror

Sa i përket strukturës së maturimit, në portofolin e borxhit të brendshëm shtetëror, referuar të dhënave të gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, peshën më të madhe e mbajnë titujt afatmesëm (2-5 vite) me 41.1% të peshës. Në përputhje me objektivin strategjik për rritjen e jetëgjatësisë së portofolit të borxhit të brendshëm, pesha e titujve me afat të gjatë maturimi (mbi 5 vite) është rritur me 3.8 pp, dhe pesha e titujve afatshkurtër është ulur me 2.3 pp krahasuar me fundit e vitit 2025. Ndërkohë, pesha e titujve me norma interesi të ndryshueshme mbetet në nivele të ulëta (nën nivelin prej 0.5%), pasi edhe gjatë kësaj periudhe nuk ka patur emetime të titujve me norma interesi të ndryshueshme, në përputhje me objektivat për reduktimin e riskut të normave të interesit dhe shmangien e fragmentimit të kërkesës për titujt me maturitet të ngjashëm.

Figura 26*: Kompozimi i borxhit të brendshëm shtetëror sipas maturitetit të titujve dhe tipit të interesit (2020–Qershor 2026)*

[8] *PBB për vitet 2020-2025: Burimi- Instat (http://databaza.instat.gov.al). Parashikimi 2026 , Burimi -Drejtoria Makroekonomike dhe Statistikave pranë MF https://financa.gov.al/kuadri-makroekonomik-dhe-fiskal (VKM Nr.516 datë 30.06.2026)*







Burimi: *Ministria e Financave (2026)*

Në portofolin e borxhit të jashtëm, mbi 60% të peshës e mban borxhi me normë interesi fikse.
Për sa i përket kompozimit sipas instrumenteve, pesha e Eurobondit vlerësohet të jetë në rritje nga viti në vit për shkak të emetimeve më të shpeshta në tregjet ndërkombëtare, ku Eurobondi më i fundit është emetuar në muajin shkurt 2025 në vlerën prej 650 milion Euro. Në fund të qershorit 2026, në portofolin e borxhit shtetëror janë 4 Eurobonde të pamaturuar në vlerën totale prej 240.1 miliard Lekë. Pas kategorisë së Eurobondit, një peshë të konsiderueshme në portofolin e borxhit të jashtëm shtetëror mbajnë huatë me burim kreditorët dypalësh dhe shumëpalësh, me destinacion financimin e projekteve me natyrë zhvillimore.

Figura 27: ***Kompozimi i borxhit të jashtëm shtetëror sipas tipit të instrumenteve dhe tipit të interesit (2020–Qershor 2026)***





Burimi: *Ministria e Financave (2026)*

Realizimi i Huamarrjes

Gjatë viteve të fundit, huamarrja është realizuar në përputhje me nevojat buxhetore dhe në përputhje me objektivat strategjikë për ruajtjen e stabilitetit të marrëdhënies ndërmjet raporteve të kostos dhe risqeve.

Periudha janar-qershor 2026 ka qenë pozitive përsa i përket sigurimit të financimit, si në tregun e brendshëm dhe në atë të huaj. Huamarrja gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 u realizua në linjë me buxhetin e vitit 2026 si edhe në linjë me Planin e Huamarrjes së vitit 2026. Huamarrja në terma bruto u realizua në

vlerën rreth 232.6 miliard Lekë, nga të cilat 93.1% (ose rreth 216.5 miliard Lekë) u financuan nëpërmjet burimeve të brendshme dhe 6.9% (ose rreth 16.2 miliard Lekë) nëpërmjet burimeve të huaja.

Tabela 27: Realizimi i Huamarrjes (T2 2025 -T2 2026)

Burimet e Huamarrjes	Janar-Qershor 2025		Janar-Qershor 2026	
	Vlera *(në mld Lekë)*	**%/Total**	**Vlera** *(në mld Lekë)*	**%/Total**
Burime të Brendshme	**229.1**	**76.1%**	**216.5**	**93.1%**
Bono Thesari	128.3	42.6%	103.9	44.7%
Obligacione	100.8	33.5%	112.5	48.4%
Burime të Jashtme	**72.1**	**23.9%**	**16.2**	**6.9%**
Hua për financimin e projekteve	6.0	2.0%	7.6	3.3%
Mbështetje Buxhetore	3.0	1.0%	8.5	3.7%
Eurobond	63.1	20.9%	-	0.0%
Total Huamarrja	**301.2**	**100.0%**	**232.6**	**100.0%**

Burimi: *Ministria e Financave (2026)*

Huamarrja e Brendshme

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, Ministria e Financave ka emetuar në tregun e brendshëm tituj shtetërorë në vlerën rreth 216.5 miliard Lekë, nga të cilat rreth 103.9 miliard Lekë i përkasin titujve afatshkurtër dhe rreth 112.5 miliard Lekë titujve afatgjatë. Në përputhje me Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 është rritur frekuenca dhe vlera e emetimeve të instrumenteve afatgjata.

Kërkesa për tituj shtetërorë ka qenë më e lartë se oferta e Qeverisë pothuajse në të gjitha ankandet e realizuara gjatë fillimit të vitit. Huamarrja neto në tregun e brendshëm në fund të muajit qershor 2026 rezultoi në nivele negative prej -18.2 miliard Lekë, si rrjedhojë e maturimit të titullit 2 vjeçar në vlerën 40.9 miliard Lekë dhe dy titujve referencë, përkatësisht obligacioni 3 vjeçar në vlerën 27.9 miliard Lekë dhe obligacioni 5 vjeçar në vlerën 26.6 miliard Lekë. Maturimi i instrumenteve referencë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, do të vijojë me linja të reja instrumentesh referencë 3 dhe 5 vjecare, emetimi i të cilave do të shtrihet gjatë gjithë vitit 2026.

Tabela 28: ***Huamarrja shtetërore nga burime të brendshme në terma neto dhe bruto (Janar - Qershor2026)***

Lloji i Titullit	Janar-Qershor 2026		
	Emetim *(në mld Lekë)*	**Maturim** *(në mld Lekë)*	**Huamarrja Neto** *(në mld Lekë)*
Tituj Afatshkurtër	**103.9**	**126.3**	**-22.4**

Bono Thesari në Lekë	103.9	126.3	-22.4
Tituj Afatgjatë	**112.5**	**108.4**	**4.1**
Obligacione 2 vjeçare	11.4	40.9	-29.5
Obligacione 2 vjeçare në Euro	0.0	0.0	0.0
Obligacione 2.5 vjeçare	25.4	0.0	25.4
Obligacione 3 vjeçare	17.1	27.9	-10.7
Obligacione 5 vjeçare	21.7	26.6	-4.9
Obligacione 7 vjeçare	13.8	6.0	7.8
Obligacione 10 vjeçare	13.2	7.0	6.2
Obligacione 15 vjeçare	5.2	0.0	5.2
Obligacione 20 vjeçare	4.7	0.0	4.7
Gjithsej Tituj Shtetërorë	**216.5**	**234.7**	**-18.2**

Burimi: *Ministria e Financave (2026)*

Huamarrja e Huaj

Përsa i përket huamarrjes së huaj, gjatë gjashtëmujorit të parë vitit 2026, huamarrja e jashtme bruto u realizua në nivelin prej rreth 16.2 miliard Lekë, dhe është realizuar krysisht nëpërmjet disbursimit të huave për financimin e projekteve në fushën e transportit, ujësjellës kanalizime dhe infrastrukturë.

Tabela 29: ***Huamarrja e huaj në terma bruto (T2 2025-T2 2026)***

Huajamarrja e Huaj Bruto	**Qershor 2025**		**Qershor 2026**	
	Vlera *(në mld Lek)*	**%/Total**	**Vlera** *(në mld Lek)*	**%/Total**
Kredi për financim projektesh	**6.0**	**8.4%**	**7.6**	**47.2%**
Energjia	0.1	0.1%	0.3	1.6%
Transporti	2.3	3.1%	1.6	9.6%
Ujësjellës Kanalizime	1.2	1.7%	0.9	5.6%
Infrastruktura Urbane	1.1	1.5%	2.1	13.1%
Shëndetësia	0.9	1.2%	0.2	1.0%
Të Tjera	0.4	0.6%	2.6	16.2%
Mbështetje Buxhetore	**3.0**	**4.2%**	**8.5**	**52.8%**
Eurobond	**63.1**	**87.5%**	**0.0**	**0.0%**
Total Huamarrja e Huaj	**72.1**	**100.0%**	**16.2**	**100.0%**

Burimi: *Ministria e Financave (2026)*

<u>Kostot dhe Risqet</u>

Kosto dhe shërbimi i borxhit

Për sa i përket raporteve të kostos dhe riskut në portofolin e borxhit, portofoli i borxhit është arritur të menaxhohet në mënyrë të përshtatshme, duke mbajtur koston në nivelin më të ulët të mundshëm sipas kushteve të tregut.


Kosto

Gjatë gjashtëmujorit të parë vitit 2026, shpenzimet për interesa të borxhit përllogariten në vlerën prej 31.3 miliard lekë, përkatësisht 18.5 miliard lekë për interesa të borxhit të brendshëm dhe 12.8 miliard lekë për interesa të borxhit të jashtëm. Ripagesat e borxhit të jashtëm për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026 ishin

15.5 miliard lekë (pagesa për principalin). Krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, shpenzimet për interesa vlerësohen rreth 1.0 miliard lekë (ose 3.3%) më të larta se gjashtëmujorin i parë i vitit 2025. Rritja ka qenë në kategorinë e instrumenteve të tregut të jashtëm, si rezultat ndryshimit të profilit të pagesave të interesave pas emetimit të Eurobondit të fundit në vitin 2025, ku ky i fundit u emetua në muajin Shkurt, dhe për rrjedhojë shkakton një zhvendosje të pagesave të interesit për këtë lloj instrumenti, në gjashtëmujorin e parë të vitit.

Rritja e shpenzimeve për interesa ka qenë brenda fondit të parashikuar në buxhetin e vitit 2026. Gjithashtu, kosto mesatare për borxhin e brendshëm në gjashtëmujorin e parë të 2026 rezultoi në nivelin 4.18%, duke u ulur me 0.05 bp krahasuar me fundin e vitit 2025, ku u vlerësua në nivelin 4.23%. Ulja e kostos mesatare për borxhin e brendshëm ka reflekuar uljen e normave të interesit, e cila ka filluar që në fund të vitit 2023.

Figura 28: ***Shpenzimet për interesa të borxhit shtetëror (T2 2020- T2 2026)***



Burimi: *Ministria e Financave (2026)*

Risqet

Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit synon të përmirësojë më tej strukturën e borxhit (kryesisht strukturën e portofolit të borxhit të brendshëm), në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve, si dhe mbajtjes së kostos në nivelet më të ulëta të mundshme, bazuar në kushtet aktuale të tregut. Gjatë gjashtëmujorit të parë vitit 2026, Ministria e Financave ka vazhduar përpjekjet në kuadër të mirëmenaxhimit të tij dhe ka vijuar të sigurojë përmirësim referuar disa prej treguesve sasiorë.
Konkretisht, sa i takon riskut të rifinancimit, jetëgjatësia e borxhit të brendshëm (ditët mesatare në maturim) është përmirësuar duke u rritur me 162 ditë, nga 1002 ditë në fund të vitit 2025 (2.8 vite) në 1179 ditë (3.3 vite) në fund të qershorit 2026, si rezultat i shtimit të instrumenteve afatmesme dhe afatgjata në portofol. Ndërkohë, pesha e borxhit që maturohet brenda një viti është ulur nga 39.2% në fund të vitit 2025, në 33.4% në qershor 2026.
Sa i përket riskut të normave të interesit, është rritur koha mesatare në rifiksim nga 2.8 vite në Dhjetor 2025, në 3.3 vite në qershor 2026. Gjithashtu, edhe pesha e borxhit që rifikson normën e interesit brenda vitit është ulur nga 39.2% në Dhjetor 2025, në 33.4% në qershor 2026.
Risku i kursit të këmbimit është mbajtur nën kontroll duke qëndruar ndjeshëm nën tavanin e përcaktuar në strategji. Konkretisht, totali i stokut të borxhit në valutë ndaj stokut të borxhit total rezultoi 40.1% në fund

të qershor 2026, i cili është një nivel poshtë tavanit prej 50% të përcaktuar në Strategjinë Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit 2022-2026.

Tabela 30: ***Treguesit e riskut të borxhit të brendshëm shtetëror (2025–Qershor 2026)***

Tregues i riskut	2025	T2 2026
Koha Mesatare ne Maturim (në vite)	2.8	3.3
Pesha e Instrumenteve qe maturohen brenda nje viti	39.2%	33.4%
Borxh i rivlerësuar në një vit	39.2%	33.4%
Koha Mesatare ne rifiksim (në vite)	2.8	3.3

Burimi: *Ministria e Financave (2026)*

Zhvillimet e Tregut Primar të Titujve Shtetërorë

Ecuria e ankandeve

Tregu primar i titujve shtetërorë gjatë periudhës janar-qershor 2026 përgjithësisht është karakterizuar nga zhvillime pozitive, ku vlen të përmendet kërkesa e tregut në nivele të kënaqshme në raport me nevojat e qeverisë për huamarrje dhe vijimi me projektin market maker për emetimin e obligacionit 5-vjeçar dhe 3-vjeçar referencë.

Ecuria e ankandeve dhe kërkesa për titujt shtetërorë

Gjatë gjashtëmujorit të parë vitit 2026, Ministria e Financave ka organizuar në total 52 ankande, nga të cilët 19 ankande për tituj afatshkurtër, 33 ankande për tituj afatgjatë. Kërkesa gjatë këtij gjashtëmujori ka rezultuar në vlerën 297.1 miliard Lekë, nga e cila 124.0 miliard Lekë i korespondon Bonove të Thesarit dhe 173.1 miliard Lekë i korespondon Obligacioneve.

Gjatë gjashtëmujorit të parë vitit 2026 kërkesa për tituj shtetërorë ishte në nivele të kënaqshme, duke tejkaluar ofertën e Qeverisë për tituj shtetërorë. Raporti i mbulimit ka qenë mbi 1.0 në shumicën e ankandeve të realizuara si në kategorinë e titujve afatshkurtër dhe në kategorinë e titujve afatgjatë. Kërkesa për tituj shtetërore ka vazhduar të mbështetet tek investitorët vendas (rezidentë), ndërkohë që sektori bankar mbetet burimi kryesor i kërkesës me mbi 60% të peshës.


Në kuadër të zhvillimit të infrastrukturës së tregut primar dhe stimulimit të tregut sekondar, kanë vazhduar të ndërmerren aktivitete, të cilat kanë pasur si objektiv reduktimin e fragmentimit të kërkesës, si dhe konsolidimin e madhësive *benchmark* për titujt afatgjatë. Titujt referencë 3 dhe 5 vjeçar janë emetuar me sukses në dy linja emetimi gjatë gjashtëmujorit të parë vitit 2026: konkretisht Obligacioni referencë 3 vjecar është emetuar në shumën totale 21.2 miliard Lekë dhe Obligacioni referencë 5 vjecar është emetuar në shumën totale 21.7 miliard Lekë.

Në drejtim të krijimit të madhësive *benchmark* është vijuar me konsolidimin e numrit të ankandeve të titujve shtetërorë, duke ulur frekuencën e emetimeve të titujve të rinj dhe duke përdorur rihapjet e titujve ekzistues.

Ecuria e normave të interesit

Normat mesatare të ponderuara gjatë gjashtëmujorit të parë vitit 2026 kanë shënuar ulje krahasuar me fundin e vitit 2025 duke reflektuar tepricën e likuiditetit dhe kërkesën e rritur nga investitoret për tituj qeveritarë.

Figura 29: ***Yield-et titujve shtetërorë[9] (2024- T2 2026)***



Burimi: *Ministria e Financave (2026)*

Pritshmëritë për Borxhin në vitin 2027

Referuar parashikimeve të rritjes ekonomike, si edhe deficitit buxhetor të planifikuar për vitin 2026, niveli i borxhit publik në raport me PBB në fund të vitit 2026 parashikohet të ulet në rreth 52.5%, ndërkohë që në fund të vitit 2027 planifikohet në nivelin prej 52.4%. Gjithsesi, niveli i pritshëm i borxhit mbetet në varësi të realizimit të planit të huamarrjes gjatë pjesës së mbetur të vitit 2026 dhe gjatë 2027.

Huamarrja e brendshme gjatë vitit 2027 planifikohet në një vlerë prej 48 miliardë Lek. Huamarrja e re në tregun e brendshëm pritet të realizohet kryesisht nëpërmjet titujve shtetërorë afatgjatë në përputhje me objektivat për reduktimin e risqeve, por gjithashtu duke ju përshtatur edhe preferencave të investitorëve për titujt.

Huamarrja e huaj parashikohet të realizohet nëpërmjet disbursimit të huave që financojnë ecurinë e zbatimit të projekteve prioritare të qeverisë, si dhe disbursimit të mbështetjeve buxhetore procedurat dhe kushtet paraprake të të cilave mund të arrijnë të plotësohen gjatë vitit 2027. Gjithashtu në vitin 2027 parashikohet dhe emetimi i një Eurobondi në vlerën indikative prej rreth 62.6 mld Lekë. Në total huamarrja e huaj gjatë vitit 2027 vlerësohet të jetë rreth 118.2 miliardë Lekë, dhe duke konsideruar borxhin e huaj që ripaguhet gjatë vitit, huamarrja e huaj neto pritet të rezultojë në nivelin 22.6 miliardë Lekë.

Sa i përket zhvillimeve më të fundit të normave të interesit, gjatë vitit 2026 është vënë re një rritje e lehtë e normave të interesit krysisht në tregun e huaj. Bazuar në normat më të fundit të interesit, si edhe bazuar në nivelin e huamarrjes së brendshme dhe asaj të jashtme për vitin 2026 dhe 2027, shpenzimet për interesa në tregun e huaj dhe atë të brendshëm pritet të jenë në nivele të krahasueshme me vitin 2026. Për sa i përket ripagesave të borxhit të jashtëm (principali), në vitin 2027 planifikohen të jetë në vlerën 95.6 mld Lekë, pasi përfshihet dhe maturimi i njërit prej Eurobondeve në vlerën prej 62.6 mld Lekë.

Tabela 31*: Shërbimi i borxhit shtetëror 2026-2027* *(në milion Lekë)*

Shërbimi	Janar-Shtator 2026 (Fakt)	2026 (I pritshmi)	2027 (Plan)
Shërbimi Borxhit Shtetëror	**68,568.5**	**90,019.4**	**157,049.5**

[9] I referohet normës mesatare të ponderuar të titujve shtetërorë të emetuar vetëm në tregun primar.

Interesat e Borxhit të Brendshëm Shtetëror	31,751.1	35,152.7	38,550.2
Interesat e Borxhit të Jashtëm Shtetëror	15,070.9	22,254.0	22,882.5
Ripagesat e Borxhit të Jashtëm Shtetëror	21,746.5	32,612.7	95,616.8

Burimi: Ministria e Financave (2026)

9.6 BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR PËR VITIN 2027

Për vitin 2027, Qeveria Shqiptare vijon angazhimin për integrimin e barazisë gjinore në planifikimin dhe përdorimin e burimeve publike, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 dhe kuadrin ligjor të menaxhimit të sistemit buxhetor. Përmes buxhetimit të përgjigjshëm gjinor dhe në zbatim të ligjit nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe procedurave të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), synohet që programet dhe shërbimet publike të marrin në konsideratë nevojat e ndryshme të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve, si dhe të adresojnë pabarazitë e evidentuara në sektorët përkatës.

Kjo përmbledhje paraqet rezultatet e integrimit të Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor (BPGJ) në politikat dhe buxhetet sektoriale për periudhën 2027–2029. Për vitin 2027, kanë integruar buxhetimin e përgjigjshëm gjinor (BPGJ) në total, 82 (tetëdhjetë e dy) programe nga njëqind e tridhjetë e një kanë përfshirë qasjen gjinore në nivel qëllimi, tregues kyç performance dhe produkti. Totali i buxhetit gjinor të parashikuar për vitin 2027 është 88,364,054,220 lekë, që përbën 9.1% të buxhetit total kombëtar.

Në tabelën e mëposhtme[10] paraqiten në mënyrë më të detajuar shpenzimet e planifikuara me kostot përkatëse që adresojnë pabarazi gjinore të sektorëve ku veprojnë ministritë e linjës dhe institucione të tjera qendrore.

Tabela 32

[10] Këtu përfshihen vetëm të dhënat e marra nga sistemi AFMIS dhe relacionet e institucioneve përkatëse. Përllogaritjet përfshijnë vetëm të dhënat e dukshme në sistem. Politika/objektiva të tjerë që adresojnë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë pabarazitë gjinore, nuk janë përfshirë në këtë përmbledhje.

Ministria/Institucioni	Programi Buxhetor	Kosto e planifikuar (në lekë)
Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	Planifikim, Menaxhim, Administrim	279,672,422
	Keshillimi dhe informacioni bujqesor	2,600,000
	Zhvillimi Rural	891,357,355
	Nen-Totali	**1,173,629,777**
Ministria e Infrastruktures dhe Energjise	Planifikim, Menaxhim, Administrim	415,535,387
	Nen-Totali	**415,535,387**
Ministria e Ekonomise dhe Inovacionit	Mbështetje për inovacion dhe teknologji	30,000,000
	Arsim i mesem Profesional	487,507,466
	Tregu I Punes	443,625,825
	Sigurimi Shoqeror	21,457,171,812
	Strehimi Social	166,164,706
	Mbeshtetje per Zhvillim Ekonomik	65,000,000
	Nen-Totali	**22,649,469,810**
Ministria e Arsimit	Arsimi Baze	18,032,067,200
	Arsimi I Mesem I Pergjithshem	5,353,985,984
	Arsimi I larte	5,859,214,561
	Nen-Totali	**29,245,267,745**
Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale	Sherbimi Paresor	352,327,696
	Sherbimi Dytesor	5,029,519,539
	Shendeti Publik	40,926,000
	Perkujdesi Social	20,597,181,932
	Nen-Totali	**26,019,955,167**
Ministria e Drejtesise	Planifikim, Menaxhim, Administrim	276,400,000
	Ndihma Juridike	23,000,000
	Sistemi I Burgjeve	9,000,000
	Permbarimi Gjyqesor	245,305,960
	Shërbimi i Provës	7,113,000
	Mjekesia Ligjore	4,600,000
	Nen-Totali	**565,418,960**
Ministria per Evropen dhe Punet e Jashtme	Mbeshtetje Diplomatike jashte vendit	100,000,000
	Nen-Totali	**100,000,000**
Ministria e Brendshme	Policia e Shtetit	1,472,860,068
	Garda e Republikes	2,713,119,596
	Gjendja Civile	351,398
	Nen-Totali	**4,186,331,062**
Ministria e Mbrojtjes	Forcat e Luftimit	1,592,684,690
	Mbështetja e Luftimit	464,218,050
	Mbeshtetje per shendetesine	4,320,298
	Arsimi Ushtarak	279,774,380
	Nen-Totali	**2,340,997,418**
Ministria e Kulturës, Turizmit dhe Sportit	Zhvillimi I turizmit	310,000,000
	Nen-Totali	**310,000,000**
Avokati Popullit	Sherbime te Avokatise	2,008,829
	Nen-Totali	**2,008,829**
Shkolla e Magjistratures	Veprimtaria Arsimore	16,924,226
	Nen-Totali	**16,924,226**
Kuvendi	Planifikim, Menaxhim, Administrim	211,531,836
	Veprimtaria Ligjvenese	928,355,572
	Nen-Totali	**1,139,887,408**
Akademia e Shkencave	Veprimtaria Akademike	5,028,571
	Nen-Totali	**5,028,571**
Qendra Kombetare e Kinematografise	Mbeshtetja e veprimtarise kinematografike	61,655,160
	Nen-Totali	**61,655,160**
Agjencia per Media dhe Informim	Sherbime te tjera	99,897,200
	Nen-Totali	**99,897,200**
Kancelaria e Urdhrave dhe Medaljeve	Sherbime te tjera	32,047,500
	Nen-Totali	**32,047,500**
TOTALI		**88,364,054,221**
Totali i Shpenzimeve Buxhetore 2026		**975,563,560,152**
Perpjesa e Buxhetimit te Pegjigjshem Gjinor (ne %)		**9.1%**

Integrimi i BPGJ-së në planifikimin buxhetor po forcon transparencën dhe përgjegjshmërinë institucionale. Në periudhën 2027–2029, prioritetet kryesore janë: *rritja e kapaciteteve analitike për vlerësimin gjinor në çdo ministri, integrimi i treguesve gjinorë në programet buxhetore vjetore dhe forcimi i mekanizmave të monitorimit dhe raportimit*.

Sektorët me ndjeshmëri më të lartë gjinore janë shëndetësia dhe mbrojtja sociale, arsimi dhe formimi profesional, si dhe ekonomia dhe punësimi.

Në total, 9.1% e buxhetit qendror është i ndjeshëm ndaj barazisë gjinore. Të paktën 82 programe buxhetore zbatojnë instrumente konkrete për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor. Përfshirja gjinore është më e fortë në sektorët e shëndetësisë, arsimit dhe punësimit. Zhvillimi i treguesve gjinorë dhe monitorimi i ndikimit mbeten prioritete për fazën e ardhshme të planifikimit buxhetor 2028–2030.

KËSHILLI I MINISTRAVE